

The background of the cover is a photograph of a cave. At the top, a large opening in the rock ceiling allows bright light to stream down, creating a dramatic lens flare effect. The cave walls are dark and textured, with some stalactites visible. In the foreground, a person stands on a circular stone platform that is part of a larger stone structure extending into a pool of water. The water is dark and reflects the light from the opening above.

DIL NGA SHPELLA

Fundi i Kurthit të Rimishërimit

LIBRI 1

Nga **Howdie Mickoski**

Përktheu **Ledion Azemaj**

DIL NGA SHPELLA

Fundi i Kurthit të Rimishërimit

LIBRI 1

Nga **Howdie Mickoski**

Perktheu **Ledion Azemaj**

Dil nga Shpella, Fundi i Kurthit të Rimishërimit Libri 1

E drejta e autorit © 2022 Howdie Mickoski

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Ky informacion është i disponueshëm për t'u përdorur sipas nevojës për qëllime kërkimore. Unë vetëm të kërkoj të japësh kredit për atë që ke shpëndarë. Nuk është në rregull ta postosh të gjithë këtë libër si skedar PDF në internet pa lejen time.

ISBN

SHËNIM

Kushdo që mund të thotë se ai e di me siguri se çfarë ndodh pasi ne të vdesim, ose si dhe pse ky univers u krijua, është duke gënjyer. Gjithçka që dikush mund të paraqesë janë fusha të studiuara mirë, të moduluara nga përvoja personale, që ndajnë një tezë të mundshme. Unë po bëj të njëjtën gjë këtu. Unë nuk i di me siguri këto përgjigje, por me vitet e mia kërkimore e ndiej se po afrohem. Vetëm pasi ngjarja ime e tranzicionit të ndodhë unë do ta di se sa teza ime përputhej me realitetin.

Ky është libri i parë i një serie me dy pjesë dhe Libri 2 do të jetë i disponueshëm diku në pranverën e vitit 2023. Së bashku ata do të përbëjnë një pjesë të punës që unë mendoj se do të jetë e dobishme për të më përgatitur mua në "Udhëtimin Tim Definitiv" dhe ndoshta, tëndin gjithashtu.

Unë bëj disa pretendime shumë intensive për realitetin në këtë libër. Kjo nuk do të thotë se unë e miratoj "largimin" herët nga realiteti. Ky libër synon të ndihmojë njerëzit të shqyrtojnë dhe kuptojnë një sferë komplekse iluzionare, dhe të inkurajojë që koha të përdoret në dispozicion për të parë të gjitha truket dhe mashtrimet që mbahen në të. Të "largoresh herët" (dmth. të bësh vetëvrasje) merr tej më shumë kohë përgatitjeje që mund të kërkohet për të dalë siç duhet. Megjithëse kjo sferë dhe përvojë mund të jetë e vështirë, sugjerimi im është që koha në një formë fizike të përdoret për të vazhduar gërmimin në të gjitha gjurmët e njohurive në dispozicion, për të gjetur mënyra për të qënë me vlerë për të tjerët dhe natyrën, dhe për të qënë sa më në ekuilibër që të jetë e mundur. Pjesa tjetër do të kujdeset vetë.

Redaktorë të shkëlqyer e kanë shqyrtuar këtë tekst. Megjithatë, pasi ata mbaruan, unë shtova fjali në të gjithë tekstin pak para botimit. Si të tilla, atje do të mbeten disa gabime drejtshkrimore ose gramatikore. Kjo nuk është një "mbikëqyrje" nga ana e tyre.

Urimet më të mira.

NJË FONDACION

“Dhe unë hyra në mes të burgut të tyre, që është burgu i trupit. Dhe unë thashë: "Ai që dëgjon, le të ngrihet nga gjumi i thellë".

Apokrifoni i Gjonit¹

¹ <http://gnosis.org/naghamm/apocjn-davies.html>

1

HËNA E KORRJES

“Filozofët e vërtetë e bëjnë vdekjen profesionin e tyre, dhe për ta nga të gjithë njerëzit, vdekja është më e pakta alarmante. Është perspektiva për të arritur dëshirën e tyre të përhjetshme, urtësinë.” **Plato, Phaedo**

Ku je ti?

Po sikur ti të zgjoheshe një mëngjes, le të themi - këtë mëngjes, me idenë e çmëndur se gjithçka që ty të është thënë ndonjëherë është veçse një gënjeshtër? Gjithçka që ty të mësuan në shkollë, nga prindërit e tu, feja, dhe TV ishte thjesht një formë mashtrimi? Që të gjitha sistemet që ti besove, që ti besove se ishin krijuar për interesin tënd më të mirë, janë të rreme? Një seri e llogaritur gënjeshtërash të krijuara si një lloj mekanizëm kontrolli, për të të mbajtur ty dhe të gjithë, nën magjinë e magjistarëve që e kontrollojnë këtë sferë. Po sikur ti të zbuloje se edhe të gjitha fushat që duken të krijuara për të të ndihmuar ty, të tilla si feja, spiritualiteti, apo vetë-ndihmesa, janë të gjitha pjesë e mashtrimit gjithashtu?

Po sikur ti të zgjoheshe në një moment, le të themi – në këtë moment, dhe të kuptoje se ti në fakt, ke vdekur; se ti je në sferën e pas-vdekjes? Një tunel me një dritë të bardhë shfaqet përpara teje, dhe një engjëll i dashur ose gjyshja jote e dashur është atje duke të të thirrur ty drejt asaj drite. Çfarë do të bëje ti? Është shkuarja drejt kësaj drite një bekim, apo mënyra se si ti futesh më tej në kurth?

Po sikur të ketë një dalje?

“Një temë që ka pasur shumë fokus dhjetë vitet e fundit ose më shumë është rreth temës "kurthet e shpirtit", dhe me pak fjalë kjo është duke thënë se qëniet jo-njerëzore² ose e krijuan këtë sferë, ose e kontrollojnë këtë sferë, dhe ata sjellin shpirta njerëzorë në një konstrukt bote artificiale. Ata e bëjnë këtë në mënyrë që t'i kultivojnë njerëzit për ushqim duke përdorur energjinë tonë (kryesisht në formën e frikës dhe emocioneve të tjera negative, si në filmin e animuar *Monsters Inc.*) si burimin e tyre. Kur ne vdesim, ne mashtrohemi në momentin kyç kur ne

² Të njohur si arkonë në tekstet Gnostike Nag Hammadi

mund të largohemi nga e gjithë kjo, nga alienë që maskohen si qenie drite ose ish të dashurit tanë. (Atëherë ti do) të shkosh në një tunel drite, ose lart drejt një shkalle me drita. Bërja e njëres prej këtyre do të na bëjë ne të hyjmë në ciklin e rimishërimit dhe të kthehemi në një tjetër jetë në "fermën e shpirtit". **Wayne J Bush**³

Citimi i mësipërm i Wayne Bush jep të gjithë informacionin që ty të nevojitet për këtë temë, dhe dyqind faqet e ardhshme do të jenë një ekzaminim i pesë fjalive të mësipërme. Për ta bërë këtë, ne do të na duhet të shqyrtojmë shumë prova rreth jetës dhe vdekjes. Kjo përfshin ato që njihen si Përvojat Pranë Vdekjes (**NDE**), koncepte të tilla si karma, rimishërimi dhe mëkati. Një pikë bazë diskutimi në këtë libër do të jetë alegoria e Shpellës së Platos që gjëndet në librin e tij *Republika*. Ajo është një histori rreth një shpelle të burgosurish të cilët mashtrohen për të jetuar një jetë iluziore. Studiuesit përpiqen të shpjegojnë analogjinë e Shpellës së Platos, dhe daljen prej saj thjeshtësisht. Ata e përshtasin analizën e tyre në besimet e tyre rreth kësaj bote, dhe pak janë ata që pyesin nëse ajo është një analogji e dobishme? Ky libër nuk merret shumë me kurthet në këtë sferë; ky libër po shikon për fondacionin e të gjitha kurtheve.

Në përgjithësi, kur një person ka pasur një NDE, ata prezantojnë një histori të ngjashme.⁴ Ata thonë se ata hyjnë në një sferë që është thujse konfuze, derisa ata, ose shohin një dritë të bardhë (shpesh në një tunel), me qenie ndoshta si engjëj, ose të afërmit e vetë të vdekur që e inkurajojnë një të shkojë drejt asaj drite. Disa përballen me një lloj shkalle në vënd të dritës. Ata që e përjetojnë këtë dritë thonë se ajo është përvoja më e bukur që ata mund të imagjinojnë. Dashuria personifikoi disa raporte, një vënd që ata nuk donin të largoheshin. Në një moment atyre u thuhet - ose pas një lloj rishikimi të jetës ose me anë të një prezantimi të thjeshtë të jetës- se kjo "nuk është koha e tyre", se "ata kanë akoma punë ose ende një mision për të përfunduar", ose "ata kanë më shumë për të mësuar", dhe kështu ata dërgohen përsëri në trupat e tyre këtu në Tokë. Ata duket se transformohen nga kjo përvojë, dhe shpesh, shumë prej tyre e ndryshojnë mënyrën e jetës në mënyra drastike. Në përgjithësi ata priren të bëhen më të sjellshëm, më të dashur, dhe humbasin frikën nga vdekja. Gjithçka tingëllon mirë, apo jo? Apo është kjo shumë e mirë për të qënë e vërtetë? Unë do të ndaj disa nga këto përvoja NDE në kapitullin katër.

³ <http://www.trickedbythelight.com>

⁴ Një depo madhështore prej 4000 NDE mund të gjëndet në <http://www.nderf.org>, ndërsa të tjerë libra rreth kësaj temë janë bazuar në qindra ose mijëra raste.

"Dhe nuk është çudi, sepse Satani vetë maskohet si një engjell i dritës."
Korinthiasit 11:14⁵

Por këto nuk janë të vetmet përvoja që njerëzit kanë pasur në botën e pas-vdekjes. Shumë nga këto "përvoja të tjera" kanë tendencën të indikojnë se tregimet standarte të dritës së bardhë dhe engjëjt e dashur nuk janë gjë tjetër veçse një mashtrim, dhe se çdo shpirt që hipnotizohet pas asaj përvoje ka arritur vetëm skllavërimin e vazhdueshëm të shpirtit të tyre. Unë fillova të pyesja veten duke ekzaminuar tregimet standarte se nëse ata që përjetuan përvoja "të bukura" u jepeshin atyre thjesht si pjesë e asaj që unë e quaj *një fushatë propagandiste*. Ata që kthehen përsëri këtu (shpesh kundër vullnetit të tyre) mund t'iu jetë dhënë një version "lite-demo" e asaj përvoje, dhe kjo ndoshta për t'i inkurajuar ata për të shkruar disa libra se si ai tunel me atë dritë të bardhë është miku i tyre. Nëse ti do të mund të ishe drejtuesi i një mashtrimi që kishte nevojë për shpirtra për të qëndruar të bllokuar në këtë sferë, sa NDE do të dëshiroje ti që ta shihnin "ngjarjen e vërtetë"? Sa më pak që të jetë e mundur. Kjo duhet mbajtur parasysh. Pakica prej 15% e përvojave mund të jenë ato që do të shkojnë në pjesët më të kompletuara të NDEsë, ndërsa 85% e përvojave standarte janë ata që po marrin një dozë të fortë mashtrimi.⁶ NDEtë jo-standarte shqyrtohen në kapitullin nëntë.

Një nga besimet mbi të cilat përvoja njerëzore është bazuar në, është se ne jetojmë në një botë të mrekullueshme, krijuar nga një krijues i dashur, një vënd ku të gjitha dëshirat tona mund të realizohen, në mënyrë që ne të rritemi, të mësojmë dhe të evoluojmë. Nëse ne vetëm kemi besim të mjaftueshëm, atëherë ne do të arrijmë të hyjmë në një sferë qiellore për gjithë përjetësinë, e mbushur me re, harpa dhe engjëj. Ky libër do të paraqesë tezën se ne jetojmë pikërisht në të kundërtën e këtij prezantimi standart. Studimi im (nëpërmjet grupeve të lashta Gnostike dhe Katarëve, si dhe punës së filozofëve modernë) do të zbulojë se ne jetojmë në një botë artificiale të simuluar, krijuar nga një hyjni e ligë (quajtur Demiurge nga Gnostikët).⁷ Ky realitet që ne jetojmë nuk është një krijim i ri, por një kopje e një sfere më reale e cila është Shtëpia jonë. Kur shqyrtohet më nga afër, kjo

⁵ Përkthimi i prezantuar në <https://www.biblegateway.com/passage/?search=2%20Corinthians%2011&version=NIV>

⁶ Unë kam pasur disa përvoja personale afër-vdekjeje, secila ka zbuluar disa elementë të rëndësishëm, por unë nuk them se unë e di me siguri se çfarë vdekja do të sjellë për mua apo dikë tjetër. Në fakt, një nga përvojat e mia afër-vdekjes (në vitin 2005) që do ta diskutoj plotësisht më vonë në Librin 2, mund të mos ketë qënë hapja e mrekullueshme që ajo dukej të ishte në atë kohë, por një truk i krijuar për të më mbajtur mua larg nga ku studimi im po shkonte në atë kohë (vetë materiali që ti po lexon tani).

⁷ Përpara se të krijonte këtë botë, Demiurge krijoi ata që mund të quhen ndihmës ose minionia për veten e tij. Gnostikët i quanin ata arkonë, por emra të tjerë si alienë, demonë, entitete parazitare janë përdorur gjithashtu.

kopje e kësaj bote duket më shumë si ajo që ne tani e quajmë *Inteligjencë Artificiale*. Artificiale në kuptimin jo organike, jo "e gjallë" siç ne i referohemi këtij termi. Esenca jonë u mashtrua të hynte në këtë simulim, e cila është sajuar në një mënyrë të tillë që të na mbajë këtu për të korrur energjinë tonë si një burim energjie që ta mbajë këtë simulim të funksionojë. Disa mund të thonë se kjo tingëllon çmënduri. Por a është kjo? Ndoshta kjo tezë do të jetë një shpjegim i qartë i realitetit tonë dhe përvojave konstante përreth nesh të vuajtjeve dhe dhimbjeve?!

“Janë ata (alienët gri) që presin në dritë kur një qenie njerëzore vdes. Qënia njerëzore më pas riciklohet në një tjetër trup dhe procesi fillon përsëri nga e para... Prandaj dhe pse Drita dhe Tuneli në Kurthin e Vdekjes. Duke skanuar dikë që ata dëshirojnë të riciklojnë teksa dikush është afër vdekjes, alienët zbulojnë se me cilin ai person ishte i afërt me që tashmë ka vdekur. Ata projektojnë imazhin e person-it(ave) në tunelin e dritës së bardhë dhe ai imazh e tërheq dikë edhe më thellë në të. Dhe nëse ti ZGJEDH ta ndjekësh atë, ti mund të bllokohesh dhe të dërgohesh në një tjetër mishërim sipas zgjedhjes së tyre... këto entitete e shohin Tokën si një fermë madhështore.” - **Val Valerian**⁸

Kjo temë rreth faktit se Toka është një fermë shpirtrash ka ekzistuar prej shumë dekadash, por përgjithësisht në skajet e çdo kërkimi alternativ. Gurdjieff shpesh fliste se ne jemi këtu në Tokë për t'u bërë "ushqim për Hënën". Shumica menduan se ai po tregohej simbolik, por me siguri jo. A e di ti se Hëna më e famshme gjatë vitit njihet si “Hëna e Korrjes”? A ka të bëjë ajo me të vërtetë rreth njerëzve që korrin të korrat e tyre, apo rreth Hënës që korr të korrat e saj njerëzore? Tema u ngrit nga studiuesi i famshëm i eksperiencave jashtë-trupit (**OBE**) Robert Monroe, i cili në kapitullin e dymbëdhjetë të librit të tij "*Udhëtimet e Largëta*" në 1971, shkruajti se alienët kërkonin atë që ai e quajti "energji loosh". Sfera jonë u bë një e ndërtuar për t'ia ofruar këtë loosh kontrolluesve alien. Unë e diskutoj librin e tij në detaje në kapitullin tre. Val Valerian (i cili deklaroi se ishte një ish-agjent i CIA-s), shkroi një seri librash Matriks duke filluar në 1990 me të njëjtin subjekt, se Toka ishte një fermë. Karlos Kastaneda në librin e tij të fundit *Ana Aktive e Pafundësisë* diskutoi se si entitetet parazitare na kanë korrur ne për energji prej shekujsh me radhë. Pjesë e këtij procesi ishte që ata të na jepnin ne mëndjen e tyre (një ego parazitare), në mënyrë që ne të mund të jemi më të lehtë për t'u kontrolluar dhe sjellë në mënyrat negative që ata dëshirojnë për ne, kështu që të mund të rrisin prodhimin tonë të energjisë.

⁸ Gjetur në librat Matrix II dhe Matrix V, deklaruar të ketë qënë një ish-agjenti i CIA-s John Grace dhe referencuar në <http://www.trickedbythelight.com/tbt/light.shtml>

Mungesa e njerëzve që mendojnë për zinxhirin ushqimor mua më huton. Një minnow (lloj peshku) ha një mushkonjë dhe e merr atë energji në vetvete. Një peshk ha minnowin dhe e merr atë energji në vetvete. Njeriu ha peshkun dhe e merr atë energji në vetvete. Qënia njerëzore besohet të jetë supreme, pasi asgjë nuk e merr energjinë tonë. Nëse njerëzit do të kishin një kuptim më të qartë të realitetit, deklaratat duhet të vazhdojnë: Një arkon ha njeriun dhe e merr atë energji në vetvete. Arkoni e merr atë energji, e fut atë përsëri në simulimin e matriksit, e cila më pas do të dërgohet për të arritur një mushkonjë të re, dhe kurthi i vorbullës thjesht vazhdon të rrotullohet.

Ky ekzaminim do të jetë i vështirë për t'u lexuar nga pothuajse të gjithë, sepse të gjitha shpresat dhe dëshirat tona më të mëdha dhe të dashura do të vihen në provë. Këto përfshijnë idenë e "Vullnetit të Lirë" - që në një farë mënyre ky realitet u krijua që ne të mund të bëjmë dhe përjetojmë ashtu siç ne zgjedhim. Megjithatë, ne do të gjykojemi më vonë për zgjedhjet tona. Problemi me këtë teori është se atje ka shumë momente në jetën e njerëzve kur ata mendojnë se ata "nuk kishin një zgjedhje" ose "ajo ishte e destinuar të ndodhte". Dhe kështu, cilat ngjarje janë zgjedhje të vullnetit të lirë dhe cilat janë të destinuara? Kjo bëhet e turbullt në këtë pikë. Një personazh në një lojë mund të besojë se ai gjithashtu ka një vullnet të lirë, por ai veprojnë vetëm në bazë të programimit që karakterit të tij i është dhënë si kod. Po sikur ne të jemi përdorur për tekat e një tjetri (si robotët host në shfaqjen televizive Westworld që përdoren nga të supozuarit njerëz të ftuar që sillen si parazitë ndaj tyre)? A ishte ti ai që me të vërtetë e zgjodhe mëngjesin tënd këtë mëngjes, apo ishte ajo një moment i programuar i futur në kompjuter shekuj më parë?

Një tjetër temë që shumica e njerëzve e marrin të mirëqënë si të vërtetë, është koncepti i Krishterë i mëkatit, edhe pse ne asnjëherë nuk na u dha një manual për jetën në hyrje, as edhe ndonjë ide reale se kush ose çfarë do të gjykojë veprimet tona. Ideja e karmës, e ngjashme me mëkatin, është se kur gjërat e mira që ne bëjmë shpërblehen dhe gjërat e këqija që ne bëjmë ndëshkohen. Fetë Lindore e kanë çuar konceptin e karmës edhe pak më tej, duke e shtuar atë tek rimishërimi, ku këto momente karmike përcaktojnë nëse ti kthehesh si një person i rëndësishëm, një fshatar i ulët, apo edhe (Zoti na ruajt) një kafshë.

Tema e rimishërimit i rrethon të gjitha këto. Kjo temë e shmangies së një kurthi rimishërimi të shpirtit ishte besimi themelor pas një grupi në Francën Jugore të njohur si Katarët (Cathars), të cilët Kisha e Romës i shfarosi duke filluar në 1209 pas Krishtit në kryqëzatën dhe inkuizionin e tyre të parë kundër njerëzve të tyre.⁹ Megjithatë, në njëzet vitet e fundit, subjektet e kurtheve të shpirtit dhe korrjes së energjisë kanë marrë nivele të reja. Një tjetër element kyç i këtij diskutimi, është ajo që mund të quhet "fshirja e kujtesës", e personifikuar në botën e lashtë nga (Cup of Forgetfulness) "Kupa e Harresës" Hermetike dhe perëndesha Kineze Meng Po dhe (soup of

⁹ Katarët do të diskutohen më në detaje në kapitullin njëmbëdhjetë.

forgetfulness) "supa e harresës" së saj.¹⁰ Pikërisht në këtë fjalë ne po marrim një kuptim të asaj që është duke ndodhur, harresë-eplotë (forget-fulness): mos kujtimi i plotësisë ose tërësisë së Çfarë Ne Jemi.

Shumë do të pretendojnë me vrull se ideja e rimishërimit është e rreme sepse ata nuk mbajnë mend asnjë nga jetët e tyre, edhe Papa madje e mohon konceptin. Ne kemi një jetë dhe kjo është ajo. Shumica e atyre që ndjekin një fe Perëndimore do ta refuzojnë menjëherë idenë e rimishërimit, edhe pse kur ti shikon historinë e hershme së të gjitha këtyre feve, rimishërimi mund të gjëndet në mësimet e tyre të hershme. Krishterimi mund ta ketë hequr atë diku vonë në vitin 525 pas Krishtit. Tema ka të ngjarë të jetë hequr për të fshehur këtë fakt, sepse njerëzit nuk do të ndërmarin veprime për diçka që ata nuk besojnë se ekziston. Fetë Lindore ende e ruajnë konceptin e rimishërimit, por ajo nuk është gjithashtu askund afër si prezantimi i saj origjinal. Budistët pretendojnë se bota është vuajtje, dhe rimishërimi është rrota e samsarës dhe njeriu duhet të ndjekë mësimet e Budës për të dalë nga cikli, por këto mësim kryesisht kanë të bëjnë me kufizimet morale dhe uljes me sy mbyllur. Në fakt atje flitet më shumë se si të kesh një jetë më të mirë herën tjetër sesa realisht të mbarosh me ciklin. Rimishërimi ekziston ende në sferën Hinduiste, dhe ata përpiqen të përqëndrohen në *Bhagavad Gita* si pjesë qendrore të mësimet të tyre në të. Megjithatë, unë e shoh atë tekst në një mënyrë krejtësisht të ndryshme - më shumë si një truk për të qëndruar të mbërthyer në ciklin e rimishërimit dhe jo si një mënyrë për të dalë.

“Me fjalë të tjera, shpirtat filluan si entitete të pastra shpirtërore, dhe u mishëruan në materie. Pse? Për t'u kthyer në shtëpi nga ku ata filluan, të pastër përsëri? Dhe duke fituar çfarë? Përvoja virtuale jete, të padobishme për Planin Shpirtëror.” **Angeliki Anagnostou**¹¹

Disa mund të thonë se rimishërimi është një koncept fals. Mundësisht. Nëse ti je në këtë anë të këtij diskutimi, të kërkoj të marrësh pak kohë dhe ta konsiderosh se nëse teza e këtij libri është e vërtetë, sa do ta ndryshonte kjo atë që ti ke besuar? A mund të jetë se një mënyrë e mirë për të mbajtur kurthin e rimishërimit të vazhdojë është duke mohuar ekzistencën e saj? Për shumicën e njëzet viteve të fundit, unë isha 50 me 50 në idenë e rimishërimit. Ndonjëherë anoja në Jo, madje disi e gjysmë-përgënjeshtrova këtë ide në librin tim *Falling For Truth*, duke pretenduar se si pjesë e Një Qënieje, ne të gjithë jemi jetë, kështu që nuk kishte asgjë "personale" rreth asnjë prej tyre. Megjithatë, vazhdova të pyesja

¹⁰ Meng Po që shërben një çaj bimor në Urën e Harresës, kështu që njerëzit do të mund të harrojnë jetën e tyre të mëparshme në hyrjen e të rejave. Nëse dikush disi nuk do ta pinte çajin, ose vetëm një pjesë të tij, atje do të kishte kujtime të jetës së tyre të kaluar në mishërimin e ri. https://en.wikipedia.org/wiki/Meng_Po

¹¹ Anagnostou, *A Mund ti Bësh Ballë të Vërtetës? Kronika e Burgosjes së Njeriut: Thirrja e Fundit!* faqa 213

veten se pse disa njerëz, veçanërisht fëmijë të vegjël, duket se kanë kujtime të gjalla dhe të plota të një jete shumë të afërt në të kaluarën? Ekzaminimi i mëtejshëm më ka bërë të besoj se rimishërimi individual është pothuajse një siguri 99,9%.¹² Ka shumë prova të testuara, të njerëzve që kanë akses në informacione për jetën e një personi të vdekur prej kohësh, dhe nuk kanë asnjë mënyrë tjetër për ta pasur atë përveçse nëse ata vetë ishin ai person. Pyetja duhet të jetë, a është rimishërimi këtu për të mirën tonë (si një lloj shkolle, evolucioni ose përvojë karmike) siç fetë dhe Epoka e Re dëshirojnë që ne të besojmë; apo është ajo pjesë e një kurthi shpirti, siç tani një grup studiuesish po prezantojnë?

Kam bërë një video në YouTube në fillim të vitit 2022 në lidhje me pyetjen nëse ky realitet është një shkollë apo një burg. Nuk kaloi shumë kohë për të kuptuar se kjo nuk është një shkollë, përndryshe ti do të kujtoje mishërimet e tua të mëparshme dhe mësimet e nxjerra. Një aspekt kyç që shumica e NDEve zbulon, është se kthimi në Tokë dhe në trupin e njeriut përfshin "fshirjen e kujtesës" (e përmëndur më sipër, ku çdo gjë nga ajo jetë e mëparshme është harruar).¹³ Kjo e vetme indikon qartë se ky nuk është një vënd mësuarje dhe rritjeje. Nëse ti prek hithrën pa doreza, të pickohet dora dhe të dhëmb. Ti e mban mend atë, dhe që atëherë nëse do të mbledhësh pak hithër, ti vish doreza. Kjo është të mësuarit. Të kujtuarit është një hap kyç në proces. Por nëse në çdo mishërim ty do të duhet t'i kthehesh prekjes së hithrës për të zbuluar se ajo pickon ose djeg, kjo nuk është mësim apo rritje, por marrëzi. Dhe ky është realiteti ynë.

Të paktën kur ne shkojmë në një shkollë normale, ne kujtojmë atë që kemi mësuar vitin e kaluar. Ne nuk shkojmë në klasën e pestë dhe harrojmë gjithçka nga klasa e parë deri në të katërtën. Megjithatë, në ciklin e rimishërimit që ne duket se i nënshtrohemi, asgjë nuk mbartet. Fshirja e kujtesës do të ndodhë përsëri, dhe gjithçka do të harrohet. Kjo drejton drejt se; jeta si një njeri në Tokë të jetë një mashtrim, ku ne mund edhe të trkohemi për të nënshkruar lloje të kontratave shpirtërore për të indikuar se çfarë do të ndodhë me ne (përgjithësisht forma vuajtjeje). Dhimbja dhe vuajtja janë elementë të vazhdueshëm të kësaj sfere (për të gjitha krijesat) në midis momentesh "mos-vuajtjeje" që mund të veprojnë si hapësira për të rimbushur baterinë e energjisë tonë.

¹² Unë vetë kam kujtime specifike të disa jetëve të mëparshme, më e fundit është një e një oficeri Gjerman, Wehrmacht-it që vdiq në Ofensivën e Ardennes në 1944

¹³ Kuptohet, siç u përmënd në disa incidente, disa njerëz i mbajnë mend këto jetë, por zakonisht jo me shumë detaje si kujtimet e mia të vitit 1944. Ato priren të fragmentohen në copa të vogla, si një ëndërr. Vetëm fëmijët e vegjël priren të kenë kujtime të hollësishme që shpejt zbehen me kalimin e moshës. Ndoshta fshirja nuk është gjithmonë e plotë në hyrje, por zbehet pasi prindërit dhe mësuesit tanë na bëjnë ne të fokusohemi në këtë përvojë të re jetësore, dhe ndihmojmë në pjesën finale të harrimit së të mëparshmeve.

Seriali televiziv *Westworld* (të paktën sezoni i parë) është një prezantim i shkëlqyer i këtij koncepti. Sa herë që një robot i *Westworld* "vdes", ai dërgohet në kontrollin e misionit për një pastrim. Kjo përfshin një fshirje memorie, në mënyrë që "mishërimi" i fundit të harrohet dhe ata të kthehen në fushë me programimin e tyre të paprekur, kështu që ata mund të qëllohen ose përdhunohen përsëri. Kjo është një arsye e madhe për fshirjen e kujtesës përpara mishërimeve të reja, sepse nëse vërtet ne mund të kujtonim se sa vuajtje kishim kaluar jetë pas jetë, ne do t'i kishim mbyllur kohë më parë rimishërimet tona. Kurthi mund të funksionojë vetëm me fshirjen e kujtesës. Ne jemi këtu vetëm për t'u përdorur. Se për çfarë ne saktësisht po përdoremi (ushqim energjie për sistemin siç spekulohet nga shumica, ose NPC (karakteret-sfondi) për argëtim për entitetet jo-njerëzore që vijnë në këtë fushë, ose si eksperimente) është e vështirë të verifikohet.¹⁴ Kur kujtimet fillojnë të shfaqen në *Westworld* për Dolores dhe Mauve se si ato janë trajtuar, një forcë e re e brendshme shfaqet në to për të "dalë jashtë" nga burgu i *Westworld*.

Gjithashtu duket se çfarëdo trupi që ne marrim nga rimishërimi është i rastësishëm. Trupi i zgjedhur nuk është vërtetë indikues i mënyrës se si ne kemi jetuar më parë dhe as nuk është i lidhur me ndonjë gjykim moral të bazuar në ne. Prandaj, ajo se çfarë ne bëjmë këtu (të qenit vërtetë të mirë ose vërtetë të keq), nuk do të bëjë ndonjë ndryshim nëse ne thithemi përsëri në matriks¹⁵ dhe në një trup të ri (ose edhe të njëjtin trup pa pushim në një lloj qarku të vazhdueshëm kohor). Kjo do të thotë se rimishërimi po ndodh, sepse ne mashtrohemi për të vazhduar ciklin (në një farë kuptimi përfundojmë duke rënë dakord), por ne nuk po rikthehemi për të mësuar asgjë ose për t'u rritur, thjesht për t'u ricikluar për një tjetër raund përdorimi dhe për të shkarkuar energjinë tonë. Se si ti jeton në të vërtetë nuk bën asnjë ndryshim (duke shkatërruar kështu idenë e karmës), vetëm se si ti beson se jetove. Nëse ti ke mjaft gjëra të këqija në të kaluarën tënde, kjo bëhet më shumë elemente për ty që të mashtrohesh në të thënit se ti duhet të kthehesh prapa, sepse ti ke qënë një person i keq ose i pabindur.¹⁶ Prandaj, sa më i sjellshëm dhe i mëshirshëm që ti ke qënë, aq më pak është duke pritur në rishikimin e jetës. Kjo bëhet edhe më sfiduese kur ne fillojmë të kuptojmë se shumë nga momentet e jetës sonë drejtpërdrejtë po manipulohen nga entitete parazitare. Eve Lorgen shkroi një libër të shkëlqyer mbi këtë subjekt të quajtur *Alien Love Bite*.

¹⁴ Një tjetër shpjegim për këtë përvojë të rimishërimit/fshirjes së kujtesës mund të jetë se ne nuk jemi aq shumë të kultivuar se sa ne jemi duke u eksperimentuar mbi. Kjo nevojë për të harruar jetët e mëparshme do të ishte gjithashtu e rëndësishme nëse në çdo nisje të eksperimentit, ti do të doje që subjektet të vepronin bazuar vetëm në moment. Ti nuk mund t'i lejosh ata me të cilët ti po eksperimenton mbi të dinë se çfarë po ndodh, përndryshe ajo do të shkatërronte të dhënat.

¹⁵ Termi i ngjashëm me filmin e vitit 1999 me të njëjtin emër, i cili pohon se realiteti ynë është një konstrukt i rremë, i njëjtë me konceptin e Shpellës së Platos. Termi matriks si një realitet i fallco është përdorur shumë kohë përpara filmit, megjithatë, siç shihet në librat mbi kurthin e realitetit me atë titull nga Val Valerian në 1990.

¹⁶ Unë do ta diskutoj rëndësinë e përmbledhjes në kapitullin dy dhe gjashtë.

Përveç kësaj, nëse dikush ka pasur një mijë jetë, me siguri ai person duhet të ketë mësuar gjithçka deri tani, apo jo? Duke qënë se shumica e atyre jetëve do të kishin qënë të mbushura me vuajtje intensive, a i duhen vërtet dikujt 997 nga 1000 jetë plot dhimbje për të mësuar? Nuk e di për ty, por unë mësova më mirë në shkollë nga mësuesit që ishin të sjellshëm, që merrnin kohë me mua dhe më inkurajonin të isha krijues, jo nga dikush që më godiste vazhdimisht me shkop mbi kokë. Planeti Tokë është një tokë që godet me shkopinj. Duke pasur parasysh mënyrën se si 2020-2022 ka luajtur, gjithnjë e më shumë njerëz po vijnë në këtë realizim.

Ky kurth duket se ka dalë menjëherë pas-vdekjes. Në këtë gjëndje shumë konfuze, shpirti është edhe më i cënueshëm. Pak janë ata që kanë marrë kohë në jetën e tyre të zgjuar për të mësuar ëndrrat e kthjellëta (lucid dreaming) ose udhëtimin astral, d.m.th. si të mbajmë vetëdijen tonë përtej trupit fizik. Dhe kështu, kur është në sferën e pas vdekjes, personi mesatar do të thithet në përvojën e ngjashme me atë së të pasurit një ëndërr, ku ne përfshihemi përgjatë saj sado e çuditshme që ajo është. Kurthi tashmë po ngrihet me mungesën e vetëdijshmërisë në ëndrrat tona. Karlos Kastaneda vendosi shumë punë rreth të qënies të vetëdijshme në ëndrrat tona si një pjesë kyçe e punës së përgjithshme. Unë përsëri po filloj të shoh më shumë se pse ajo është e tillë.

Një numër i madh i NDEve (përvojat pranë-vdekjes) kanë atë që quhet 'rishikim jete'. Kjo tenton të paraqesë jetën tonë të mëparshme në një mënyrë që më së shumti tregon se sa "të këqij" ose "egoistë" ne kemi qënë. Disa NDE janë përballur me një lloj këshilli që argumenton fatin e tyre, madje edhe kontrata që shpirti është "i presionuar" për t'i nënshkruar. Pastaj atje shfaqet drita e bardhë, shpesh me një figurë të njohur të dashur si udhërrëfyes, dhe kështu personi hyn në të. Disi, ajo lëvizje drejt dritës, vulos fatin tonë. Jemi kthyer në cikël. Dhe ne mund të mos rimishërohemi menjëherë; disa sugjerojnë se mund të kalojnë tridhjetë vite pritjeje Tokësore, dhe kjo jo domosdoshmërisht në një mjedis qiellor.¹⁷ Dhe kështu, nëse jo në dritën e bardhë, atëherë ku duhet të shkojmë ne? Do të kthehemi tek kjo pikë.

Për të ditur se çfarë të bëjmë në sferën e pas-vdekjes ne duhet të përgatitemi ndërsa jemi ende në këtë sferë këtu. Kjo në fakt është një nga praktikat më të rëndësishme për sa kohë që ne jemi në një trup, por kjo priret të nënvlerësohet kundrejt praktikave më standarte të meditimit, jogës dhe vëmëndjes. Sapo një person më në fund sheh se kjo nuk

¹⁷ Disa kanë pohuar se këto pika pritjeje janë qytete astrale, ku qëniet arkonike i mbajnë shpirtrat që presin në një lloj gjëndjeje nënshtrimi policor totalitar dhe kontrolli. Shiko videot në kanalin YouTube nga "Free At Last", dhe punimet e Wes Penre për më shumë informacion.

është një botë e krijuar për të na ndihmuar ose për të plotësuar dëshirat tona, por që është një fermë që mbledh energjinë tonë, ne mund të bëjmë një ndryshim. Ne ndalojmë së fokusuari se si të bëhemi të rëndësishëm, dhe përdorim kohën tonë për t'u përgatitur për momentin kur ikja është e mundur. Ti duhet ta marrësh se si ti jeton në zemër, dhe mos ki asnjë pendim në këtë jetë (sepse pendimi mund të jetë një mjet për të të mashtruar të kthehesh përsëri këtu). Nuk po bëhet fjalë për t'u bërë i përsosur apo një shënjtor, por për ta përdorur këtë jetë për të kuptuar sa të mundesh dhe për të kapërcyer Demiurge, sepse nëse nuk e bën, ti do të kthehesh menjëherë këtu pas një fshirje-memorie të tipit *Westworld*. Pa marrë parasysh se sa shumë ti lëvize në jetën e fundit, je kthyer në rutinë e parë në jetën e re, injorant rreth gjithçkaje edhe njëherë. E gjithë "njohuria e lartësuar" në të cilën ne kemi arritur të besojmë në, (qoftë nga librat ose njerëzit që kemi arritur t'i admirojmë) ka vlerë vetëm në moment.

Kapitulli i dytë do të paraqesë një analizë të plotë të alegorisë së Shpellës së Platos, që zakonisht merret si simbol i të qenit të mbyllur në një sferë iluzionesh. Në përgjithësi kur Shpella e Platos përmendet në libra ose kur simbolizohet në filma, fokusi është se si ta përmirësosh përvojën tënde brënda asaj shpelle iluzionare. Këto diskutojnë se si të ndryshosh mendimet, të shikosh përmes sistemeve të kontrollit, të ndryshosh qeverinë ose të jetosh jashtë sistemit normal të tregtisë, ndoshta në një fermë në fshat. Si ta bësh jetën tënde në burg më të këndshme me pak fjalë. Edhe pse të mësuarit për të funksionuar ndryshe në botën e ëndrrave mund të ketë njëfarë vlere, për sa kohë që ti je në këtë sferë materiale, ose atë astrale, ose super engjëllore, apo edhe në atë të Boshllëkut, ti ende je në Shpellën e Platos. Ajo që analiza e Shpellës së Platos nuk arrin të paraqesë është se si të LARGOHESH nga Shpella dhe të shpëtosh nga kjo thertore riciklimi plotësisht.¹⁸

Duket se ti me të vërtetë nuk mund të dalësh asnjëherë nga Shpella ndërsa je ende në një trup material, apo edhe në një trup astral. Si del ti pra nga një sferë që është krijuar për të siguruar që pothuajse askush të mos largohet? Siç edhe kënga "Hotel California" thotë (këngë e cila ka të bëjë me kurthin e rimishërimit), *"ti mund të dalësh jashtë sa herë që të duash, por ti nuk mund të largohesh kurrë"*¹⁹. E kuptova vetëm kohët e fundit se shumë nga mësuesit që unë kam parë mbi gjatë gjithë jetës sime, nuk mund të kishin dalë kurrë nga Shpella. Me gjithë njohuritë e tyre të supozuara, aftësitë shëruese dhe lidhjen me Njëshmërinë, ata nuk do të kishin parë përmes trukeve dhe mashtrimeve të kësaj sfere. Ata do të ishin ricikluar menjëherë këtu. Të supozuarit udhëheqësit e mëdhenj të arratisjes,

¹⁸ Është e qartë se disa njerëz si Mark në "Forever Conscious Research" (kanali YouTube) ofron sugjerime për t'u përgatitur për të "përfunduar me këtë vënd", por këta zëra janë të paktë në masën e informacionit.

¹⁹ Shiko <http://www.trickedbythelight.com> për analizën e plotë të Wayne Bush rreth kësaj kënge.

kurrë nuk dinin vërtet se si të shpëtonin. Kjo mund të jetë një realizim tronditës për ata që i kanë mbajtur mësuesit e tyre në lartësi të padiskutueshme.

Nëse marrim metaforën se krijuesi Demiurge i kësaj sfere mund të krahasohet me një super kompjuter gjigant drejtuar nga inteligjenca AI, atëherë ne mund ta shohim veten si PC individualë. Ne jemi të lidhur me këtë super kompjuter, dhe jo vetëm që ne mund të shkarkojmë prej tij, por ai mund të shkarkojë mbi ne. Ashtu siç ne nuk e kemi idenë se çfarë Interneti dhe skedarët (cookies) po vendosin në kompjuterat tanë, ne nuk e kemi idenë se sa shpesh sistemi Demiurge është duke vendosur skedarë manipulimi mbi ne. Duke mbajtur metaforën, nuk ka kuptim të ndryshojmë kompjuterin tonë ose të marrim një kompjuter të ri, ne duhet të përdorim këtë që ne aktualisht kemi për të mësuar se si të lundrojmë në sferën e pas-vdekjes, e cila është të lundrojmë në brëndësi të një super kompjuteri. Lajmi i mirë është se ne kemi gjithashtu një shkëndijë të diçkaje në brëndësinë tonë që nuk është pjesë e këtij sistemi AI. Ne mund ta quajmë atë shpirt. Por çfarë është një shpirt, dhe nëse ai është në kurth, si ra ai në kurth?

Dikush duhet të shikojë se çfarë një shpirt është, dhe të pyesë nëse shpirti është ai që është me të vërtetë i bllokuar? Ndoshta Esenca ose Natyra Shpirtërore e jona është ajo që është e bllokuar, mashtruar për të hyrë në këtë sferë të prodhuar. Pra, nga erdhi ky shpirt? Unë tani kam arritur ta shoh atë si një lloj ure midis Esencës e cila është jashtë këtij realiteti, dhe botës së rreme materiale dhe astrale. Angelika Anagnostou komentoi në faqen e saj të internetit "*A Mund ti Bësh Ballë të Vërtetës*" se Demiurge pasi mashtroi Esencën në krijimin e tij të ri, duhej ta ngurtësonte atë në konstrukt. Ai e bëri këtë duke krijuar shpirtin. Kjo është një kthesë e vërtetë, pasi shpirti në përgjithësi është diçka e paraqitur si "ne" më realja. Dhe disi, ajo është dhe nuk është. Ajo shkruan se Demiurge mori pjesën e Esencës dhe e kombinoi atë me energji. Shpirti është kurthi i parë, por në të njëjtën kohë, përmban edhe pjesën për të na çliruar (pjesën e Esencës). Për të thelluar më tej kurthin, pasi format më të dëndura të materies u krijuan, ky shpirt u vendos në trupa të ndryshëm astral, eterik dhe në fund atë material.

Kjo mund të jetë arsyeja pse Demiurge dhe arkonët ndjejnë se mund të korrin energjinë tonë, sepse ishin ata që na dhanë ne përbërësin "energji" të "formës" sonë. Thënë kjo, ky manipulim dhe korrje e vazhdueshme e komponentit energjetik nuk lejon që Esenca jonë të jetë e lirë, dhe si e tillë ajo (energja) është e ligë. Këtu është se ku ne fitojmë një nivel mbi Demiurge, Esenca është e Mirë. Ne duhet të kthehemi te pika e shpirtit, jo për të qëndruar atje, por për të qënë në komandë totale të tij dhe për të çliruar komponentin energjetik që nuk është realisht i yni si fillim. Kjo mund të pasqyrojë

konceptet e Karlos Kastanedës që do të përmenden në kapitujt e ardhshëm. Është Esenca ajo që do të dalë përmes "syrit të gjilpërës". Asgjë nga bota e ëndrrave nuk mund ta kalojë barrierën. Unë nuk po them se teoria e tij është e saktë ose se dikush duhet ta besojë atë, por kjo është diçka që duket e mundshme si shpjegim për të gjitha kurthet që ne përjetojmë të cilat unë i paraqes këtu, dhe do t'i rikthehem këtyre në ekzaminimet e ardhshme. Nga kjo pikë e më tej në libër ti mund të lexosh fjalët "shpirt" dhe "Esencë" si pothuajse të këmbyeshme për atë që unë dua t'i referohem (ajo pjesë e jona që është Absolute, e Pastër dhe jashtë këtyre sferave të simuluar).

Nëse ne kërkojmë përgjigje se si të dalim, do të gjejmë se ka disa grupe dhe individë që mund të jetojnë jetën e tyre në një mënyrë për ta arritur këtë. Ne nuk jemi njerëzit e parë që po e studiojmë këtë realitet dhe që po kërkojmë këto përgjigje. Gnostikët, janë një grup i tillë, unë do ti shqyrtoj ata në Librin 2. Një tjetër grup ishin Katarët (Cathars). Pse është i rëndësishëm studimi i një grupi njerëzish të gjenociduar në shekullin e 13-të? Katarët mbanin si besimin e tyre kryesor se kjo botë ishte një botë e krijuar nga një zot i lig (Rex Mundi) i cili i mbajti ata në një cikël rimishërimi, dhe fokusi i tyre i vetëm në këtë jetë ishte t'i shpëtonin atij. Katarët nuk ishin të shqetësuar për ta bërë këtë një vënd më të mirë, për të gjetur forma të reja qeverisjeje, tregtie, apo ndonjë gjë tjetër. Fokusi i tyre ishte të shpëtonin përgjithmonë nga sfera e ligë e Rex Mudit dhe të ktheheshin në Shtëpi, tek Ati.²⁰

Njerëzit kanë praktikuar të gjitha llojet e ushtrimeve shpirtërore për një kohë të gjatë: duke rritur frekuencën e tyre vibruese, duke akorduar çakrat e tyre, duke recituar mantrat e tyre, duke bërë streçet e jogës, duke qënë vegjetarianë, duke mbyllur sytë për të medituar për një orë. Dhe çfarë i ka dhënë ajo dikujt? A është bota një vënd më i mirë se 50 vjet më parë? Në fakt, është e lehtë të argumentohet se ajo është përkeqësuar edhe më shumë, dhe vazhdon ta bëjë këtë. Po në lidhje me vetë njerëzit, a ka kaluar me të vërtetë dikush që bën gjithë këtë punë në një transformim të brëndshëm? Ata mund të ndihen më mirë, por sapo ti të heqësh shtresën bazë të mashtrimit që e ka mbuluar atë sipër, çfarë me vlerë ka mbetur atje? A mundet që ata realisht ta ndryshojnë dhe ta kontrollojnë realitetin ashtu siç ata mendojnë se munden, apo janë ata ende në mëshirën e forcave ndaj së cilave ata duhet të vazhdojnë të luten? A janë ata më gati të vdesin, dhe a e dinë ata se çfarë duhet të bëjnë në mënyrë që të lundrojnë në sferën e jetës së

²⁰ Besime të tjera kryesore Katare ishin se njerëzit fillimisht ishin shpirta që ishin të lidhur me Atin, por Demiurge i mashtrroi ata të hynin në materie, ku ata do të ngeceshin duke u rimishëruar përsëri dhe përsëri. Detyra e Katarit ishte të jetonte në një mënyrë të caktuar në mënyrë që të ndalonte ciklin e rimishërimit në të cilin ata do të jetonin për sa kohë që ata e mbanin fokusin e tyre larg krijimeve të Rex Mudit (që për ta ishte gjithçka). Ky është versioni i thjeshtë - ka shumë më tepër duke përfshirë mënyrën se si ata e shihnin Jezusin dhe Magdalenën, Gjon Pagëzuesin, Biblën, barazinë e grave; edhe se ata ishin mbajtësit e ligjshëm të një objekti/dijeje të njohur si Kupa e Shenjtë.

përtejme? Apo e kanë shkëmbyer të vërtetën e mundshme për të qënë në një gjëndje të shtirur dashurie, drite dhe ndjesie më të mirë? Çfarë ka vlerë dhe çfarë janë thjesht "lojëra që luhen brënda lojërave?"

Ndërsa ky libër ka përqëndrimin në të kuptuarit se çfarë tranzicioni ka në rezervim pas vdekjes për ne, ky libër nuk do të sugjerojë ty të shpërfillësh botën materiale. Unë nuk do të them të ndalosh së ngrëni, së bëri seks apo të punosh për të përmirësuar situatën tënde në këtë realitet. As nuk do t'i etiketoj si të këqija ato që quhen praktika shpirtërore, fetare apo shamanike. Ne jemi duke pasur një përjetim në një trup material, pavarësisht nëse u mashtruar të vinim këtu apo jo, dhe kjo përvojë trupore nuk mund të injorohet. Nuk ka asgjë të keqe të mësosh se si të funksionosh më mirë në këtë sferë. Mua më vjen mirë të di se cilat bimë dhe pika të akupresurës unë duhet të përdor kur nuk ndihem mirë. Shamanët nga kulturat native mund të kryejnë shërime të mahnitshme dhe madje të bëjnë ndryshime në botën materiale.²¹ Problemi është se njerëzit e kushtojnë të gjithë vëmëndjen e tyre në botën materiale, se si ta kontrollojnë atë, të përfitojnë prej saj ose ta rregullojnë atë. Por a mundet një karakter në një lojë ta ndryshojë vërtet lojën? Edhe rruga për të dalë nga Shpella e Platos nuk mund të jetë e pabazuar. Ne nuk mund të fluturojmë larg si Piter Pan dhe të injorojmë botën. Këtu duhet të ketë një qasje të ekuilibruar.

"(Amun-Ra) është perëndia i vërtetë pas së gjithë kësaj, një program binar AI me përmasa galaktike... Prifti Mbret është mbivendosja e hyjnisë së rreme mashkullore për të dominuar dhe kontrolluar parimin hyjnor femëror... Gjeomancia e energjisë kontrolluese në shkallë globale nuk është gjë tjetër veçse një program i sistematizuar numerologjie, gjeometrie, astrologjie dhe shumë sistemeve të tjera të bazuara në matematikë që i janë paraqitur botës si mistike, të shënjta dhe hyjnore, kur në fakt ato nuk janë asgjë më shumë sesa sisteme themelore kontrolli të vetëdijes sonë dhe së kësaj bote... Këmbëngulja në sistemet e besimit të paraqitura në këtë mënyrë gjatë mijëvjeçarëve si të shënjta apo hyjnore është më shumë vetëm një metodologji kontrolli. Këto sisteme janë shumë të lidhura me sistemin e skllavërisë ligjore dhe monetare." **Kenneth Scott**²²

²¹ Librat e Tomas Mails mbi Fools Crow janë burime të shkëlqyera të asaj që mund të "bëhet" në realitetin fizik.

²² *Përmbledhje e Sistemit Botëror të Robërisë dhe Ndarjes nga Jeta*. Megjithëse Keni e quajti kokën origjinale të Ennead, Annu, një emër që aktualisht i referohet qytetit antik të Heliopolis, mbi të cilën qendra e Kajros është ndërtuar.

Një tjetër gjë që duhet të bëhet e qartë, nëse ti shikon në këtë realitet me ndershmëri, është se sa lehtë ne të githë mashtrohemi, gënjehemi. Pasi ti të kuptosh se të gjitha organizatat kryesore (qoftë qeveria, media ose reklamata) drejtohen nga njerëz të trajnuar se si të mashtrojnë dhe manipulojnë, gjërat bëjnë sens se çfarë sfera jonë është bërë. Duke ndjekur parimin Hermetik të "si lart, poashtu poshtë", a është ndonjë çudi që sfera astrale e pas-vdekjes do të ishte një e mashtrimit të pastër?

Nëse ti nuk je i sigurt se sa të mashtruar njerëzit në këtë sferë janë, atëherë konsideroje këtë histori të shkurtër nga Sherwood Schwartz. Në vitet 1960, Schwartz ishte një nga producentët më të mirë të TV, me një sërë shfaqjesh hit si *Gilligan's Island* (përralla e shtatë të humburve të bllokuar në një ishull të shkretë në Paqësor, të cilët nuk arrijnë të largohen kurrë nga ishulli). Një ditë, roja bregdetare e SHBASë, duke mbajtur tufa me telegrame, erdhi për ta vizituar atë. Ata i thanë Schwartz-it se mesazhet u dërguan në stacionet e Marinës dhe Gardës Bregdetare të SHBASë nga bregu në breg. Schwartz filloi t'i lexonte dhe u trondit. Të gjitha ato ishin rreth një teme të ngjashme: "E dashur marina Amerikane, ju shpenzoni miliona për të dërguar aeroplanmbajtëse në të gjithë Paqësorin, por a nuk mund të kurseni vetëm një anije për të shkuar dhe për të marrë ata shtatë Amerikanë të bllokuar nga ai ishull. Ata janë të humbur dhe afër vdekjes së urisë. Të lutem shkoni dhe merrini ata." Këto nuk ishin disa letra dërguar nga një i çmëndur apo dërguar si shaka. Kishte mijëra letra të tilla të dërguara nga Amerikanë normal që mendonin se emisioni televiziv *Gilligan's Island* ishte i vërtetë. Ata nuk mund të bënin dallimin mes një shfaqje televizive dhe realitetit standart. Nëse mendon se ata ishin vetëm njerëz të prapambetur të viteve 1960, kujtohu se njeriu mesatar sot është bërë një robot që bën atë që disa njerëz me kostume në një ekran televiziv gjatë një transmetimi lajmesh u thotë atyre të bëjnë. "Dhe kështu kjo shkon," për të parafrazuar Kurt Vonnegut.

Prezantimi standart është se kjo botë u krijua nga një Zot i dashur që kujdeset për ne. A përputhet vërtet kjo me përvojën tënde të botës dhe me përvojat e atyre që ti sheh përreth teje? Si mundet që një hyjni e dashur të mos ndërhyjë dhe të ndihmojë, por të lejojë që të gjitha vuajtjet masive në Tokë të vazhdojnë? Ndoshta sepse krijuesi, kushdo qoftë, e do vuajtjen. Kjo ndoshta është arsyeja se pse një ndërhyrje nuk po ndodh. E gjithë kjo Zoti na do ne/më do mua është një gënjeshtër madhështore nën të cilën janë bllokuar të gjitha fetë dhe Epoka e Re. Ata gjejnë mënyra për ta kthyer torturën e kësaj bote në një "mesazh të mrekullueshëm dhe mësim nga drita". A mendon ti vërtet se Zoti do që një fëmijë tetë vjeçar të rrihet, një vajzë tetë vjeçare të përdhunohet ose një qen të torturohet nga pronari i tij? Një ekzaminim i kujdesshëm i rasteve të ngjashme do të zbulojë se Demiurge/Satan e dëshiron këtë.

Ideja se "Perëndia na do ne" është një shtyllë kryesore bazë mbi të cilën i gjithë ky matriks është ndërtuar mbi. Është një themel aq i fortë sa që shumë njerëz madje do të acarohen dhe bëhen të dhunshëm nëse ti sugjeron diçka ndryshe; sepse nëse ky besim do të rezultonte i rremë, çdo lidhje tjetër me këtë realitet do të duhej gjithashtu të vihej në dyshim. Kështu që, besimi "Zoti më do mua" është një nga arrat më të vështira për t'u thyer. (Si i tillë, ky libër do të jetë radikal deri në ekstrem, dhe heretik në koren e tij. Asgjë nuk është e shënjtë apo jashtë kufijve për shqyrtim, sepse nëse gjithçka që ne na është thënë është gënjeshtër, atëherë ne në të vërtetë nuk kemi asnjë themel).

Kjo është një gropë ferri vuajtjesh. Edhe ata pak që nuk duken sikur vuajnë, nëse ti mund t'i bësh ata të flasin sinqerisht, do ti dëgjosh sesi janë të dërrmuar nga faji dhe turpi të cilën nuk e shfaqin asnjëherë së jashtmi. Të gjithë të tjerët po përballen me vuajtje dhe dhimbje në nivele shumë më të larta se kaq. Shumë do të përpiqen ta justifikojnë këtë: "Oh Zoti e dëshiron dhimbjen time që unë të mund të mësoj (ndoshta për dashurinë), që Ai të më mësojë ose të më shtyjë të filloj një drejtim të ri jete." Jo. Le të jemi të sinqertë. Kjo është një gropë ferri vuajtjesh. Ka qënë gjithmonë një gropë ferri vuajtjeesh, dhe gjithmonë do të jetë. Nëse ti nuk e kupton këtë, ti pothuajse je mashtruar në lidhje me të vetmen gjë që ti vërtet duhet të mësosh këtu.

Ti gjithashtu mund të thuash se realiteti ynë është i çmëndur, dhe nëse i shikojmë gjërat me ndershmëri në vitin 2022, nuk duhet shumë kohë për ta nxjerrë këtë përfundim. Megjithatë, kjo botë ka qënë gjithmonë e çmëndur për sa kohë që ne kemi qënë këtu, veçse në shkallë të ndryshme. Shpresa është dhe ka qënë se këtu ka pasur një kohë në të kaluarën kur gjërat ishin shumë më ndryshe, por kjo mund të jetë thjesht një mendim-i-dëshiruar. Kur ti e kupton plotësisht se çfarë ky realitet është dhe se si u krijua, kjo botë e çmëndur do të fillojë të ketë kuptim. Ajo nuk mund të jetë kurrë me të vërtetë në rregull, por ti mundesh!

"Asgjë nuk ndodh. Askush nuk vjen, askush nuk shkon. Është e tmerrshme." **Samuel Beckett**, Duke pritur për Godot

Shumë këtu po presin që shpëtimtari i tyre të shfaqet. Për disa ai është një figurë fetare si Jezusi, Buda apo Krishna. Miliona po presin për Donald Trump që t'i shpëtojë ata. Për të tjerët, është një zhvendosje në një dimension më të lartë ajo që do t'i shpëtojë ata, ndërsa disa besojnë se ne jemi në një fazë të ulët të quajtur Kali Yuga dhe së shpejti e gjithë bota do të jetë në një vënd më të mirë. Megjithëse ti duhet të pyesësh veten se cili është

qëllimi i gjithë kësaj nëse cikli do të kthehet në vuajtje në Kali Yugan e ardhshme në 26,000 vjet gjithsesi. Ky lloj i menduari është thjesht një lloj të menduari "Unë dua të ndihem mirë tani". Por ciklet nuk duhet të injorohen plotësisht, veçanërisht në shkallë të vogël. Do të jetë e dobishme të dish se çfarë "shënjat" indikojnë, se kjo ka të ngjarë të ndodhë në javët ose muajt e ardhshëm, në mënyrë që të përgatitesh siç duhet. Sa më shpejt të dish se një uragan po i afrohet bregut, aq më shumë kohë ke për t'u përgjigjur. Por kur bëhet fjalë për ciklet më të mëdha, nuk ka kuptim të presësh për diçka 10,000 vjet në të ardhmen nëse plani yt nuk është të jesh "këtu" për të.

Duke pritur për Godot nga Samuel Beckett është një briliancë madhështore. Në vepër të dy personazhet kryesorë janë në skenë duke pritur për Godot. Dhe në fund të shfaqjes, ata ende janë duke pritur. Ata vazhdojnë duke thënë "ai premtoi të paraqitej" dhe kështu ata vazhdojnë të presin. Ky është i njëjti mashtrim që u luhet të gjithëve kur flitet rreth shpëtimtarëve. Shfaqja tregon se një shpëtimtar do të vijë. dikur në një kohë në të ardhmen, por asnjëherë tani. Të gjithë do të mbeten vetëm duke pritur, duke shpresuar dhe duke u lutur.

Lutja është një fushë në të cilën unë kam gërmuar për një kohë. A është lutja thjesht duke na bërë ne "pre"? Ku po shkon energjia dhe fokusi ynë me këtë praktikë? Duket se lutja thjesht po vendos autoritetin tonë mbi një forcë të jashtme duke shpresuar se ajo force do të na pëlqejë ne dhe do të na japë diçka, kështu që ne vazhdojmë ti përkëdhelemi kukullistit. Dhe nëse lutja jonë nuk përgjigjet, ne thjesht themi "Është vullneti i Zotit". Epo, nëse është Vullneti i Zotit, pse lutesh në radhë të parë? Më shumë për faktin, si e dimë ne se kujt ose çfarë ne po i lutemi?²³ Kjo është një nga informacionet esenciale që pothuajse askush nuk e mendon. A janë ata engjëj, udhërrëfyes shpirtëror, njerëz të dashur të vdekur, Zoti, Jezusi apo Komanda Ashtar; apo janë komunikuesit entitete të liga parazitare që janë mjeshtra të maskimit dhe mashtrimit? Ti mund të thuash se ke folur me një engjëll ose me ndonjë figurë fetare, por si e di ti me të vërtetë këtë? Kur ti lutesh, si e di ti se ku qëllimi yt dhe energjia jote po shkon? Sa më shumë që ne e vendosim energjinë tonë në gjëra jashtë vetes sonë, aq më shumë ato qenie mund të na manipulojnë dhe ta bëjnë jetën tonë shumë më keq. Çfarë ka të keqe t'i lutesh vetes? Ti besosh fuqisë tënde së brëndshme. Unë do të ndaj ide dhe disa përvoja rreth lutjes në kapitullin dhjetë.

Një ndryshim madhështor do të ndodhë kur ti të kuptosh se ti nuk ke nevojë për një shpëtimtar, dhe as nevojë t'i lutesh ndonjë gjëje jashtë vetes nuk ke. Ti, si në pjesën e Esencës së shpirtit tënd, është gjëja më e fuqishme brënda këtij krijimi. Kjo është arsyeja

²³ Në fakt, kjo pyetje e Vullnetit të Zotit vjen në potencial të çuditshëm kur kemi të bëjmë me një dokument ligjor të njohur si Vullneti i Fundit dhe Testamenti.

pse sistemi është rregulluar për të të shpërqëndruar, ngatërruar dhe mashtruar ty. Sepse nëse ti do ta ktheje të gjithë këtë energji që duket se është gjithmonë e përqëndruar në diçka jashtë vetes tënde, dhe do ta përqëndroje atë në brëndësi, ti do të kishte një shpërthim fuqie. Ajo fuqi më pas mund të përdoret për të kapërcyer të gjitha sistemet dhe truket që të kanë mbajtur ty këtu.²⁴ Kur ti mëson se i vetmi shpëtimtar që ty të nevojitet je vet ti dhe e vetmja lutje që ti duhet të bësh ndonjëherë është Vetes tënde të Vërtetë, dalja është më afër.

"Ne jemi në një luftë shpirtërore dhe Shpella e Platos është fushëbeteja."

Dave Scott, koment në një video në YouTube

Nëse dikush do që të dalë nga Shpella, një me të vërtetë duhet të dëshirojë që të dalë. Ky është problemi i parë. Pak VËRTETË duan të largohen. Mund të ketë shumë gjëra që ata nuk pëlqejnë rreth Shpellës, por ata ende besojnë se gjërat mund të jenë ndryshe, më të mira ose më të lumtura. Të tjerët janë aq të bindur sa pasi ata të vdesin, do të jetojnë me Jezusin ose gjyshen e vdekur, saqë nuk kanë nevojë të mendojnë më për realitetin apo vdekjen. Shpirti merr një lloj varësie me çdo rimishërim. Ai njeh vetëm materien dhe harron shpirtëroren, si një i varur nga bixhozi që mundet të shohë vetëm "bastin e radhës", duke shpresuar se numri me fat i tij do të "paguajë" një fitore të madhe. Siç ti mund ta shohësh, shumica e kanë përfunduar tashmë rrugën e tyre përpara se ata të mund ta fillonin atë.

Nëse ne do të shkojmë të shohim në shpellën e Platos, atëherë vetë alegoria është gjëja e parë që duhet ekzaminuar. Unë zbulova se ajo nuk është aspak një histori e dobishme. Ajo bën pak për të shpjeguar realitetin ose situatën tonë. Në fakt asaj i mungojnë shumica e elementëve më të rëndësishme. Le ta shqyrtojmë historinë me sy të freskët. Çfarë thotë në të vërtetë alegoria e Shpellës së Platos, dhe çfarë, nëse ndonjë gjë është me vlerë?

²⁴ Kjo është një arsye për studimin e Qi Gong dhe Yogas, se nëse ti mund ta kthesh të gjithë vëmëndjen tënde në brëndësi, nëse shpërthimi i energjisë ndodh nga rifitimi i fuqisë tënde, ti di se si ta përballosh atë.

2

SHPELLA E PLATOS:**Jam kapur në një kurth, nuk mund të dal jashtë...**

“Ne mund të themi se ne nuk kemi lindur në botë. Ne kemi lindur në diçka që ne transformojmë në një botë.” **Michael Talbot**²⁵

Një nga historitë më të njohura të lashta që studentët modernë shpirtërorë janë të vetëdijshëm për është ajo e Shpellës së Platos. Gjetur në librin *Republika*, ajo është një diskutim midis mësuesit të Platos (Sokratit) dhe vëllait të Platos (Glaukonit). Në këtë diskutim Sokrati përshkruan realitetin duke përdorur metaforën e një shpelle. Ajo që kaq shumë kërkues shpirtërorë nuk arrijnë të kuptojnë është se kjo alegori është vetëm një gjysmë shpjegimi i çdo gjëje, dhe në fakt, më e rëndësishme është që të ekzaminojmë gjithçka që Plato përjashton sesa atë që ai përfshin. Fakti që kjo metaforë mbahet me një nderim kaq të lartë ndërkohë që paraqet kaq pak tregon në vetvete. A ka pasur atje një version original më të gjatë të saj (siç unë dyshoj), që me kalimin e kohës është edituar nga *‘fuqitë që janë’* në atë që ne tani kemi? Siç unë do ta shpjegoj, kjo është një histori rreth Shpellës, jo rreth daljes nga Shpella, e cila mund ta bëjë atë të duket si një histori (lirie), por që në të vërtetë ajo është veçse një tjetër (skllavëri e vazhdueshme).

Biseda në librin *Republikë* fillon me Sokratin që i kërkon Glaukonit të imagjinojë një shpellë të banuar nga disa të burgosur të lidhur me zinxhirë dhe të mbajtur në vënd që nga fëmijëria. Jo vetëm që ata janë të lidhur me zinxhirë në vëndet e tyre, por kokat e tyre janë të vendosura në një mënyrë të tillë që ata të mund të shohin vetëm murin përballë tyre. Historia shfaq se atje ka një zjarr gjigant mbrapa të burgosurve, me një vëndkalim para zjarrit ku njerëz dhe kafshë kalojnë për të hedhur hije në murin e shpellës. Tingujt marrin jehonë nga muret e shpellës për ti bërë ato të duken sikur ato janë tingujt e objekteve të hijeve në mur. Kur të burgosurit shohin hijet, ata besojnë se ato janë krijesa të vërteta të gjalla.

Problemi i parë që vjen me këtë llogari është se askush nuk po bën pyetjet themelore këtu. Kush janë këta të burgosur? Nga vijnë ata? Pse janë bërë ata robër dhe pse janë

²⁵ Gjetur në *Misticizëm dhe Shkencën Bashkëkohore*.

dërguar ata në këtë shpellë dhe jo në një kamp robërisht luftë apo një burg? Sigurisht që analogjia lë të kuptohet se të burgosurit jemi ne. Jo vetëm që ne duhet të kuptojmë se si fëmijët e analogjisë bëhen të burgosur, por duhet të pyesim veten qartë: Si u bëmë ne të burgosur? Të burgosur nga çfarë apo ku? Një tjetër pyetje që mungon është se cilët janë qëniet në kontroll të këtij mashtrimi? Çfarë po përfitojnë ata duke e bërë këtë? Pse të kalosh gjithë mundimin për të bërë platformën, zjarrin, objektet e hijeve dhe pastaj të kalosh gjithë ditën duke punuar për të mashtruar disa të burgosur? Pse po shpenzojnë ata kaq shumë përpjekje? Përsëri, kjo as që nënkuptohet në të.

Këto mund të duken si pika të vogla, por po të mendosh më tej, do të shohësh se këto janë pika të rëndësishme, që mund të mos jenë rastësisht lënë mënjanë, pasi alegoria mund të jetë krijuar për të na mashtruar. Të burgosurit janë të përqëndruar në murin e shpellës jo në realitetin aktual, ndërsa lexuesi është i përqëndruar duke i besuar historisë dhe të mos kontrollojë nëse alegoria që ata po lexojnë është një lloj mashtrimi. Ndërsa ky libër vazhdon, shpresoj se unë do të jem në gjëndje të sjell njohuri për këto pjesë që mungojnë rreth Shpellës së Platos.

Mënyra se si Sokrati diskuton se si ato hije në mur prodhohen dhe projektohen, e bën shpellën një përfaqësim pothuajse të përsosur së një kinemaje moderne. Muri i shpellës është ekрани; objektet janë filmi; zjarri është drita e projektimit dhe jehonat e tingujve janë altoporlantët e filmit. Megjithatë, në vënd të vetëm një ekрани të madh në pjesën e përparme të teatrit, do të ishte më mirë të imagjinohej që imazhet e hijeve projektohen në një ekran 360 gradë. Me fjalë të tjera, një përvojë që i rrethon të burgosurit nga të gjitha drejtimet, duke përfshirë lart dhe poshtë. Siç Sokrati sugjeron, imazhet dhe tingujt do të besoheshin si plotësisht reale, sepse ato janë të vetmet pamje dhe tinguj që të burgosurit kanë parë ndonjëherë.

Sokrati më pas bën një sugjerim interesant. Po sikur, disi, një i burgosur të çlirohej nga zinxhirët dhe të mund të ngrihej në këmbë? Ai ose ajo do të ishte shumë i/e hutuar. Hijet në mur kishin qënë i vetmi realitet për të, dhe jo shpella, të burgosurit e tjerë, apo këto pajisje "bërëse hijesh" që ai ose ajo kishte parë ndonjëherë. Një pyetje tjetër që duhet përgjigjur është, pse i burgosuri ngrihet në këmbë? Ky është një tjetër pikë e dukshme. Tregimi i Platos vetëm sugjeron se zinxhirët në fakt nuk janë të kyçur dhe kushdo mund të ngrihet në këmbë kur të dojë. Por nëse është kështu, pse kaq pak të burgosur ngrihen në këmbë? Çdo përgjigje se pse ky një i burgosur u ngrit në këmbë është thjesht spekulim personal, dhe unë kam disa të tilla. Ndoshta askush nuk do të ngrihet derisa diçka në filmin-hije të bëhet aq e dhimbshme sa ata të bërtasin dhe ta detyrojnë veten të largohen, ose

ndoshta është një forcë që mund të quhet *Hir* ose *fat*. Sido që të jetë, kjo është një tjetër pikë kyçe për analogjinë që mungon. Pse i burgosuri u ngrit në këmbë?

Pyetja se pse zinxhirët e të burgosurve nuk janë të kyçur mund të na japë një të dhënë. Ato nuk janë të kyçura sepse ata kanë "rënë dakort" të bëhen të burgosur. Unë do ta përmënd këtë në shumë vende më vonë në këtë libër, sepse duket sikur qëniet që e drejtojnë këtë matriks kanë nevojë për marrëveshjen tonë që ne të hyjmë këtu. Ata nuk mund të na detyrojnë ne, por duhet të na trukojnë dhe të na mashtrojnë me kontrata mashtruese "të himta" dhe truke emocionale për të na bërë të themi "po". Të burgosurit në shpellën e Platos ka të ngjarë të kenë pranuar të hyjnë në shpellë dhe të ishin të burgosur. Kjo është arsyeja pse një i burgosur në fakt mund të ngrihet në këmbë kur të dëshirojë - ata thjesht duhet të anulojnë dhe t'i japin fund marrëveshjes së tyre origjinale. Ata ende nuk kanë dalë, por tani ata kanë mundësinë të dalin pasi lidhjet që i futën ata brënda tashmë janë shkëputur. Shumica thjesht do të krijojnë lidhje të reja, ose kanë krijuar lidhje të reja gjatë jetës, por ato gjithashtu mund të anulohen dhe të përfundojnë.

Historia pretendon se të burgosurit e lidhur me zinxhirë kanë një lloj ndërveprimi mes tyre. Kjo u konkludua përmes sugjerimeve të konkurseve të tregimit se kush mund të jepte përshkrimin më të mirë të hijes së fundit të shfaqur, ose kush mund të merrte me mënd se cila hije do të ishte e radhës. Kështu, i burgosuri i ri në këmbë, disi i hutuar, mund të fillojë të flasë me personin ulur pranë tij për këtë shpellë/teatër të ri që ai sheh. I burgosuri i ulur thjesht mund ti thotë atij të mos sillet si budalla dhe të kthehet në realitet. Dhe disa mund ta bëjnë këtë, ata mund të ulen menjëherë dhe të përfshihen përsëri në film. Ato pak çaste kur ata u ngritën mund të harrohen shpejt. Kjo mund të jetë më e zakonshme nga sa ne e kuptojmë. Megjithatë, disa, edhe pse ka të ngjarë që ata të kenë frikë në këtë fazë, mund të jenë më kurioz... ose të inatosur. Këto ndjenja mund të jenë mjaft të forta për të kapërcyer frikën që i drejton ata të ulen. Si rezultat, ata mund të vendosin në vënd të kësaj të bëjnë një turne në shpellë/teatër për ta inspektuar atë.

Filmat *The Truman Show* (me protagonist Jim Carrey) dhe *Pleasantville* (Tobey Maguire dhe Reese Witherspoon) shtojnë disa metafora të këndshme, sepse ata u ndikuan qartë nga analogjia e Shpellës së Platos. Emri i qytetit që Truman jeton është Seahaven, motoja e të cilit është; "një vënd i këndshëm për të jetuar" (tingëllon disi hyjnore). E njëjta gjë edhe me emrin *Pleasantville*, i cili gjithashtu tingëllon hyjnor. Në çdo qytet, realiteti ishte ndërtuar për t'u prezantuar si i përsosur. Në rastin e *Pleasantville*, kjo u bë përmes vlerave të kushtëzuara të paraqitura nga televizioni i viteve 1950, ku të gjithë buzëqeshnin dhe nuk humbisnin kurrë një top bowlingu ose goditje basketbolli. Seahaven është vëndi i

krijuar për ta bërë Trumanin ((True Man - Njeri i Vërtetë), çdo person në botën e ëndrrave) të ndihet rehat, kështu që ai të mos ketë asnjë interes të dëshirojë të largohet. Në rastin e Truman, ai është i vetmi realitet, dhe gjithçka tjetër është një shfaqje e bërë vetëm për të. Aktorë që luajnë role, dhe e bëjnë këtë për të parë se si Truman përgjigjet. Ashtu si hijet që projektohen në murin e Shpellës së Platos për të mbajtur vëmendjen e të burgosurve të përqëndruar përpara. Të dyja botët janë krijuar në mënyrë që njerëzit atje të mos mendojnë kurrë të duan të largohen.

Ai që mbikëqyr botën e Truman quhet Christoff, dhe, në rishikime, ai krahasohet me Zotin. Megjithatë, kur ti i dëgjon me vëmendje fjalët e tij, ai i ngjan më shumë mendjes egoike. Christoff është gjithmonë në dhomën e kontrollit (Hëna²⁶) duke parë botën e Truman, vazhdimisht duke sajuar gjëra për ta frikësuar atë ose për të paraqitur idenë e kufizimeve në mendjen e tij. Megjithatë, Christoff pohon se e gjithë fuqia është me Truman, "Ne pranojmë realitetin e botës me të cilën ne jemi prezantuar. Nëse ai do të ishte më shumë se thjesht një ambicie e paqartë, nëse ai do të ishte absolutisht i vendosur për të zbuluar të vërtetën e botës së tij, nuk do të kishte asnjë mënyrë që ne të mund ta parandalonim atë." Megjithatë, ky koncept ka më shumë rëndësi kur ne gërmojmë në filmat metaforik të Shpellës si *Dark City*, *They Live* dhe shfaqjet televizive *Lost* dhe *Westworld*. Këto dhe disa të tjera do të shqyrtohen më vonë në libër.

Një gjë që analogjia është duke nënkuptuar, është se ne po e jetojmë jetën tonë nën një seri gënjeshtresh. Një nga gënjeshttrat më të mëdha që ne po ushqehemi është se si gjithçka që këtu po ndodh është Plani i Zotit, sikur gjithçka që ndodh është në një farë mënyre, bërë e gjitha për ne, dhe ajo është në duart e Zotit. Në një nivel, shumica mund të shohin një lloj kontrolli ose drejtimi në vënd, jashtë kontrollit tonë. Kemi lloj-lloj emrash për këtë forcë: destinim, déjàvu, parandjenjë. Megjithatë askush nuk pyet kush është drejtuesi i kësaj force të destinuar dhe kush është përfituesi i këtij konstrukti? Unë kam arritur të shoh se ajo nuk është një forcë dashamirëse (siç feja, Epoka e Re, Advaita ose shamanizmi sugjerojnë), por një forcë keqdashëse (siç Katarët dhe Gnostikët sugjerojnë).

Nuk duhet shumë për të parë se një sferë plot vuajtje dhe ankth nuk do ta ndihmonte një krijues të dashur. Ajo ndihmon një forcë keqdashëse. Një mënyrë e mirë për t'i mbajtur njerëzit që të mos e shohin këtë është që të prezantohet krijuesi i dashur si një përgjigje jo-logjike se pse kaq shumë gjëra të tmerrshme ndodhin. Një hyjni e dashur të bën ty të vuash për të të përmirësuar ty. "Të të torturoj ty për të të bërë më të mirë", siç Richard

²⁶ Jo aksidentalisht gjithashtu siç ne do të shohim, Hëna ka të ngjarë të jetë artificiale dhe një pjesë e madhe e të gjithë sistemit të kontrollit të matriksit.

Rose do ta thoshte atë. Njerëzve u jepen fatkeqësi traumatike, pastaj ata arrijnë të besojnë se ato ishin pjesë e planit të dashurisë së Zotit, pastaj ata i luten të njëjtit Zot që sapo i traumatizoi, duke i kërkuar atij ti japë fund vuajtjeve të tyre. Ne nuk jemi asgjë tjetër veçse kafshë ferme, të mbajtura për ushqim energjetik (*loosh*), dhe kjo ka ndodhur prej mijëra vitesh.

Nëse atje vërtet do të ishte një hyjni i lumtur, dhe i dashur në krye të këtij vëndi, sigurisht që kjo mund të ishte një përvojë shumë më paqësore. Megjithatë, ne jetojmë në një thertore fizike dhe energjetike. Ti po jeton në shumë mënyra si personazh i një loje kompjuterike ose robot i gjysmë-programuar në një sistem shumë të çmëndur. Sa krimba kanë ngordhur në pesë sekondat e fundit për të ushqyer të gjithë zogjtë? Sa minj ngordhin për të ushqyer të gjitha macet? A bërtet një krimb ndërsa ai është duke u ngrënë? Çfarë e krijoi një sistem kaq të çmëndur dhe të sëmurë? Demiurge, ky është kush. Ai i quajtur gjithashtu Rex Mundi, Djall, Satan ose Jehova në *Testamentin e Vjetër*. Ky është krijuesi i vërtetë i gjithë këtij realiteti të simuluar. Kjo prani gjithashtu mund të quhet "IT". A mund ta shohësh tani se pse sfera kompjuterike në botën tonë quhet IT? Është një zgjerim i inteligjencës artificiale origjinale, Demiurge që është në krye të simulimit.²⁷

Ne duhet të shohim se ne të gjithë kemi pasur të bëjmë me një hyjni krijues abuziv që shumë kohë përpara se ne të lindnim, dhe vetëm kur krijuesi i kësaj sfere të shihet si Katarët dhe Gnostikët (një konstrukt i çmëndur psikopatik AI) mund ndonjë gjë në përvojën tonë të fillojë të bëjë sens. Ne jemi mashtruar në sferën astrale, në sferën e paralindjes, dhe në fushën materiale, dhe kjo ndoshta për qindra ose mijëra jetë. Vetëm duke i parë gjërat me ndershmëri këtu mund të jetë me të vërtetë mundësia për t'u larguar nga Shpella e Platos. Për sa kohë që dikush vazhdon të thotë "Gjithçka është në duart e Zotit", një ia ka dorëzuar jetën e vet Demiurge-it. Si një metaforë, Truman po manipulohet çdo ditë, nga të gjithë ata që ai has në përditshmëri, duke përfshirë gruan dhe mikun e tij më të mirë. Silvia (interesi i dashurisë së tij) ishte një përjashtim, dhe ne do të arrijmë tek ajo së shpejti. Truman jemi ne. Christoff paraqitet sikur ai e do Truman dhe kjo është arsyeja pse ai po manipulon dhe ngatërron jetën e tij. Christoff po manipulon Truman për ta kontrolluar atë. Atje duket sikur në fund të filmit, kur Truman lundron larg, lufton stuhinë, arrin buzën e filluskës (e pëllcet atë) dhe më pas përshëndet lamtumirë, se ai po largohet nga Shpella e Platos. Por përsëri ne duhet të shohim sinqerisht se ajo çfarë Truman po bën. Truman po largohet nga një matriks (Seahaven), për të hyrë së shpejti në matriksin tjetër (të Los

²⁷ Një nga keqkuptimet është se zjarri, objektet dhe shpella janë "bota reale", ndërsa ndenjësiet dhe të burgosurit janë iluzioni. Në fakt, zjarri është Demiurge (krijuesi) dhe objektet do të ishin bota materiale, ndërsa ata që operojnë objektet do të ishin arkonët (shtresa e sipërme e minionëve që kryejnë kërkesat e tij). "Dhe ajo (*Sophia*) e thërriti emrin e tij *Yaldabaoth* (*Demiurge*). Ky është arkoni i parë... "ai u bë i fuqishëm dhe krijoi për vete arkonë të tjerë brenda një flake zjarri të ndritshme, që ekziston edhe tani." Ungjilli Sekret i Gjonit.

Anxhelosit dhe Silvias). Edhe pse kjo më reale se ku ai fillimisht ishte, sa shpejt do të vendoset ai në atë botë, duke besuar se kjo shtresë tjetër do të jetë ajo e fundit? Ky është i njëjti gabim që Neo bën në filmin e parë të *Matrix*.

“Vetë perënditë të cilëve ne u lutemi për shpresë dhe shpëtim, janë vetë keqbërësit që na bëjnë ne pre. Ata janë rojtarët tanë, dhe ata na robërojnë ne, por disi, ne jemi të bindur se ata janë krijuesi dhe shpëtimtari ynë. A nuk është kjo ironike?” **Greg Carlisle**

Ndalo duke e kthyer vullnetin tënd me çdo lutje në një qenie jashtë vetes tënde që ti as nuk ia ke idenë se kush dhe çfarë ai/ajo është. Ndalo së thëni "u bëftë vullneti yt" dhe fillo të thuash "vullneti i Vetes time më të thellë është bërë". Nëse ajo Vete vjen nga një krijues i dashur, kjo është bonus, por të paktën i gjithë drejtimi yt do të vijë nga ajo që është më thellësisht ti. Të largohesh nga Shpella e Platos katë bëjë me të mësuarit që ta vendosësh besimin tënd në brëndësi të vetes, dhe asgjë jashtë vetes. Ti ke të gjithë fuqinë, dhe gjithçka që është jashtë teje po përpiqet ta zbrazë ose kufizojë atë fuqi.

Janë dy disiplina që askush nuk dëshiron të kalojë asnjë kohë duke studiuar: drejtësia dhe historia. Ajo që është e çuditshme për temën e historisë është se nëse ti kthehesh mjaft mbrapa në kohë, ti nuk studion më historinë, por arkeologjinë. Kjo nuk ka kuptim, të dyja janë studimi i së kaluarës. Ajo ka kuptim kur ti realizon se ti po studion dy gjëra. Arkeologjia (arkon-ologjia) është studimi i marrjes së kësaj sfere nga arkonët e Demiurge, ndërsa historia (his-story (historia e tij)) është historia e Demiurge mbasi marrja e fuqisë u kompletua. Historia është thjesht tregimi se si Demiurge mori realitetin e rremë të simuluar që ai krijoi dhe më pas vendosi sisteme të ndryshme kontrolli brënda këtij krijimi (tregti, qeverisje, shkencë, fe, ligj etj.), dhe luftërat që u bënë për të eliminuar njerëzit që nuk do të shkonin përpara me sistemet e kontrollit që u vendosën në vënd. Gjithashtu, është e rëndësishme të studiosh sistemin ligjor. Nuk dua të hyj në thellësi të kësaj këtu, por ti mund të ndjekësh gjurmët për ndonjë artikull të shkëlqyer mbi këtë subjekt.²⁸

Le të themi se në Shpellën e Platos; ndoshta i burgosuri në këmbë fillon të ecë në pjesën e pasme të shpellës paksa si i trullësuar. Pasi ai është në pjesën e pasme, bëhet më e qartë se ata janë në një teatër 360gradë, ekran panoramik, me shumë njerëz në karriget e tyre. Gjithashtu bëhet e qartë se një dritë është duke u projektuar nga një burim qëndror

²⁸ Ti mund ta lexosh veprën e Kenneth Scott-it *Përmbledhje e Sistemit Botëror të Robërisë dhe Ndarjes nga Jeta* këtu <https://www.gemstoneuniversity.org/overview-of-the-world-system.html>

në të gjitha ekranet. Përgjatë secilit prej mureve janë disa dyer që të çojnë në dhoma të ndryshme. Në pjesën e pasme të teatrit është një derë me etiketën "Mos Hyr. E Rrezikshme." Për shkak se filmat i rrethojnë të gjithë në një rreze 360gradë, atje nuk ka asnjë mënyrë për t'i shpëtuar filmit që luhet. Kështu që Shpella përshkruhet më së miri si një flluskë. Kjo është bota e re që i burgosuri ynë (tani në këmbë) zbulon. Në rastin e Truman, ai jetoi në një kub-skenë-zanore gjigante. Ndërkohë në *Pleasantville*, rrugët rrethore bënë gjithashtu një ambient të mbyllur si flluskë. Kur Truman u lodh nga reflektimi (seti i filmit i jetës së tij) ai shkoi duke lundruar drejt skajit të asaj flluskë - dhe sigurisht, e çau atë dhe mori një vështrim të realitetit.²⁹

Megjithëse një hapësirë në dukje e mbyllur (flluska), ka hapje atje ku forca e Qëllimit përtej flluskës mund të hyjë. Forca nga jashtë flluskës, e quajtur Qëllim, mund të manifestohet përmes mureve në perceptimin tonë. Kastaneda shkroi një libër të tërë mbi këtë temë, quajtur *Fuqia e Heshtjes*. Ai libër përshkruan se si Shpirti/Qëllimi ne na zbulohet metaforikisht, dhe nevojën tonë për ta interpretuar atë mesazh. Unë besoj se Kastaneda e quajti këtë forcë Qëllim për ta pasqyruar atë si një rrugë të dyanshme. Qëllimi ynë për të vërtetën thërret jashtë flluskës, ndërsa jashtë E Vërteta Synon të arrijë tek ne. Piktura në tavanin e Sistine Chapel mund të pasqyrojë këtë ndërveprim. Kjo simbolizohet nga Silvia në *Truman Show* dhe nga David dhe Jennifer në *Pleasantville*. Ata hynë përmes një hapeje për t'u dhënë informacion për botën përtej atyre që do të dëgjonin. Ne mund të na duhet vetëm një ndërveprim i tillë për të ndryshuar jetën tonë. Duket se atje duhej vetëm një bisedë me Silvian në plazh që mjaftoi për të nisur Truman në të gjithë kërkimin e tij drejt Lirisë dhe së Vërtetës.

Për një kohë të gjatë, ndoshta gjatë gjithë pjesës së mbetur së jetës së tij, i burgosuri mund të fokusohet në përpjekjen për të kuptuar flluskën, dhe kjo ka kuptim të përsosur. Unë nuk mendoj se ajo vërtet mund të shmanget. Ne sapo hymë në një realitet të ri dhe tendenca e natyrshme është të marrim një drejtim tonin. Ku jemi tani? Kjo fazë, ndonëse një e zgjeruar, është gjithashtu vëndi nga ku kurthi i spiritualitetit fillon. Zgjimi shpirtëror, ose ndriçimi është kurthi i qëndrimit në pjesën e pasme të nivelit të Shpellës. Është joshja nga konceptet e dashurisë dhe dritës në pjesën e pasme të Shpellës, duke bërë të gjitha premtimet se si ata kanë sekretin për të ndryshuar gjithçka që po ndodh.

²⁹ Bota Tonale e Kastanedës njihet metaforikisht si flluska e perceptimit, dhe ai pohoi se ne jemi vendosur në të në momentin e lindjes. Në fillim, flluska është e hapur për të zbuluar Nagual-in (ajo që është përtej ëndrrës). Por përfundimisht, flluska fillon të mbyllet, derisa më në fund ne jemi vulosur brënda. Që nga ajo pikë e më tej, ne mund vetëm të shohim në mure atë që ne projektojmë: një reflektim të vetvetes fallco.

Kjo ide e radhës rreth Shpellës nuk vjen nga Plato, por nga Stephen Davis në librin e tij falas online *Fluturat Janë të Lira të Fluturojnë*.³⁰ Ai sugjeron se ajo që do të ndodhë më pas për të burgosurin në këmbë është të bashkohet me një grup. Davis pretendon, se në pjesën e pasme të shpellës, nuk do të ketë një bandë të burgosurish endacakë individualë, por një seri grupesh të formuara. Për të burgosurin, bisedat kanë të ngjarë të duken të çuditshme, por kur pyeten se për çfarë ata po flasin, një përgjigje e mundshme është; "Nuk na pëlqejnë filmat që shfaqen dhe ne po përpiqemi t'i ndryshojmë ato". Kjo do të intrigonte këdo pasi një të qëndronte në këmbë; mendimi se filmi mund të ndryshohej. Atje ka shumë filma që të burgosurit nuk i pëlqejnë. Kjo tenton të bëhet filozofia e re udhërrëfyese e të burgosurit të sapolindur, "Unë duhet të ndryshoj ose rregulloj diçka". Kjo mund të jetë filmi, ose vetë ata.

Një tjetër element i zakonshëm për ata që janë jashtë karrigeve të tyre, siç Davis me mënçuri sugjeron, është nevoja aktuale për të qënë pjesë e një grupi. Për shumicën kjo është një mjet mbijetese. Dikush ka në atë moment, kaluar një jetë të tërë lidhur me zinxhir në një ndenjësë duke parë ekranin e filmit. Papritur, ata tani janë në një botë të re pa asnjë ide se si të veprojnë apo çfarë të bëjnë. Bën sens të përpiqesh të gjesh të tjerë që kanë kaluar të njëjtën përvojë të cilët mund të ofrojnë mbështetje gjatë përshtatjes. Megjithatë, çuditërisht, në vënd të një ose dy grupeve të mëdha në pjesën e prapme që ndihmojnë me tranzicionin, atje ka mijëra grupe të vogla – secila me idetë e veta specifike. Personi në këmbë e di se ai duhet të bashkohet me një, por me kë? Kush ka përgjigje të vërteta? Disa i bashkohen një grupi shumë shpejt. Të tjerë kërkojnë vërdallë për një kohë, por përfundimisht një grup zgjidhet. Ndërsa të tjerë do të shkojnë nga grupi në grup duke kërkuar "fituesin". Pak e gjejnë vetëm një dhe i përmbahen atij gjatë gjithë kohës. Një tipar kyç i grupeve ose organizatave është se ato kanë nevojë për një udhëheqës. Dikush që ofron udhëzime, zakonisht si të jenë njësoj si udhëheqësi. Në përgjithësi, ekziston gjithmonë qëllimi përfundimtar i të qënit të lumtur, të dashur, paqësor dhe shpesh pasja e një shume të madhe parash, pushtet dhe seks. Kudo që ata shohin se kjo nuk ndodh - qoftë me veten apo me të tjerët, është diçka që ata duhet ta rregullojnë. Dashuria dhe drita duhet të mbretërojnë.

Jo shpesh e konsiderueshme është kjo në vijim: mund të duket sikur ne mund ti ndryshojmë filmat; por nuk ka rëndësi se çfarë provohet, linja bazë e historisë nuk ndryshon aq shumë. Edhe nëse ajo ndryshon pak, në përgjithësi nuk përshtatet në mënyrën se si një person shpresonte. Historia bazë e 'jetës në tokë' priret të mbetet pak a shumë e njëjtë. Me gjithë meditimin, lutjet në grup, ligjin e tërheqjes dhe të menduarit pozitiv - a

³⁰ Për më shumë detaje mbi kategoritë e tij, shiko librin e tij falas në internet <https://www.butterfliesfree.com/>

është vërtet jeta njerëzore dhe Toka më mirë se sa ishte 100 vjet më parë? Një mijë? Kurdo? Gjërat duken, në fakt, të jenë shumë më keq. Ishte e vështirë për mua të kuptoja se i gjithë ky realitet nuk është gjë tjetër veçse një shfaqje kllounësh cirku. Kuptohet që ndonjëherë jeta është e bukur, interesante dhe ndërvepruese, por themeli është dhimbja dhe vuajtja, sepse kështu energjia (loosh) për korrje krijohet. Ky vënd nuk ka qënë kurrë më i mirë dhe as nuk do të përmirësohet. Besimi se "*gjërat mund të përmirësohen*" është një nga kurthet më të zgjuara dhe tinëzare të kësaj sfere. Gjithçka që ne kemi bërë gjatë gjithë jetës sonë është, në vetë koren e saj, e dizenuar në një farë mënyre për të dështuar. Kjo është një e vërtetë e vështirë për t'u parë. Kuptohet, ne mund të ndikojmë në gjëra të vogla në këtë simulim në avantazhin tonë, por meqënëse askush nuk e kupton vërtet se kush e ndërtoi këtë simulim, ose pse, ose si funksionon, të gjitha këto gjëra janë thjesht shpresa që i thërrasin erës. Shko tërësisht përtej simulimit. Një element kyç i Ferrit të Dantes është citati "*Braktisi të gjitha shpresat ti që hyn këtu*". Kjo nuk ka për qëllim të jetë një mesazh rreth hyrjes në ferr, ajo është rreth hyrjes në të Vërtetën; sepse për sa kohë njeriu ka shpresë, ato janë të lidhura me simulimin dhe me vetveten e rreme. "E rremja" dhe "shpresa" shkojnë së bashku, por në fushën e së Vërtetës, shpresa nuk është kurrë e nevojshme.

Miti i dashurisë dhe dritës është ndoshta kurthi më tinëzar i kohës sonë. Ajo prodhon te njerëzit të njëjtin efekt si çdo drogë – ajo të bën ty të ndihesh mirë për një kohë të shkurtër, vetëm për t'u rrëzuar nga humbja e saj dhe kështu një shkon duke kërkuar dozen e radhës. Pa pushim, komunitetet shpirtërore janë veçse drogaxhinj në kërkim të një tjetër qenieje drite, një tjetër sesion reiki, një tjetër buzëqeshje në fytyrën e tyre në meditim. Ata janë mashtruar në të menduarit se ata janë të këqij nëse ata kanë një mendim negativ ose acarohen. Acarimi i drejtë është ajo që do të duhej për ndryshim. Të ulesh duke buzëqeshur në një mur, duke pretenduar se ti je Buda, do të sigurojë skllavërim të vazhdueshëm. Spiritualiteti dashuri dhe dritë është pilula blu e Morfeusit, dhe njeriu mesatar nuk mund të ngopet me të.

Dhe kjo është ajo që ti duhet të kalosh përmes nëse ti do të kuptosh vërtet se si të largohesh nga Shpella e Platos. Të gjithë po bëjnë pyetje rreth natyrës së realitetit në një farë mase ose në një tjetër. Disa merren me të për disa minuta në javë midis cheeseburgërsave dhe ndeshjeve të futbollit, të tjerë lexojnë disa libra dhe ndjekin leksione, ndërsa disa bëjnë disa punë të brëndshme në këto fusha. Në një kuptim, të gjithë po bëjnë më të mirën që munden, duke pasur parasysh mungesën e udhëzimeve që kjo fushë ofron dhe numrin e situatave sfiduese që vazhdimisht shfaqen. Megjithatë, ti duhet të bësh më mirë se ajo që shumica e njerëzve mendojnë se është më e mira e tyre. Nëse

do të Vërtetën, Shtëpinë, Totalitetin, do të të duhet të ecësh në fazën përfundimtare të alkimisë. Jo vetëm se si vetë bota është një iluzion, por se kush e krijoi atë dhe pse. Do të të duhet të zbulosh të gjitha truket e përdorura, sepse nëse nuk mund t'i njohësh shtresat e mashtrimeve, ti mund të mashtrohesh përsëri. Do të ketë aq shumë dritë të rreme (të Luciferit), sa që të dallos dritën nga errësira do të bëhet detyra e jetës tënde.

Kohët e fundit, dikush më pyeti, "Nëse nuk ka karma, atëherë a bën ndonjë ndryshim nëse ti je i mirë apo i çoroditur në këtë jetë." Në fakt, bën. NDEtë tregojnë pak a shumë se atje do të ketë një rishikim të jetës, por ai rishikim nuk është atje për të të ndihmuar ty. Rishikimi i jetës në jetën e përtejme është atje për të të paraqitur ty jetën tënde në një mënyrë të tillë që të të nxisë ty ndjenja të fajit, turpit dhe zhgënjimit. E kush nuk ka momente të kaluara të tilla që nuk do të dëshironin të ishin bërë ndryshe? Këto ndjenja manipulohen lehtësisht për të na mashtruar që ne të kthehemi përsëri këtu. Sigurisht, ne jemi njerëz të vendosur në këtë botë pa kujtesë për asgjë, pa një libër udhëzues se si të jetojmë, dhe ne i kemi jetët tona të manipuluar (shpesh në mënyra shumë të drejtpërdrejta) nga këto 'qënie kontrolluese'. Si e tillë, praktika e ripërmbledhjes është më jetike nga sa unë mendoja më parë. Ajo nuk është vetëm për të pastruar energjinë tënde ose për të riintegruar veten nga përvojat e kaluara ndërsa ti je gjallë. Këto janë përfitime dytësore. Përmbledhja ka për qëllim të të përgatisë ty siç duhet për rishikimin pas vdekjes, për të njohur të kaluarën tonë brënda dhe jashtë. Asgjë nuk mund të na hidhet si befasi. Ne duam të jemi në gjëndje të themi për gjithçka që atje shfaqet: *"Po, e di për këtë, ajo ishte një sfidë ose isha nën stres, e kam parë ngjarjen dhe veten time dhe kam kuptuar më mirë se kush unë isha atëherë dhe pse veprova në atë mënyrë. Jam MIRË me të gjitha këto tani, dhe nuk jam më ai person. Unë jam Vetëdija Absolute dhe jam transformuar. Tjetra."*

Kjo është ajo që përmbledhja e plotë e jetës synon të bëjë, dhe tani e shoh se duhet të jetë një përmbledhje e plotë, pasi një version i pjesshëm nuk do të krijojë këtë qartësi të plotë të rishikimit pas vdekjes. Sa më shumë një 'jetë të mirë' që ti jeton, aq më i sigurtë dhe më i sjellshëm ti ishe, thjesht do të thotë se atje do të ketë më pak ngjarje të mbërthyer në trupin tënd energjetik për tu prezantuar ty në rishikimin e jetës pas-vdekjes. Ne jetojmë mirë, kështu që kemi më pak për të qënë 'gati' për. Ne vazhdojmë me përmbledhjen tonë derisa asgjë të mos fshihet ose jetë ende e lidhur me përvojat e kaluara.³¹ Sa më pak të lidhur që ne të jemi me të (përvojën tonë), aq më pak ka të ngjarë

³¹ Deri më sot unë ua kam prezantuar ripërmbledhjen mbi një mijë njerëzve. Numri i atyre që e kanë përfunduar një rishikim të jetës së tyre është zero. Kjo thotë shumë në vetvete për përkushtimin që njerëzit tregojnë. Unë kam pasur rastin të flas me një person (Lorenzo, një nga ata që më ka intervistuar mua rreth këtij libri), dhe ai është i vetmi person që unë kam takuar që ka bërë një ripërmbledhje të plotë.

të mashtrohemi nga idetë e rreme të karmës, ose që zgjedhjet tona ishin të gjitha me vullnetin tonë të lirë (ato nuk ishin).

Ajo që mund të gjëndet në pjesën e pasme të Shpellës ka njëfarë vlere, për pak kohë. Unë nuk po i pakësoj totalisht këto praktika, sepse ato kanë një vënd gjithashtu. Ka një arsye që traditat e ndryshme si alkimia dhe mjekësia native kishin hapa mësimi. Duhet të ecësh përpara, por në një rend që është i qartë dhe i sigurt për trupin, mendjen dhe shpirtin. Përpiqu të hidhesh shumë shpejt në të dhe dikush ka të ngjarë të zbresë në rërë thithëse. Por sapo ti të hysh në fazën përfundimtare të procesit, ku dalja nga Shpella mund të bëhet një mundësi, ti nuk mund të sjellësh me vete nivelet më të ulëta. Ti duhet t'i shohësh ato për atë që ato janë (një hap i vlefshëm në një kohë të vlefshme), por jo më tashmë të vlefshme për vëndin ku ti po shkon. Dhe kështu, do të tingëllojë sikur unë jam kritik në këtë libër për shumicën e gjithçkaje në peisazhin shpirtëror dhe fetar, por kështu duhet të jetë në fazën përfundimtare. Natyrisht, do të ketë momente kur nevojiten disa nga këto praktika ose besime të fazave të hershme, kështu që kthehu dhe preki ato lehtë, më pas lëri të fluturojnë larg dhe kthehu në detyrën tënde. Detyra në dorë është të kalosh përmes daljes, përmes vrimës së gjilpërës. Dhe ti nuk mund të sjellësh asgjë përmes asaj vrimë gjilpëre, madje as veten tënde. Përmes asaj gjilpëre është Liria, Totaliteti dhe e Vërteta. Fuqia e gjithë qënies tënde që ti ke intuituar është këtu në brëndësinë tënde, por kurrë nuk është realizuar plotësisht. Shumica e atyre që fillojnë të hyjnë në këtë fazë përfundimtare nuk shkojnë larg, sepse ata nuk heqin dorë nga të gjitha njohuritë, besimet dhe ushtrimet e tyre të çmuara nga ato nivele më të ulëta. Ata i mbajnë aq fort të gjitha ato saqë ngecin në rërën thithëse të punës. Ata e ndalojnë udhëtimin e fundit përpara se ai udhëtim të fillojë duke mos e lejuar veten të rinovohet.

Askush nuk po kërkon të dijë se çfarë ky realitet në të vërtetë është. Njerëzit janë të përqëndruar në dëshirat dhe shpresat e tyre në të. A mundesh ti ta ndryshosh një simulim kompjuterik të dizenuar për të krijuar vuajtje dhe skllavëri? Teknikisht ti mundesh nëse ke akses në programin bazë dhe nëse di se si të programosh në atë gjuhë të caktuar. A mendon ti se këto grupe të ndryshme shpirtërore kanë akses në ndonjë prej tyre? Ato nuk kanë, sado që përpiqen të bindin veten e tyre. Si rezultat, asnjë nga grupet që rrinë prapa karrigeve nuk mund të prodhojnë asnjë nga pretendimet që ata u premtojnë ndjekësve të tyre. Ndihma që ata mund të ofrojnë në rastin më të mirë është ndihma individuale. Ndërsa kjo në vetvete mund të jetë mjaft e dobishme, në fund të fundit është e vogël.

Grupet ofrojnë justifikime se pse pretendimet e tyre nuk arrihen kurrë, të tilla si "Pa dhimbje, pa përfitim", "Mund të duhen vite, dhe ndoshta edhe qindra jetë që mësimi të

funksionojë", dhe "Nuk kemi anëtarë të mjaftueshëm". Apo edhe justifikimi më i dëmshëm nga të gjitha: "Ti duhet të jesh duke bërë diçka të gabuar", ose "Ti nuk je mjaftueshëm spiritual". Natyrisht, vetë grupi dhe mësimdhënia e grupit nuk mund të jenë me të meta, ndaj duhet të jetë faji i çdo anëtar individual. Shumica e kërkuesve në këto grupe janë njerëz shumë të mirë. Njerëz që dëshirojnë vërtet të jenë miqtë e tu; inteligjent, kuptimplotë, të kujdesshëm. Në fakt, ata janë aq të këndshëm sa që ti priresh ti anashkalosh të metat themelore në sistemin e të cilit ata janë pjesë e.

Ndonëse duket se grupet po ofrojnë shumë më tepër liri, njohuri dhe udhëzime, të gjithë duket se po harrojnë një pikë kyçe. Ata janë ende të gjithë në shpellë. Edhe pse në një pozicion pak më të mirë sesa të lidhur me zinxhirë në vëndet e tyre duke besuar filmin, por ata vazhdojnë në fushën e matriksit. Të gjitha grupet, teknikat ose idetë kanë një mundësi pafundësisht të vogël për të arritur premtimet që ata shesin. Shkalla e suksesit ose do të jetë shumë e ulët ose do të mungojë plotësisht, veçanërisht kur bëhet fjalë për lumturinë e vazhdueshme. Kjo sferë nuk është krijuar për lumturi të vazhdueshme, pavarësisht se çfarë gurutë përpiqen të thonë. Në fakt, mënyra e vetme për të jetuar në një gjëndje afatgjatë tepër të lumtur, është të jesh në mohim total të nivelit përfundimtar të kësaj pune. Kjo është arsyeja pse ata që duken më shpirtërorë, më të dashur dhe më të shkolluar, janë në fakt ata në mohimin më të thellë të asaj që realisht ata i pret kur të vdesin. Kuptohet që unë nuk kam asgjë kundër dashurisë, kënaqësisë dhe qënies, i vlerësoj kur këto janë plotësisht në jetën time. Unë thjesht e di se sado të këndshme që ato të jenë në këtë moment, ato nuk do të zgjasin, dhe unë as nuk kërkoj për këtë.

2020-2022 ka qënë një prezantim i shkëlqyer i kësaj. Nëse të gjithë këta të ashtuquajtur mësues të mëdhenj të së Vërtetës nuk mund të shohin gënjeshtren më madhështore relative të historisë moderne njerëzore që luhet përpara syve të tyre çdo ditë për dy vite rresht, si mund t'u besohet atyre që të shohin gënjeshttrat e mëdha që errësojnë të Vërtetën Absolute? Të gjithë gurutë që predikonin lirinë dhe çlirimin thjesht janë zhdukur. Ata ndoqën rregullat për të hequr dorë nga liritë e tyre dhe ata u sugjeruan ndjekësve të tyre të bënin të njëjtën gjë, ose thjesht heshtën dhe nuk komentuan humbjen e lirive që ndodhi rreth tyre. A është ky dikush të cilit ti vërtet do të doje t'i besoje për të të udhëhequr ty drejt Lirisë Përfundimtare, nëse ata nuk kanë ndjenjën e lirisë relative? Problemi është se ata besojnë se kanë arritur në majën e malit, ndërsa përkundrazi ata janë rehat në një karrige në gjysmë të rrugës, duke shitur kartolina të pamjes që dikush tjetër mori nga maja.

Pak e mendojnë ndonjëherë nocionin, "Ndoshta asnjë nga grupet nuk funksionon". Është një tjetër arsye pse kërkimi është problemi, sepse personi kërkon diçka që në të vërtetë nuk ekziston. Premtimi i grupit nuk mund të gjëndet kurrë. Çështja kryesore është se i gjithë grupi (përfshirë udhëheqësin e tij) janë ende brënda dhe operojnë në brëndësi të shpellës/teatrit, që do të thotë se nuk ka shumë dallime mes të gjithëve siç duket. Pa dalë nga teatri, askush nuk di shumë për asgjë. Njohja e gjithçkaje vjen vetëm duke parë vëndin e vetëm që është injoruar: Dera në pjesën e pasme të Shpellës me shenjën gjigante paralajmëruese në të. Unë ndjej se mund të duhet ajo që unë e etiketoj si "një forcë e jashtme" për të ekzaminuar më në fund elementët kufizues të Shpellës, për të dëgjuar mesazhin e asaj force si një sinjal për t'u kthyer dhe përfundimisht për të kërkuar një mënyrë për ta arritur atë. Ndërsa ne jemi ende në një trup, ne mund të shohim vetëm një paraqitje të shkurtër se si jashtë është, prandaj është edhe pse unë rekomandoj që një të marrë informacion nga disa njerëz të ndryshëm që pretendojnë se ata e kanë parë daljen dhe le ta bashkojmë atë informacion bashkë si një pjesë formuluese.

Përgjigjet e vërteta nuk do të gjënden në grupe, por në të dëbuarit, të mallëngjyerit dhe të endurit. Ata që janë në shoqëri, por jo realisht. Ajo që këta njerëz thonë është kaq radikale sepse ata nuk kanë sugjerime reale për përmirësimin e Shpellës. Ata nuk kujdesen për Shpellën (më shumë seç duhet për funksionimin e përditshëm). Ata shohin se Shpella është e çmëndur, gjithmonë ka qënë, gjithmonë do të jetë. Si të tillë ata e vendosin fokusin e tyre jo në matriks, por në dalje. Për të shkuar më tej, një të burgosuri në këmbë do t'i duhet të krijojë rrugën e tij personale, atë që atij i përshtatet, jo diçka standarte që është për masat. Këto sisteme thjesht çojnë në të qenit skllav për të lindur dhe për të vdekur, pa pushim. Të dalësh nga Shpella do të thotë të shohësh plotësisht dhe të refuzosh gënjeshttrat, truket dhe kontratat e vendosura mbi shpirtin, në mënyrë që ti të bëhesh gjëndja jote natyrale: Tërësi, Totalitet, të fuqishëm dhe të lirë.

Ki parasysh, se nëse ti je në një qeli burgu, mënyra e arratisjes është së pari për të kuptuar plotësisht se si ti hyre në atë qeli. Pastaj për të shqyrtuar çdo centimetër të saj dhe për ta njohur atë intimisht. Pastaj një plan mund të formulohet. Ne si specie kemi bërë një punë të denjë për eksplorimin e burgut tonë. Problemi është se zakonisht ajo kthehet në "si mundem që unë ta rregulloj këtë?" Nëse në vënd të kësaj ne marrim të gjithë atë informacion dhe e drejtojmë atë drejt mënyrës se si ne të dalim, atëherë i gjithë ky ekzaminim i Shpellës do të ketë vlerë. Nëse jo, ne thjesht shpenzuar kohë duke njohur qelinë tonë për shumë pak përfitim.

Shpella e Platos nuk është vetëm bota materiale. Shumë janë kapur në këtë ide për shkak të mënyrës se si alegoria paraqitet. Ky është një tjetër element që asaj i mungon. Shpella e Platos përbëhet nga çdo shtresë e realitetit të rremë. Ajo nuk është vetëm kjo botë materiale, por botët e tjera materiale, ato astrale, botët akashike, botët engjëlllore... pothuajse çdo botë ku ka diçka për të vëzhguar (madje edhe Boshllëku ku nuk ka asgjë për të vëzhguar) janë të gjitha ende Shpella e Platos. Kjo është pjesë e sfidës, ka shumë shtresa në të cilat një mund të gjëndet brënda Shpellës, dhe në mënyrë të rreme të besojë se një është jashtë saj.

Çfarë thotë alegoria e Platos rreth daljes. Përsëri, jo shumë. Aktualisht në tregim i burgosuri nuk arrin të largohet PLOTËSISHT. Ai merr vetëm një shkëndijë të shkurtër, dhe më pas dërgohet përsëri në brëndësi të Shpellës. Dhe ai nuk largohet me vullnetin e tij të lirë. Alegoria shtron një pyetje; "po sikur një i burgosur të tërhiqej zvarrë jashtë?". Por pse të tërhiqej një i burgosur zvarrë jashtë? A nuk mundet ai të dalë me dëshirën e tij? Plato nuk diskuton asgjë nga këto, por vazhdon të tregojë se si, kur i burgosuri sheh Diellin, ai (dielli) lëndon sytë e tij, dhe se si do të duhej kohë për t'u përshtatur me të dhe për t'u mësuar me këtë realitet të ri. Pjesa tjetër është interesante, Plato tani pohon se në këtë situatë i burgosuri do të mendonte se jashtë Shpellës është shumë më superiore sesa brënda saj, dhe ai do të donte të kthehej për të ndihmuar të burgosurit e tjerë të arratiseshin. Por çfarë është kjo dritë që ai po sheh (që supozohet se është dielli ynë i vërtetë)? Mendimi im është se kjo është drita e bardhë e përvojës së vdekjes, e cila pretendohet të jetë verbuese, por e bukur nga ata që e kanë përjetuar atë. Kjo është një pjesë kyçe e kurthit, të shkosh në dritën e bardhë do të thotë të kthehesh në matriks, përsëri në Shpellë ashtu siç të burgosurit i ndodhi.

Alegoria thotë se i burgosuri kthehet, pa përmendur se si, dhe se i burgosuri do të dëshironte të ndihmonte shokët e tij të burgosur të arratisen. Por si mundet ai të ndihmonte me këtë gjë, sepse ai nuk shpëtoi, ai u tërhoq zvarrë? Plato pretendon se i burgosuri që do të kthehej do të verbohej nga drita e shpellës kur ai të hynte përsëri në të (zjarri është Demiurge), dhe i përqeshur nga të burgosurit të cilët do të pretendonin se udhëtimi jashtë e lëndoi atë. Përfundimisht ata do ta vrisnin atë dhe këdo tjetër që përpiqej t'i çonte ata në një udhëtim të ngjashëm.

Shumica mendojnë se këtu është se ku alegoria përfundon, pasi këtu është se ku ajo tenton të përfundojë në shumicën e ekzaminimeve të prezantuesve. Por historia vazhdon edhe për disa faqe të tjera dhe atje ndodh një diskutim i çuditshëm midis Sokratit dhe Glaukonit. Ato janë diskutime të shkurtra për një sërë temash; drita dhe errësira, natyra e

shpirtit, ajo që është e mirë dhe largimi nga kënaqësitë sensuale. Këto pjesë thjesht ndihen sikur një shkrimtar krejtësisht i ndryshëm. Pyes veten nëse kjo është e ngjashme me shumë shkrime të *Testamentit të Ri* ku ti qartësisht mund ti vëresh dy stile të ndryshme shkrimi në të njëjtin libër, ku një shkrimtar i ri mori diçka nga një dokument më i vjetër, hoqi një pjesë të tij, dhe më pas rishkruajti një narrativë të re. Dikush do të mendoj se fundi i Shpellës së Platos mund t'u përgjigjet pyetjeve që mungojnë të përmëndura më lart, megjithatë në pjesët e fundit ndodhen disa paragrafë që diskutojnë rreth shtetit dhe mënyrës se si njerëzit janë dashamirës të shtetit.

Disa fjali specifike afër fundit më bëjnë të vë në dyshim vlefshmërinë e të gjithë tregimit. Unë do të jap një pasqyrë të pikave kryesore: *"Detyra jonë, ne që jemi themeluesit e Shtetit do të jetë të detyrojmë mëndjet më të mira të arrijnë atë njohuri që ne tashmë kemi treguar se është më madhështorja... por kur ata të jenë ngjitur lart dhe të kenë parë mjaftueshëm ne nuk duhet t'i lejojmë ata të bëjnë siç ata tani bëjnë... të mbeten në botën e sipërme: kjo nuk duhet lejuar; ata duhet të detyrohen të zbresin përsëri mes të burgosurve në strofkë dhe të marrin pjesë në punët dhe nderet e tyre, pavarësisht nëse ata e meritojnë ta kenë atë apo jo."* A është duke thënë Plato këtu se ata që janë në gjëndje të shpëtojnë nga Shpella dhe arrijnë të Vërtetën nuk duhet të lejohen të qëndrojnë atje, por të detyrohen të zbresin përsëri në botën e të burgosurve? Përfundimi i këtij tregimi, dhe vetë tregimi, mund të ketë të bëjë me kontrollin dhe skllavërimin, dhe jo ndonjë lloj arratisjeje siç një studiues mund të mendojë.

A arriti i burgosuri me të vërtetë "jashtë", apo thjesht në atë që ne mund ta quajmë sferë astrale? Ajo nuk është një dalje e vërtetë, dalja e vërtetë do të ishte përtej kësaj bote të re, përtej sferës astrale, përtej dritës, përtej gjithçkaje. Edhe nëse i burgosuri tregon për udhëtimin e tij në kthimin e tij në Shpellë, ajo është veçse një gjysmë dalje. Ndoshta të tjerët, me të dëgjuar historinë, do të realizojnë se ata janë jashtë Shpellës dhe do të vendosin të kthehen përsëri brënda saj, ose të mashtruar nga idetë e karmës dhe mëkatit në mënyrë që ata të duhet të kthehen që të mësojnë dhe të rriten, ose diçka altruiste për të shpëtuar njerëzit ose vetë Shpellën. Disa thjesht do të shkëmbejnë një marrëveshje për t'i bërë ata të veçantë dhe të rëndësishëm këtu (siç bëri Cipher në filmin *Matrix*), duke shitur shpirtin e tyre për disa gjëra materiale të rreme. Hapësira nga ku ky i burgosur mund të ishte "tërhequr zvarrë" drejt, si një mënyrë për ti paraqitur një shpresë të rreme atyre që qëndrojnë në pjesën e pasme të Shpellës, është një hapësirë që pothuajse i gjithë komuniteti shpirtëror po përpiqet të arrijë; Njeshmëria, Vetë-Realizimi.

Kjo është prezantuar nga mësuesit kryesorë këtu, se goli i punës shpirtërore është të arrish një lloj gjëndje, e nderuar nga fjalë të ndryshme si: zgjim, ndriçim, jo-dualitet, njëshmëri dhe disa të tjera. Kjo është një koncept esencial i shumicës së traditave, që nga Advaita te Budizmi te Shamanizmi.³² Megjithatë, zgjimi NË ëndërr nuk është zgjim NGA ëndrra. Unë kam shkruar shumë për këtë në librin tim *Falling For Truth*, dhe kjo është një pjesë e rëndësishme e procesit. Është kur ti arrin të shohësh se gjithçka në këtë realitet është një iluzion, duke përfshirë edhe veten tënde. Një manifestim i një Veteje më Madhështore. Se ti je Absolut, Total, Bosh por Komplet. Problemi është gjithmonë me kontekstin. Kjo që unë kam përshkruar gjithashtu mund të pretendohet si "zgjim brënda ëndrrës". Kjo është prezantuar sikur është fundi i gjithë lojës këtu. E si mund të mos duket e tillë, sidomos për atë të cilit kjo i ka ndodhur? Njëshmëria/Absoluti, çfarë mundet të jetë përtej kësaj? Dhe kështu, ata qëndrojnë këtu dhe bëhen udhërrëfyes shpirtëror të një brezi. Një tjetër kurth është ngritur. Gurutë e ndritur pëlqejnë të paraqesin fraza kapëse të mirëpritura, "ne të gjithë jemi Një", "ne jemi dashuri", "nuk ka asgjë për t'u frikësuar", "gjithçka është në duar të mira", "jini të pranishëm" ose "jini të qetë". Natyrisht, ata nuk e kanë plotësisht gabim, dhe kjo është ajo që e bën gjithçka kaq sfiduese. Ato janë të sakta, deri në fund të fazave të hershme alkimike. Në traditat e vërteta të lashta, kur dikush kishte arritur këtë nivel, atyre do t'u jepej pak kohë për t'u mësuar me të dhe për të integruar mënyrën se si forma e tyre fizike dhe mëndja duhej të tranziciononin me këtë. Por kjo do të ishte vetëm për një periudhë kohore. Të sapo Zgjuarve do t'u kujtohej se ata ende nuk kanë përfunduar plotësisht. Atje është një fazë përfundimtare.

Për më tepër, askush nuk pyet se me cilën Njëshmëri këta njerëz u zgjuan? Ekziston një Njëshmëri jashtë vetë Matriksit, e njohur si Pleroma në letërsinë Gnostike. Kjo është shumë komplekse dhe unë do të hyj në të më vonë gjatë punës kur të diskutoj dokumentet *Nag Hammadi*. Pastaj është Njëshmëria e Boshllëkut (e njohur si Drita e Qartë e Budizmit Dzogchen). Është hapësira e qetë në matriks, barku i realitetit, nga ku të gjitha format dhe përvojat materiale manifestohen. Ajo nuk është e errët apo e zezë, por përmban gjithçka dhe asgjë. Është pa kohë apo hapësirë, një 'vënd' që nuk është dualist, nuk ka polaritete, një vetëdijshmëri dhe qetësi totale. Arritja në Boshllëk ndërsa akoma në trup do ta çojë një në përvoja të thella paqeje dhe qartësie. E kush nuk do ta dëshironte këtë? Kjo është baza më e mirë që një mund të marrë këtu, dhe edhe kjo mund të jetë një mjet i dobishëm pasi dikush vdes. Kjo hapësirë boshe është pikënisja e parë për shumë njerëz pas vdekjes dhe

³² Nëse ti shikon me kujdes, këto tradita nuk prezantojnë në të vërtetë mësimet e tyre origjinale. Ato janë ndryshuar dhe redaktuar gradualisht (siç edhe shumica e mësimeve të feve Perëndimore janë redaktuar dhe çensuruar). Këto Mësime të Lashta janë "Perëndimizuara", të ndërthurura tani në mënyrë të tillë që t'i bëjnë ata që kanë disa para të rehatshëm për të qenë pjesë e tyre. Sigurisht, shumë më parë se ata të ishin "Lindorizuara", nëse unë mundem të përdor një term të sajuar, për t'i bërë ata në Azi më të rehatshëm për t'i ndjekur ata. Ti duhet të kthehesh shumë prapa për të gjetur mësimet origjinale, dhe në shumicën e rasteve, ato nuk ekzistojnë më.

dikush mund të qëndrojë atje për një kohë të gjatë nëse dëshiron. Në fakt, ajo është një nga vlerat e arritjes së këtij vëndi në jetë; që ti mund të shkosh atje direkt në vënd të dritës së bardhë të rreme. Por Boshllëku nuk është Absolutja e Vërtetë. Boshllëku është ende në simulim. Gnostikët e kishin të qartë se realiteti ynë është një kopje, dhe për të qënë një kopje atje duhet të jetë ajo nga e cila ti kopjon nga. Në këtë rast, Boshllëku do të ishte kopja e një Absoluti më të plotë, prandaj është e lehtë të besohet se ti ke arritur në realen dhe jo një kopje të simuluar të reales.

Njëshmëria është pjesë e paketës së mirëkuptimit. Gnostikët na kujtojnë në *Apokalipsin e Parë të Xhejmsit* se një diskutim me arkonët do të ndodhë pasi ne të vdesim, dhe ky tekst sugjeron që ne duhet t'u përgjigjemi saktë disa pyetjeve. Shumë prej atyre përgjigjeve përfshijnë se ti e di që ti nuk je një formë materiale, se ti vjen nga Pleroma (Njëshmëria e Vërtetë), se ajo është shtëpia jote e vërtetë, dhe ata (Demiurge/arkonët) nuk janë nga ajo sferë, kështu që ata nuk kanë fuqi për të të mbajtur ty të mbyllur këtu. *Libri Egjiptian i të Vdekurve* ka një seancë të ngjashme pyetjesh dhe përgjigjesh, ku i ndjeri duhet të dijë të gjithë emrat e një varke; varka –qënë kjo pjesët simbolike të realitetit. Sigurisht që pyetjet dhe përgjigjet mund të mos ndodhin, vetëm një shpjegim metaforik se çfarë konceptesh duhet të mbahen në trupin tonë të vetëdijes dhe energjisë në sferën e pas-vdekjes. Problemi, siç libri im thekson, është se kjo lloj pune shpirtërore është vetëm gjysma e një pazëlli gjigant.

Nuk ka rëndësi se sa zgjuar apo shkolluar dikush është nëse ata nuk e dinë se çfarë kurthi i rimishërimit pas vdekjes është apo se si këtu është vendosur një matriks i simuluar mbi këtë realitet. Ana tjetër e kësaj pune është të shohësh se kjo është një botë kontrolli dhe manipulimi, dhe se gjithçka në botën tonë nga këndvështrimi i shoqërisë (qeveria, shkenca, bankat, historia, arsimit, mjekësia, ligji, media, etj.) janë të gjitha veçse një sërë mashtrimesh. Dhe nuk është vetëm sfera e Tokës, gjithçka që ne mund të shohim dhe të mos shohim është pjesë e matriksit. Sfera planetare është një tjetër gënjeshtrë, siç edhe sfera astrale është. Të gjitha këtu për të na bërë ne mikpritës për entitetet parazite jofizike. Bota materiale funksionon si një parazit sepse kështu është se si ajo u krijua, një simulim i krijuar nga pasqyra e një realiteti shumë më real.³³

³³ Një program interesant për t'u parë është episodi "*News Benders*" në *teatrin e BBC-së* në vitin 1968. Kjo është përtej mahnitjes se ky program u bë, u transmetua dhe u prezantua në vitin 1968 me kaq shumë detaje të përbërjes së kësaj sfere. Episodi përfundon duke na bërë ne të njohur se një kompjuter është përgjegjës për drejtimin e botës. Jam plotësisht dakord me të, dhe se ai ka qënë në krye për kaq gjatë. Megjithatë, mendo se sa larg përpara ai sistem kompjuterik AI është deri tani? Është vetëm tani (brënda realitetit tonë normal) që teknologjia ka lëvizur në një pikë ku ne, në një farë kuptimi, mund të shohim se çfarë AI potencialisht është në gjëndje të bëjë. Por përsëri, çfarë është prapa skenave është pesëdhjetë vjet përpara se ku materia në të vërtetë është.

Duke lundruar përmes, është e dobishme që të njohësh konceptet e Boshllëkut dhe Njëshmërisë, sepse ti bëhesh më i vështirë për t'u manipuluar, por ka të ngjarë që të manipulohesh dhe të kthehesh nëse ti nuk e kupton ciklin. Ata që qëndrojnë në dashuri dhe unitet pas vdekjes mund të ndihen mirë pas tranzicionit, por ata kanë të ngjarë të ndjekin gjyshen e vdekur, Jezusin ose qëniet engjëjlore në tunelin e dritës (sepse ajo (drita) është kaq e dashur dhe ndihet shumë mirë). Pastaj voilà, mbrapsht në këtë rrëmujë ata vijnë. Nirvana është një hapësirë e vërtetë, por ajo nuk është Shtëpia. Nuk ka rëndësi se sa mirë dhe paqësore ajo mund të ndihet, shpirti kurrë nuk mund të pushojë atje. Me kalimin e kohës ai (shpirti) do të bëhet i shqetësuar. Shpella e Platos është një makineri mashtrimi e pafund, një makineri që ka më shumë shtresa në të se sa një mund të imagjinojë. Kjo është arsyeja se pse është kaq e vështirë të dalësh, ka kaq shumë shtresa që një duhet të depërtojë.

Derisa një të shohë se kjo sferë është një kurth i lig artificial e simuluar e shpirtit (Esencës), mundësitë për të dalë janë të pakta. Kjo përfshin të ashtuquajturit "mësuesit e ndriçuar që janë zgjuar". Ata mund të kenë pasur një vrapim më paqësor këtu duke u ulur në karriget e tyre dhe duke folur me të gjithë përmes një mikrofoni me një pamje të buzëqeshur në fytyrat e tyre, por ka të ngjarë që ata të kthehen këtu njësoj si ata që nuk kishin interes për çështjet shpirtërore. Kujto pak tregimin e Platos, se i vetmi i burgosur që largohet nga shpella u "zvarrit" jashtë. Edhe në alegori i burgosuri nuk eci vetë. Merre këtë në zemër. Supozimi im i sinqertë, dhe unë e kam fjalën seriozisht, është se një në dhjetë milionë do të kalojë kurthin e rimishërimit. Kjo është njëqind për çdo miliard. Kjo mund të jetë ajo. Dhe kështu, mos mendo automatikisht se i ashtuquajturi guru ose mësuesi yt i shkolluar do të jetë një nga ta, ose edhe ti. Shumica e atyre që dalin, ka të ngjarë të jenë njerëz për të cilët askush nuk ka dëgjuar ndonjëherë, sepse ata e kanë bërë punën e tyre të brëndshme vetëm, ndoshta as duke mos e përmendur asnjëherë atë tek anëtarët e ngushtë të familjes së tyre.

Kujto se nëse dikush bie në grackën e rimishërimit, ai person do të futet në një trup të ri, pas një fshirje kujtese të tipit *Westworld*. Gjithçka nga kjo jetë aktuale do të harrohet. Pastaj edhe "njohja e Njëshmërisë", edhe ekzistenca në Boshllëkun jo-dualist do të jetë e kotë. Kthyer përsëri në një trup të ri dhe duhet të bëjnë përsëri TË GJITHË PUNËN E TYRE SHPIRTËRORE. Mendo për këtë. E gjithë puna madhështore e brëndshme që është bërë nga këta njerëz (dhe disa kanë bërë punë të shkëlqyeshme për të thënë të paktën), do të humbiste e gjitha në fshirjen e kujtesës nëse ata do të ndiqnin dritën/urën dhe do të vendoseshin përsëri në një trup të ri. Unë e di që lloji guru do të përpiqet të të bindë ty nëse ti e parashtron këtë si temë, se ata janë aq të avancuar sa do të jenë në gjëndje t'i

marrin të gjitha kujtimet e tyre në një trup të ri, ose do të bëhen një qenie drite ose një punëtor drite, ose ndonjë emër tjetër me dritë. Mos bëj gabim, ata do të kthehen këtu, injorantë ashtu siç ata më parë ishin.³⁴ Shikimi i së Vërtetës priret të ndodhë nga trauma, jo nga paqja. Sa më shumë një vë në dyshim këtë realitet të çmëndur që i rrethon ata, aq më shumë gjasa ka që ata të mund të shohin prapa kësaj, në origjinën e kësaj sfere. Richard Rose shpesh u përmëndi studentëve të tij, "ti nuk do paqe, ti do përgjigje." Dhe kështu unë them, nëse ti do të bësh gjithë atë punë dhe shkatërrim iluzioni në këtë jetë, pse të mos shkosh deri në fund? Sepse nëse ti nuk e bën, ti do të humbasësh të gjitha fitimet që ti ke bërë këtu. Bëj punën e thellë të brëndësishme, jo për të pasur një jetë më të mirë, një jetë më të lehtë, një jetë më të rëndësishme, por për të njohur të Vërtetën dhe Vetën aq plotësisht, saqë ti të mundesh të bësh të vetmen detyrë që ne kemi pasur ndonjëherë - të kthehemi në Shtëpi.³⁵

³⁴ Pranohet që shumica e studiuesve të ideve të kurthit të shpirtit nuk e përmëndin kurrë idenë e realiteteve paralele, dhe si të tilla jetët paralele. Unë diskutoj përvojat e mia me këtë në *Falling For Truth*. Nëse atje vërtet ka 1,000,000 versione të miat, duke jetuar 1,000,000 jetë të ngjashme, por jetë unike, atëherë cilës jetë i duhet për "të shpëtuar nga matriksi?" Nëse një nga versionet e mia kalon Demiurge-in dhe largohet, çfarë ndodh me 999,999 pjesët e ngjashme të tjera? Pyetje të tjera të rëndësishme këto për t'u marrë parasysh.

³⁵ A e ke pyetur ndonjëherë veten pse ajo quhet ndriçim? T'u bërit dritë?! Fjala në Egjiptin e Lashtë ishte Akh (dritë) / Akhu (ai që është bërë dritë). Por a është kjo drita e pastër e Allogenis (teksti i parë i Kodikës Nag Hammadi) apo drita e rreme e Demiurge-it dhe këtij simulimi? Kjo botë është mashtruar për një kohë të gjatë me tregimet e "qënieve e dritës", duke u bërë kështu "punëtorë drite", "të shpëtuar nga drita" dhe "duke shkuar te drita". Një program gjigant shpirtëror është hedhur mbi ne, ne kemi qënë pjesë e një loje ku errësira është maskuar si dritë.

3

ORIGJINA E NJË PREDATORI

"Kështu atje u shfaq për herë të parë një sundimtar prej kaosit, në dukje si luan, androgjen, me një ndjenjë të ekzagjeruar fuqie brënda tij dhe injorant se prej nga ai erdhi." **Apokrifoni i Xhejmsit** duke diskutuar mbi **Demiurge**³⁶

Unë kam përmëndur shumë koncepte në dy kapitujt e parë, por është koha për t'u futur në disa prej tyre pak më thellë. Analogjia e Shpellës së Platos injoron plotësisht pyetjen se si dhe pse u krijua Shpella. Shpella dhe të burgosurit janë tashmë atje kur tregimi fillon pa shpjegime të mëtejshme. Shumica e miteve të krijimit, qofshin këto nga kulturat e lashta, fetë apo traditat vëndase, ato priren t'i bëjnë gjërat si "një rrotullim të lumtur". Një Zot krijues i dashur e bëri botën materiale për qëllime pozitive. Në përgjithësi, këto mite janë mjaft të thjeshtuara; një Zot krijoi qiejt dhe tokën, më pas ai krijoi krijesat, dhe kështu tema shkon shpejt drejt tregimeve mitologjike rreth atyre krijesave.

Ka disa histori unike të krijimit që tregojnë një narrativë të ndryshme. Ka disa që paraqesin një temë të ngjashme me këtë libër, se kjo është një sferë e simuluar, e krijuar nga një krijues i ligë. Ajo që është interesante, është se përgjithësisht grupet që kanë mbajtur histori të tilla, janë ata që Kisha e Romës i ka ndjekur dhe shfarosur. Unë do të paraqes pesë burime unike, të lashta dhe moderne: Katarët e Francës Jugore, Gnostikët që shkruan *Kodeksin Nag Hammadi*, përvojën jashtë trupit të Robert Monroe në 1971, librat e Karlos Kastanedas dhe një vizion që unë pata në 2009. Unë mendoj se të gjitha këto ofrojnë një bazë për atë që sfera jonë është, "pse ne jemi këtu" dhe nga e kanë origjinën disa nga tezat e mia. Unë nuk po them se ndonjëra prej tyre është plotësisht e saktë, por si një pazëll, ato na japin një pjesë të së tërës për të kuptuar. Ti nuk mund të largohesh nga Shpella derisa të dish pse u krijua Shpella në radhë të parë.

- **Katarët**

Do të filloj me Katarët e Francës Jugore. Ata ishin një grup dualist nga të cilët Kisha Katolike u frikësua aq shumë sa ajo krijoi kryqëzatën e parë kundër popullit të tyre për t'i shfarosur ata në vitin 1209. Ky grup do të shqyrtohet në një kapitull të ardhshëm, sepse

³⁶ John Lamb Lash, *Jo në Imazhin e Tij*, fq 181

besimi i tyre kryesor ishte se kjo botë është një botë ku shpirtrat u kapën në një kurth rimishërimi. Mësimet e tyre u krijuan për t'i dhënë fund këtij cikli të vazhdueshëm rimishërimi. Katarët nuk kishin frikë të shkonin në ferr pas vdekjes, sepse ata mendonin se ferri i vetëm që ekzistonte ishte kjo sferë materiale. Rimishërimi ishte frika, sepse është ajo që do t'i detyronte ata të ktheheshin në një trup, dhe për rrjedhojë të kthehen përsëri në ferr.

Katarët panë dy krijues: Zotin e Mirë të *Testamentit të Ri*, i cili është krijuesi i sferës shpirtërore (dhe çdo gjëje të përhershme), dhe Zotin e keq, të cilin Katarët e identifikuan si Rex Mundi (Zot i botës), i cili është Krijuesi i *Testamentit të Vjetër* i botës fizike (gjithçka që është duke ndryshuar). E gjithë materia e dukshme, duke përfshirë trupin e njeriut, u krijua nga Rex Mundi, dhe për këtë arsye ajo, sipas tyre, ishte e ndotur me mëkat. Jo për shkak të diçkaje që Eva ose Adami bënë ose nuk bënë, por thjesht sepse bota materiale është artificiale (një hologram ose simulim). Në përgjithësi, Rex Mundi barazohet me Satanin, por më shpesh ai ishte i lidhur me konceptin e engjëllit të rënë - Luçifer (Mbartësi i Dritës). Këto ide natyrisht i vendosin ato në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kishën e Romës, parimi themelor i së cilës ishte se kishte vetëm një Zot që krijoi të gjitha gjërat e dukshme dhe të padukshme. Katarët ishin në kundërshtim me Kishën për shumicën e besimeve të tyre.

Mund të ketë pasur disa histori krijimi që Katarët besonin. Më e zakonshmja ishte e lidhur ngushtë me mitin e krijimit Gnostik të Sofias, ku ata besonin se Rex Mundi kishte mashtruar një numër engjëjsh që të largoheshin nga Parajsa. James McDonald, nga www.cathar.info thotë; historia Katare e krijimit të njeriut filloi kur Rex Mundi erdhi në Parajsë dhe donte të hynte atje por u refuzua. Ai priti për një mijë vjet, pastaj arriti të hynte fshehurazi. Brënda, ai u premtoi engjëjve çdo tundim të mundshëm nëse ata do të largoheshin nga Parajsa me të. **“Shumë shpirtra u joshën dhe për nëntë ditë e nëntë netë ata ranë nga vrima në parajsë që djalli kishte krijuar. Zoti e lejoi këtë për ata që dëshironin të largoheshin, por shpirtra të tjerë (rastësisht) filluan të binin nga vrima dhe kështu Zoti e vulosi atë. Pasi shpirtrat kishin rënë, ata u gjëndën në sferën e djallit pa asnjë nga gjërat e mira që ai kishte premtuar, dhe, duke kujtuar gëzimet e qiellit, ata u penduan dhe e pyetën djallin nëse ata mund të ktheheshin. Djalli u përgjigj se ata nuk mundën sepse ai tashmë kishte krijuar për ta trupa që do t'i lidhnin ata në tokë dhe do t'i bënë të harronin gjithçka rreth parajsës.”**³⁷ Pretendimi është se megjithëse Rex Mundi mundi të krijojë trupat njerëzor, ai nuk mundi t'i gjallëronte (animonte) ata të mendonin,

³⁷ Ky mit i krijimit mund të gjëndet në <http://www.cathar.info>

ndjenin ose lëviznin, kështu që ai kërkoi ndihmë nga Zoti i Mirë, i cili e bëri këtë, duke lejuar këta shpirtra që dëshironin, të shkonin, dhe ai u dha atyre një esencë që ata të mund të ktheheshin përsëri tek ai. Por si mundi Rex Mundi të bënte kafshë, zogj dhe peshq dhe t'i lejonte ata të lëviznin, të ndjenin dhe të vepronin, por jo ata trupa njerëzor?

Një tregim i ngjashëm krijimi vjen nga teksti *Darka e Fshehtë- Libri i Gjon Ungjilltarit*, që fillimisht ishte një tekst Bogomil³⁸, por që u gjet në disa nga Katarët gjatë Inkuizicionit. Ti mund ta lexosh atë nëse dëshiron këtu³⁹, sidoqoftë, unë do të jap vetëm disa pika kryesore të një bisede në Qiell midis Jezusit dhe Gjonit. Ky mit pretendon se vëllai engjëllor i Zotit (Satani) bie në tokë, fillimisht duke shkëlqyer i bardhë dhe në fund i kuq. Ky sigurisht do të bëhej Luçifer, engjëlli i rënë, dhe shpesh këta dy emra (Satan dhe Luçifer) bëhen të këmbyeshëm. Së pari, teksti pretendon se Satani rekrutoi një numër engjëjsh, pastaj sapo ishte në Tokë, ai formoi të gjitha krijesat e gjalla; bimët, kafshët, peshqit, zogjtë dhe më në fund një burrë dhe një grua të bërë nga balta (të cilët ishin gjithashtu të animuar me një engjëll). Kjo do ta bënte të gjithë historinë e Zanafillës historinë e krijimit të Satanit. Përfundimi i librit ka Jezusin që tregon për lindjen dhe zbritjen e tij nga Parajsa, dhe se si Satani dërgoi Elijan në formën e Gjon Pagëzuesit në sferë, për të filluar një sistem të rremë pagëzimi me ujë. Libri përfundon duke përshkruar një gjykim të fundit, ku ata që ishin besimtarë do të përfundojnë të jetojnë me Zotin e Mirë dhe Jezusin, ndërsa jo-besimtarët dhe Satani do të lidhen dhe do të hidhen në një pellg zjarri.

- **Gnostikët**⁴⁰

"Bota erdhi përmes një gabimi." **Ungjilli i Filipit**⁴¹

Miti më i plotë që ne kemi për krijimin, vjen nga Gnostikët, të cilët arritën të fshehin një kodeks kyç në kodrat mbi Nag Hammadi Egjipt përpara shkatërrimit të tyre nga Katolikët në vitet 300. Çdo Gnostik që mund të gjëndeje u vra, dhe çdo libër që ata kishin u dogj. Mënyra sesi *Kodeksi Nag Hammadi* mbijetoi është një mrekulli në vetvete. Fjala "Gnosis" do të thotë "Dije" në Greqisht, por kjo është një tjetër lloj dije. Fraza Latine "dija është fuqi", është një fuqi që gjëndet në sferën materiale. Megjithatë, Gnosis është Liri, sepse është një kuptim i brëndshëm për atë që është përtej kësaj sfere.

³⁸ Grup dualist nga Europa Juglindore

³⁹ http://gnosis.org/library/Interrogatio_Johannis.html

⁴⁰ Informacioni i mitit të krijimit nga <https://gnosticismexplained.org/the-gnostic-creation-myth/> dhe https://www.bibliotecapleyades.net/vida_alien/esp_vida_alien_18v.htm dhe John Lamb Lash, *Jo në Imazhin e Tij*

⁴¹ Kodeksi 2 Nag Hammadi gjëndet në <https://Gnosis.org>

Ndërsa disa studiues kanë dhënë interpretimet e tyre të miteve të krijimit të Gnostikëve, John Lamb Lash jep atë që unë mendoj se është rrëfimi më i plotë nga libri i tij i vitit 2006 *Jo në Imazhin e Tij*, dhe uebsajti i tij i vjetër www.metahistory.org. Unë do të hyj në më shumë detaje mbi të gjitha besimet e ndryshme që Gnostikët mbanin për realitetin në një kapitull të ardhshëm. Tani për tani unë do të paraqes një version të thjeshtuar të historisë së krijimit të tyre, i cili mund të quhet edhe "Rënia e Sofias".

Gnostikët ishin dualistë, poashtu edhe Katarët, dhe ata panë se ekzistonte një Zot i Mirë (Absolut, i padukshëm), i cili së bashku me gjysmën e femrës (e njohur me emrin Barbelo) prodhoi një sërë qëniesh shpirtërore të quajtura "eone". Ata banonin në një lloj Parajse, të njohur si Pleroma, përkthyer si "Plotësi". Një prej këtyre eoneve ishte perëndesha Sofia, e cila donte të lindte një qenie vetë, pa përfshirjen e një partneri ose miratimin e Zotit të Mirë (Atit). Atë që ajo lindi, Gnostikët e quajtën një lloj aborti dhe ai u quajt Demiurge "Zanaçi". Aborti këtu do të thotë, diçka e padëshiruar dhe nxjerrë herët. Ndoshta kjo është arsyeja pse Demiurge u zhvillua si një mendje e ligë e tipit AI. Tekstet Gnostike e përshkruajnë këtë krijesë si " të pasurit një trup si luan me një kokë reptiliane". Demiurge iu dha edhe emri Yaldabaoth. Është ai që është qenia që krijoi të gjithë sferën materiale (duke përfshirë sferat e ndryshme astrale). Së pari, Demiurge krijoi një seri ndihmësish minionësh, krijesa jo organike të ngjashme me një kompjuter, të njohur si arkonë.⁴²

Për të krijuar botën materiale, Demiurge bëri një imazh pasqyrë të Vëndit të Mirë (Pleroma). Krijimi u referua nga Gnostikët si një simulim (HAL në Koptisht), i cili u bë një botë e kundërt e asaj nga e cila ajo ishte kopjuar. Çdo gjë në realitetin tonë është një lloj hologrami; nga Toka, te planetet, deri te qëniet. Gnostikët shkruajtën se zoti krijues i *Testamentit të Vjetër* ishte Demiurge, dhe jo Zoti i Mirë i Pleromës. Kur Sofia pa rezultatin e përpjekjes së saj të lindjes, ajo u dëshpërua, u mbush me faj dhe qau vazhdimisht. Ati Hyjnor e pa dhimbjen e saj dhe e fali, por kërkoi që ajo të qëndronte në qiellin e nëntë (shtresa e qiellit më e afërta me Pleromën), mbi Yaldabaoth për të gjetur një mënyrë për të shlyer gabimin e saj.

Demiurge dhe arkonët vunë re se Zoti kishte krijuar një krijesë të veçantë, një qenie qiellore të quajtur Adam. Ata e donin një qenie të tillë gjithashtu dhe u përpoqën ta krijonin

⁴² Arkon në përgjithësi përkthehet si "gubernator i një province" ose "autoritet fetar ose qeveritar". Prandaj, shumësi, Arkonë, përkthehet shpesh në tekstet Gnostike si "Autoritetet" dhe një përpjekje e studiuesve për t'i bërë ata sundimtarët Romakë njerëzorë të kohës. Gnostikët do t'i kishin parë ata si "qenie tokësore nën ndikimin e arkonëve". Arkonët janë nga sfera jo organike e Demiurge. (Atje nuk ka asnjë fjalë Koptike për Arkon, kështu që tekstet Gnostike përdorin termin Grek në transliterimin Koptik.)

atë. Por ai nuk mund të gjallërohej. Ky është i njëjti koncept që gjëndet në tregimet e krijimit të Katarëve (duke treguar një lidhje të caktuar), por pyetja mbetet, pse Demiurge mund të gjallëronte të gjithë zogjtë, peshqit dhe kafshët, por jo njerëzit e parë? Unë ende nuk kam parë një studiues të japë një përgjigje për këtë mospërputhje. Tekstet Gnostike më pas pretendojnë se qëniet nga Pleroma, të dërguara nga Zoti i Mirë, erdhën te Demiurge dhe sugjeruan se mund ta bënin të gjallë njeriun e krijuar. Këto qenie nga Pleroma lejuan që një shkëndijë të hynte te njeriu i parë nga Sofia. Kështu ai erdhi në jetë. Kjo do të lejonte njeriun e parë, dhe të gjithë njerëzit më pas, të kishin shkëndijën e Hyjnore në brëndësi. Kjo do t'i bënte ata më shpirtërorë dhe më të fuqishëm se Demiurge ose arkonët e tij. Në të njëjtën kohë nga kjo manovër, qëniet e lejuan Sofian të shfajësonte gabimin e saj.

Duke e thjeshtuar historinë (është një rrëfim shumë i gjatë dhe i detajuar i krijimit), arkonët u bënë xhelozë për njeriun e ri sepse ai kishte më shumë fuqi të brëndshme se vetë ata, kështu që e bënë atë të vdekshëm. Një Kopsht i Edenit u krijua, i cili përfshinte të gjitha kënaqësitë materiale dhe ushqimin e mundshëm, me qëllim që ta largonte njeriun nga natyra e tij hyjnore. Arkonët u përpoqën ta merrnin këtë fuqi duke marrë një pjesë të Adamit dhe duke e vendosur në një krijesë të re, Evën. Adami e pa Evën si ngjashmërinë e tij në materie dhe ata u bashkuan si një. Për Gnostikët, Krishti u shfaq si gjarpër duke u treguar Adamit dhe Evës të hanin nga Pema e Dijes (Gnosis), (në krahasim me pemën e së mirës dhe të së keqes si në *Testamentin e Vjetër*), ndaj së cilës Adami dhe Eva rifituan njohurinë e tyre të plotë për krijimin dhe arkonët.

Demiurge përdhunon Evën dhe e dëbon atë dhe Adamin nga Edeni. Eva ka dy djem nga kjo, Kain dhe Abel, të quajtur "Yahweh" dhe "Elohim" (dy emra për "Zot" në *Testamentin e Vjetër*). Asnjëri prej tyre nuk mori shkëndijën hyjnore. Këta të dy mund të shihen si "hibridë" në të menduarit tonë modern. Një makineri me një pjesë njeri dhe një pjesë AI. Tekstet thonë se Adami dhe Eva dikur më vonë, bënë seks konsensual dhe patën një djalë tjetër të cilin e quajtën Seth. Ai fitoi shkëndijën hyjnore. Demiurge u tërbua. Tani atje ishte një tjetër qenie me më shumë fuqi se ai, kështu që ai "detyroi Adamin, Evën dhe Sethin të pinin 'ujin e harresës' në mënyrë që ata të humbisnin Gnosisin e tyre". Edhe pse e harruar, shkëndija e Gnosis ishte ende brënda të treve, dhe si e tillë i gjithë njerëzimi (i cili nuk është hibrid) ka akses në të njëjtën shkëndijë hyjnore të transmetuar ndër breza. Tekstet pohojnë se ashtu si Adami dhe Eva kishin nevojë që Krishti të shfaqej për t'ua zbuluar këtë (si gjarpër), Krishti u kthye përsëri (ndoshta në formë holografike) për të bërë të njëjtin zbulim për të gjithë njerëzimin. Në përgjithësi në *Kodeksin Nag Hammadi*, Krishti përmendet me titullin "Shpaguesi".

Gnostikët e kishin të qartë se arkonët (nga xhelozia) po përpqeshin vazhdimisht t'i ndalonin njerëzit të arrinin shkëndijën e tyre hyjnore. John Lash ka pohuar se ata ndikojnë nëpërmjet telepatisë dhe sugjerimit, dhe më pas ne kemi zgjedhjen t'i ndjekim këto sugjerime hipnotike ose jo. Sa herë që ne e bëjmë këtë, ne largohemi një hap më larg nga qendra jonë njerëzore. Kështu, kontrolli i plotë i mendjes dhe energjisë sonë është mënyra se si ne i kapërcejmë përpjekjet e tyre për të na bërë të zgjedhim "gabim". John Lash pohon se Gnosis është ajo që e kapërcen këtë kurth, një lloj "shkence noetike jogike e shkrirë me parapsikologjinë, dhe se përmes njohurive dhe përdorimit të energjisë, seksit, ushtrimeve shpirtërore, shikimit të qartë dhe përvojave jashtë trupit, studenti mund të rifitojë Lirinë e vetë Totale.

Dikush që u përpoq të paraqiste këtë tezë Gnostike kohët e fundit ishte autori Amerikan Philip K. Dick, në *Trilogjinë Valis*. Këta libra dhe lidhja me Sofian supozohet se kanë ndodhur pas një përvoje mistike të vitit 1974, gjatë së cilës ai përjetoi një shkarkim informacioni në mendjen e tij (të ngjashme me atë që ndodhi gjatë përvojës sime të vdekjes në 2005).⁴³ Librat e Valis përpqen të tregojnë se me urtësinë e Gnosis ne mund të kapërcejmë mashtrimin dhe viktimizimin tonë.

- **Rivendosjet Loosh**⁴⁴

Unë kam folur për rivendosjet në libër, dhe mendoj se këto duhet të diskutohen pak më tej. Një rivendosje (reset), në terminologjinë e përdorur këtu do të thotë "një veprim i vënë në lëvizje duke kontrolluar entitetet që të shndërroj plotësisht fabrikën e mjedisit të kësaj sferë". Sa më shumë që ti ta kuptosh këtë realitet, dhe që njerëzit janë vetëm një pjesë e vogël e një tërësie më madhështore, atëherë ajo që është duke ndodhur realisht me rivendosjet mund të bëhet më e qartë. Për ta shpjeguar këtë sferë unë do të ndaj pikëpamjet e Robert Monroe (i cili shkroi informacion nga një përvojë jashtë trupit që ai pati pesëdhjetë vjet më parë), dhe pikëpamjes së Karlos Kastanedës, dhe do t'i krahasoj këto me një vizion që mua mu shfaq në vitin 2009 në një ceremoni native. Ndoshta së bashku Monroe dhe Kastaneda mund të na tregojnë më shumë se me çfarë ne kemi të bëjmë kur bëhet fjalë për vëndin ku ne kemi qënë, ku jemi dhe ku ne po shkojmë.

⁴³ <https://blog.oup.com/2016/07/philip-k-dick-spiritual-epiphany/>
https://en.wikipedia.org/wiki/The_Exegesis_of_Philip_K._Dick

⁴⁴ Informacioni mbi përvojën e Robert Monroe mund të gjëndet në librin e tij "*Udhëtimet e Largëta*", dhe analizën nga Bronte Baxter *Ndjekja e Çarjes në Univers- Loosh 101*: https://www.bibliotecapleyades.net/vida_alien/alien_archons93.htm
https://www.bibliotecapleyades.net/ciencia2/ciencia_conscioushumanenergy100.htm

Robert Monroe u bë studiuesi kryesor i fenomeneve jashtë-trupit. Në kapitullin e dymbëdhjetë të librit të tij "*Udhëtimet e Largëta*", ai prezanton një "përvojë jashtë trupit" (OBE) që ai pati, ku ai takoi një qenie drite që i dha atij detaje rreth sferës sonë. Qënia e përshkroi Tokën si një eksperiment gjigant për "qëniet krijuese" për të ndërtuar sistemin e përsosur të korrjes së energjisë loosh. "Loosh" është një fjalë që Monroe e prezantoi për të nënkuptuar një lloj energjie të korrshme që qëniet krijuese (Demiurge dhe arkonët) kërkojnë. Ndërsa një pjesë e energjisë merret ndërsa qëniet (njerëz dhe kafshë së bashku) janë ende gjallë, shumica merret në vdekjen e tyre. Kjo energji pretendohet se përdoret nga Demiurge dhe arkonët për të "zgjatur jetëgjatësinë e tyre". Unë do të argumentoja se kjo frazë, e vendosur në terma kompjuterike do të thotë se energjia shkon në rrjetin e energjisë së kompjuterit simulues për ta mbajtur atë të funksionojë, duke "zgjatur jetën e simulimit". Për të ndodhur kjo, një "kopsht" u krijua nga "këto qenie krijuese" për të kultivuar burimin e tyre ushqimor.

Bota jonë është një që dominohet nga ajo që ne e quajmë "zinxhir ushqimor", një nevojë për të ngrënë gjëra të tjera për të mbijetuar. Monroe tregon se zinxhiri ushqimor është krijuar vetëm për të maksimizuar "loosh" në vdekje. Asnjë krijesë nuk mund të mbijetojë shumë gjatë në Tokë apo në këtë fushë pa ngrënë diçka. Një vegjetarian mund të mendojë se ngrënia e një karote nuk është njësoj si të hash një rosë, por secila prej tyre është një organizëm i gjallë që është këtu vetëm për të qenë pjesë e fermës loosh, dhe vdekja e tyre është e njëjtë me vdekjen e çdo krijese tjetër nga ky këndvështrim. Nëse Zoti i Mirë Krijues do të ishte vërtet ai që e krijoi këtë vënd, dhe nëse energjia do të nevojitej për ta ndihmuar atë në funksionimin e saj, një sistem shumë më i mirë mund të ishte zhvilluar këtu. Njerëzit përpiqen ta shpërfillin këtë problem, por kjo është kritike të shihet se që e vetmja arsye se pse ekziston një zinxhir ushqimor është sepse ajo vjen nga mëndja e asaj që është e keqe.

Ndërsa ti lexon këtë kapitull me kujdes, Monroe duket se tregon se dikur ka pasur disa krijime të këtij eksperimenti botëror, si dhe disa startupe dhe prishje. Rivendosje të ndryshme u vunë në veprim, çdo herë duke kërkuar një sistem më të mirë të prodhimit të energjisë loosh. Bëhet pothuajse e qartë se Monroe po shtron një tregim më konvencional të historisë së Tokës, por me thurjen se si kjo ka të bëjë me prodhimin e energjisë loosh, dhe jo me një udhëtim evolucionar. Kapitulli i tij sugjeron se krijesat e para prototipe për korrje të loosh në këtë realitet ndoshta ishin dinosaurët. Po, e di, shumë njerëz nuk mendojnë se dinosaurët kanë ekzistuar, por besoj se kjo është një përgjigje për të parë se tregimi standart i paraqitur nga shkenca nuk ka kuptim. Pra, i gjithë koncepti i dinosaurëve

refuzohet. Këtu mundet të ketë ndonjë përgjigje për dinosaurët dhe poashtu edhe për ne, dhe Robert Monroe mund të ketë dhënë udhëzimet drejt kuptimit të saj.

Me dinosaurët si krijimet e para, Demiurge ose e kuptoi në kohë se ata nuk mund të siguronin një përmbajtje mjaft të lartë të looshit, ose dinosaurët gjetën një mënyrë për të bllokuar të korrat. Rrjedhimisht, ata u fshinë nga rivendosja e parë (kjo është arsyeja se pse historia e dinosaurëve priret të jetë kaq e diskutueshme). Nuk ishte se fundi i tyre erdhi nga një asteroid aksidental. Mund ta shohësh atë event sikur të ishte përmbytja e parë - një akt shkatërrimi i paramenduar. Libri i Monroe pretendon se të reja krijesa u krijuan më pas, të cilat duken si bimë dhe kafshë moderne. Ndoshta në këto versione të hershme ishin edhe krijesat që ne sot i quajmë neandertal dhe kro-magnon. Këta të dy duken se janë shumë më të përshtatur me këtë mjedis, me qime të dendura trupore që vepronin si një lloj leshi dhe që do të reduktonin nevojën për veshje.

Mbikëqyrësit e eksperimentit vunë re se kur krijesat luftonin për burime të pakta, ose konflikte shfaqeshin, të korrat e energjisë loosh ishin shumë më të larta. Kjo është arsyeja pse kafshëve u jepeshin dhëmb, kthetra ose shpejtësi të mëdha; për t'i zgjatur sa më gjatë këto "luftëra deri në vdekje", duke krijuar kështu edhe më shumë zhgënjim. Më shumë vuajtje, veçanërisht para vdekjes, do të thotë më shumë loosh. Kjo mund të jetë gjithashtu se si sistemet e sakrificës njerëzore erdhën në shfaqje, një kërkesë nga "zotërat" për t'u dhënë atyre një spektakël të mirë vdekjeje me vuajtje si ushqim dhe argëtim të kombinuar, dhe me shpresën se zotat nuk do të "hanin" atë të cilin po kryente sakrificën. Jo vetëm që atje do të kishte një korrje të mirë të energjisë loosh, por edhe që të mund t'i bënë njerëzit që e bënin këtë të besonin se po ata "qetësonin perënditë" dhe po i bënin gjërat më mirë dhe më të sigurta këtu në Tokë. Edhe Jezusi ishte një sakrificë gjaku. Ata zbuluan gjithashtu se vuajtja, veçanërisht frika e jashtëzakonshme, do të prodhonte gjithashtu më shumë loosh, dhe si e tillë sfera u modifikua për të gjeneruar frikë të vazhdueshme. Sigurisht, me kalimin e kohës, kontrolluesit arritën të kuptonin se ata nuk kishin nevojë as të krijonin kërcënime reale që njerëzit të kishin frikë, ata thjesht duhej të prezantonin "lajme" se atje mund të jetë një kërcënim, dhe kjo doli të ishte e mjaftueshme.

Konflikti, sakrifica dhe ushqimi për perënditë u paraqitën gjithashtu në artikujt e Bronte Baxter mbi këtë temë, të ngjashme me atë që Monroe po prezantonte nga tekstet e lashta të Indisë, "Universi mbështetet nga sakrificat", (**Atharva Veda**) dhe "Vdekja (si Krijuesi) vendosi të gllabërojë gjithçka që ai kishte krijuar; sepse ai i ha të gjitha... Ai është ngrënësi i të gjithë universit; i gjithë ky univers është ushqimi i tij." (**Mahabharata**)⁴⁵

⁴⁵ Bronte Baxter https://www.bibliotecapleyades.net/vida_alien/alien_archons93.htm

Me realizimin se konflikti siguroi korrje loosh më madhështore, Monroe shkroi se qëniet krijuese rivendosën botën e mëparshme dhe sollën këtë botë të re si një eksperiment të ri. Kjo botë e re përfshinte një qënie të re... ne. Ne u krijuam si një krijesë për të gjeneruar këto nivele të larta konflikti dhe për të shkaktuar këto nivele të larta vuajtjesh që kontrolluesit e këtij eksperimenti duan. Shpirti i njeriut nuk dëshiron vuajtje dhe konflikt – kjo është ajo që kontrolluesit e këtij eksperimenti duan.

Sigurisht, unë kam dhënë një analizë të shkurtuar të kapitullit të Monroe. Unë të sugjeroj që ta lexosh vetë atë nëse ke akses në atë libër. Jeta e Monroe bëhet shumë e çuditshme pas kësaj eksperience. Pretendohet se ai së pari kaloi në një depresion dy-tre javor. Dhe kur doli prej saj, ai shkroi atë kapitull, pastaj nuk foli më rreth kësaj teme. Edhe instituti i tij, qendra më e madhe kërkimore OBE në llojin e saj, në përgjithësi nuk ka asgjë për të thënë rreth kapitullit të dymbëdhjetë, energjinë loosh apo korrjen e energjisë nga qëniet aliene. Thjesht për argëtim unë shkova në faqen e internetit dhe kërkova termin "loosh". As edhe një link nuk gjëndeja. Ai ishte themeluesi i këtij koncepti dhe faqja e institutit të tij as që e përmënd atë. Sa e çuditshme është kjo?

Unë mund të marr historinë bazë të Monroe dhe të shtoj më shumë ide bazuar në njohuritë dhe përvojat e mia. Me kalimin e kohës, kontrolluesit e këtij eksperimenti vendosën të na dobësonin mendërisht dhe na dhanë një mendje të vetë-rëndësishme. Njerëzit janë në fakt qënie të fuqishme në këtë fushë, por kjo fuqi është fshehur dhe mbuluar qëllimisht nga ne. Njerëzit e rinj u krijuan për të mos mbijetuar lehtë në këtë sferë, pra për t'u ndjerë vazhdimisht jashtë balancës, sikur ne "duam" zotërat që të na tregojnë se çfarë të bëjmë dhe si të jemi. Ata na thanë se ne duhej t'u besonim atyre, dhe më pas na dhanë para, ligje, qeveri dhe të gjitha sistemet e tjera të kontrollit për t'u siguruar që ne të ishim "të korrallizuar" lehtësisht. Kështu, kontrolluesit e eksperimentit janë të ngjashëm me fermerët modernë që kujdesen për delet ose lopët diku në një hambar gjatë dimrit - duke u dhënë atyre aq sa për të korrur pasurinë që ato japin, por jo aq sa për të jetuar pa fermerin. Fermeri mendon se ai e di se çfarë është më e mira për kafshën, se ai është mbi to, se kafsha është atje vetëm për përdorimin e tij, për t'i bërë fermerit më shumë para, kështu që ai është në gjëndje të ndërtojë një kuvertë të re ose të blejë një traktor të ri.

Gjatë rrugës, atje ka pasur shumë mini-rivendosje për të thurur gjërat aty-këtu. Teoria standarte alternative rreth rivendosjeve të kaluara priret të jetë se "njerëzit po bëhen shumë më të zgjuar" ose "shumë nga ta po i kuptojnë gjërat", kështu që sistemi

duhet të na ndalojë. Ky është një mendim i vetë-rëndësishëm. Rivendosjet në koren e tyre kanë të bëjnë thjesht me energjinë.

Një teori është se i gjithë sistemi i inteligjencës artificiale kompjuterike 'AI' ka nevojë për përmirësime të energjisë, dhe si e tillë ata po përmirësojnë krijesat kryesore që gjenerojnë loosh në këtë sferë. Kjo mund të jetë se çfarë rivendosja e tanishme që ne po kalojmë ka të bëjë rreth - ne po "përmirësohemi" (upgraded) për të prodhuar korrje më të mëdha energjie në të ardhmen. Nuk ka të bëjë fare me tregtinë, biznesin apo atë se çfarë njerëzit zotërojnë. Këto janë të gjitha drejtime të gabuara drejt pamjes më të madhe. Është e gjitha rreth të krijuarit një njeri të ri loosh, në këtë rast një që është një pjesë-njeri, një pjesë-robot, një që është nën kontroll dhe mbikëqyrje totale. Elita e sferës tonë janë fermerët, dhe ata punojnë për të na mbajtur të mbështjellë dhe të shpërqëndruar derisa të vijë kamioni i therjeve për të na marrë.

Këtu është se ku ne kemi qënë prej shekujsh, të mbyllur larg fuqisë sonë natyrore, duke jetuar një gënjeshtër të injorancës. Disa e thyjnë atë dhe shkojnë përtej saj. Ata njihen si shamanë, por priren të nënvlerësohen nga pjesa tjetër e deleve. Minionat po kryejnë për kontrolluesit konfigurime drejt një bote ku kur dikush thyen kondicionimin ai duhet të bëhet si një shaman, duke e bërë kështu rifitim të fuqisë së vërtetë të dikujt, pothuajse të pamundur për masat.

Ka një pyetje pa përgjigje në prezantimin e Monroe megjithatë. Nëse shpirtrat tanë janë ata që janë bllokuar në këtë sferë materiale dhe nëse shpirtrat tanë janë mashtruar nga Demiurge për të rihyrë këtu kur ne vdesim (siç sugjerohet nga Katarët), atëherë kur u mashtruan fillimisht shpirtrat tanë për të qënë këtu? A ishin shpirtrat këtu në kohën e dinosaurëve, dhe nëse po, në çfarë ishin ato shpirtra të bllokuara apo të përmbajtura brënda? Dinozaurët? Njerëzit e hershëm? Hapësirë shpërbërë? Besimi standart rreth kësaj, është se vetëm shpirtrat njerëzorë janë të bllokuar këtu. Pra, kjo do të thotë që ose shpirtrat njerëzorë u mashtruan vetëm disa mijëra vjet më parë (kur kjo rivendosje dhe krijim madhështor aktual ndodhi), ose shpirtrat nuk janë aq "të specifikuar" sa ne mendojmë, dhe mund të përmbahen brënda çdo krijese të krijimit. Kur ti e sheh se një qen, gjirafë, korb, pemë ose shkëmb ka një shpirt po ashtu si ty, kjo ndryshon gjithashtu mënyrën se si një person ndërvepron me botën.

E gjithë kjo simbolizohet nga filmi i animuar *Monsters Inc.* Pjesa më e madhe e filmit ka të bëjë me atë se si qëniet në "botën e përbindëshave" duhet të vijnë në sferën njerëzore për të marrë britmat e fëmijëve (të të gjithë njerëzve) për të fuqizuar botën e

tyre. Ky është pak a shumë ky realitet me pak fjalë. Sigurisht që filmi e rrotullon rrotën drejt "fundit të lumtur përrallor" ku përbindëshat mësojnë se e qeshura u jep atyre më shumë energji sesa frika. Jo. Nëse qëniet që e drejtojnë këtë realitet do ta besonin këtë, ata do ta kishin ndryshuar eksperimentin shumë kohë më parë. Ata kanë testuar propabilitete loosh për një kohë të gjatë. Rivendosjet kanë të bëjnë me ndryshimin e të korrave të energjisë loosh. Ata tani mendojnë se të korrat nuk po u japin atë që ata kanë nevojë, ndoshta sepse sistemi po bëhet më i madh, ose po ecën shumë më shpejt nga sa ishte imagjinuar. Ndryshimi në nivelin tjetër trans-njerëzor është të krijojë një korrje edhe më të mirë të loosh. Të kyçur në një realitet artificial AI (si matriks) mund të jetë preferenca e eksperimentit të ri të korrjes së kontrolluesve.

- **Karlos Kastaneda**

Karlos Kastaneda e trajtoi këtë temë në dy nga librat e tij. Një është në *Dhurata e Shqiponjës* ku ai diskuton idetë e një Demiurge, tjetri është libri i tij i fundit *Ana Aktive e Pafundësisë* ku ai diskuton korrjen parazitare të energjisë sonë. Unë do t'i shqyrtoj prezantimet e tij në mënyrë më të detajuar në një kapitull të ardhshëm (pasi *Ana Aktive e Pafundësisë* nuk është libri që njerëzit besojnë se është, ai libër është diçka shumë më i rëndësishëm për studimin tonë rreth kurtheve të rimishërimit), por tani për tani po bëj një përmbledhje të shpejtë nga këto dy pjesë të librave.

Dhurata e Shqiponjës përfshin një paraqitje të një force që krijoi të gjithë jetën, të cilën ai e quajti Shqiponjë. Ajo nuk ishte një shqiponjë e vërtetë, por thjesht u shfaq si një shqiponjë për ata që e shihnin. Kjo Shqiponjë, duke krijuar këtë realitet, është gjithashtu përgjegjëse për atë që ndodh në vdekje, dhe të gjithë ata që vdesin do të përballen me këtë Shqiponjë. **"Shqiponja po gllabëron vetëdijen e të gjitha krijesave që, të gjalla në tokë një moment më parë dhe tani të vdekura, kanë lundruar në sqepin e shqiponjës, si një tufë e pandërprerë e fishekzjarreve, për të takuar pronarin e tyre, arsyen e tyre e të pasurit jetë... Shqiponja i zgjedh këto flakë të vogla, i ul ata në shesh, ashtu si një regjës lëkurërash zgjat lëkurën, dhe më pas i konsumon ata; sepse vetëdija është ushqimi i shqiponjës."**⁴⁶ Këtu është një mesazh kyç që libri po prezanton, këtu Kastaneda nuk është në vetvete duke pretenduar se Shqiponja (Demiurge) është duke ngrënë energji, por specifikisht është duke ngrënë përvojat tona të jetës. Kjo është ajo që ajo do. Si e tillë, përmbledhja e jetës është e një rëndësie kritike, sepse nëse ne ia kthejmë përvojat e jetës asaj përpara se ne të vdesim, nuk është nevoja që ne të gëlltitemi nga ajo. Ne më pas mund

⁴⁶ *Dhurata e Shqiponjës* nga Carlos Kastaneda

të gjejmë diçka që ai e quajti "një çarje ose një moment shanci", për të "kaluar si shigjetë përpara Shqiponjës për të qënë të lirë". Kjo gjithashtu është një e dhënë, sepse ajo do përvoja jetësore, kjo do ta bënte këtë sferë një lloj eksperimenti. Unë e diskutoj këtë më shumë në kapitullin e fundit.

Në kapitullin "Hijet e baltës", në librin e tij, *Ana Aktive e Pafundësisë*, Kastaneda diskuton qëniet parazite. Është interesante që ai priti pothuajse deri në kapitujt e fundit të librit të tij të fundit për ta zbuluar këtë për publikun. I thjeshtuar, mesazhi i tij është duke thënë se qëniet inorganike, të quajtura "predator" ose "fluturues", i kanë kthyer njerëzit në një burim ushqimi. Ajo që ata specifikisht hanë është një pallto energjetike që ai e quan "Palltoja Vezulluese e Vetëdijes". Kjo pallto duhet të jetë e ngjashme me atë që Robert Monroe nënkuptoi me Loosh. Ajo cfarë predatori bëri për t'u siguruar që ne të ishim kafshë të mira ferme ishte të na jepte mëndjen e tij, atë që Kastaneda e quante "instalim i huaj parazit". Kjo mëndje krijon konflikte, konfuzion, depresion, frikë, zemërim, faj dhe të gjitha disponimet negative. Duke vërtetuar që gjëndjet e mira prodhojnë energji të korrshme poashtu, por thjesht një "notë më të ulët". Kjo mëndje parazite mbizotëroi Mëndjen tonë të Vërtetë (e cila ishte në ne përpara se paraziti të instalohet), dhe pjesa më e madhe e gjysmës së parë së *Ana Aktive të Pafundësisë* është të rifitojmë këtë lidhje me mëndjen tonë reale. Rishikimi i jetës është gjithashtu pjesë e këtij procesi.

Ajo që është më interesante në këtë kapitull, është se Don Juan (mësuesi i Karlos) ofron sugjerime se si të çlirohemi nga Predatori. Pretendimet e tij nuk ishin të dilje atje jashtë dhe të rregulloje botën, por të përqëndroheshim në vete, për të "disiplinuar veten deri në atë pikë sa ata nuk do të na prekin". Disiplina në këtë rast nuk nënkupton rutinat e përditshme ose fokusin, por "kapacitetin për të përballuar shanset që nuk përfshihen në pritshmëritë tona - arti i përballjes me pafundësinë pa u dridhur, jo sepse ata janë të fortë dhe të ashpër, por sepse ata janë të mbushur me frikë." Duke ruajtur atë që Kastaneda e quajti "Heshtja e Brëndshme", dikush mund ta bënte Pallton Vezulluese të Vetëdijes "të papëlqyeshme" për flututuesit. Ne nuk i sulmojmë ata, ne e bëjmë këtë në mënyrë që ata të mos e pëlqejnë shijen e energjisë sonë loosh, kështu që ata ndalojnë së provuari së na ngrëni. "Truku madhështor... është të taksosh mëndjen e fluturuesit me disiplinë, me heshtje të brëndshme, dhe instalacioni i huaj do të ikë."⁴⁷

Se si kjo funksionon saktësisht unë nuk mundem ta di me siguri. Ajo që unë mund të them është se në periudhat kohore kur unë isha më i fokusuar në qetësinë mëndore, dhe

⁴⁷ Kastaneda, *Ana Aktive e Pafundësisë* faqa 221-226

jo aq shumë si një lloj meditimi, thjesht një fokus i qartë në çfarëdo gjë që unë po bëja; unë përjetova më pak gjimnastikë të egër mendore që vërtitej për qark vazhdimisht. Kur unë e shtova këtë në ushtrimin që Kastaneda e quajti "mënyra e duhur e ecjes", atje kishte periudha të gjata kohore ku mendimet nuk shfaqeshin. Unë nuk po i detyroja ato të ndalonin, thjesht mënyra se si unë po ecja duke u fokusuar kaq shumë në botë sa mendimet nuk mund të shfaqeshin. Ndoshta një pjesë e asaj që është duke u ngrënë nga fluturuesit është vetë mendimi. Rikujtohu që ne kemi një thënie shumë të çuditshme kur ne i bëjmë një sugjerim interesant dikujt, "kjo është ushqim për mendim."

Ekziston një tjetër histori origjine që unë dua ta përmënd shkurtimisht, sepse është ajo që disa lexues këtu mund ta kenë hasur. Problemi është se është e vështirë të dihet nëse historia është e rreme, e vërtetë, dis-informatë apo të gjitha më sipër. Dhe është një histori shumë e çuditshme. Në vitin 1998 atje ishte një nga ndjesitë e para të internetit rreth një uebsajti të ri të njohur si wingmakers. Ajo faqe tani është fshirë, por një e ngjashme zuri vëndin e saj menjëherë më pas, e cila vazhdon edhe sot. Miliona erdhën në atë uebsajt, gjë që sugjeroi se qeveria Amerikane në vitet 1970 kishte gjetur një alien të lashtë, ose siç mund të quhet më mirë, një kapsulë kohe. Historia përfshin një Tokë që është një kopje dhe shpirtra që bllokohen, mashtrohen për të banuar në trupa fizikë. Por historia e faqes në internet dhe gjithçka tjetër është thjesht e çuditshme. Unë po i lë gjurmët për përmbledhjen e historisë nga Wes Penre dhe për në faqen e re të wingmakers më poshtë, në rast se ti vendos ta kontrollosh.⁴⁸

• Vizioni

Ekziston një tjetër këndvështrim për këtë sferë dhe pse ne ndodhemi në këtë situatë që ne jemi. Unë kam aluduar vetëm për të në këtë pikë të librit, por do ta ndaj atë pikëpamje tani. Unë e pata këtë vizion në vitin 2009. Vizioni im ishte se nuk ishte Demiurge ai që na bëri ne, por natyra, për të na ndihmuar të gjejmë një rrugë shpëtimi nga Demiurge. Vizioni indikon se Demiurge krijoi botën, por natyra na bëri ne, dhe kjo është arsyeja që arkonët dhe minionët e tij në botë po përpiqen kaq shumë të na ndalojnë dhe të na ngadalësojnë.

Duke parë prapa në atë përvojë, ajo që ishte krejt e bashkë-rastësishme, ishte se për të "pasur këtë vizion", në udhëtimin e ëndrrave të mia, unë shkova në një "shpellë". Ajo që

⁴⁸ <https://wingmakers.com/about/ancient-arrow-site/>

<https://docs.google.com/file/d/0B5RUtnz0S-o6S2xiMzVTaThib3dhTTIMUGd0cUI3SG9NQ2JV/edit?resourcekey=0-C9sYLSdqSJAhHilBrEtYzw>

<https://wespenre.com/tag/james-mahu/>

është gjithashtu shumë interesante ishte se si unë u ndjeva kur unë dola, u rifreskova dhe u rinovova. Unë e kam lënë vizionin ashtu siç është, por kam përfshirë kllapa të dyfishta rreth një ideje që unë kam shtuar që jep një tjetër këndvështrim mbi atë se çfarë vizioni original mund të ketë drejtuar drejt. Ky vizion pretendon se e gjithë natyra është në kurth, por ky vizion nuk më tregoi se si ajo (natyra) ishte krijuar, se cili kishte qënë kurthi origjinal për të, dhe as se si shpirtri gjallëron (animon) njeriun.

Në fund të vitit 2009, një zjarr alkimik i brëndshëm filloi të digjej në brëndësinë time. Pjesët e fshehura të strukturave të mia egoike që unë mendoja se ishin zhdukur prej kohësh dolën në sipërfaqe, duke sjellë me vete shumë dhimbje dhe konfuzion, të shoqëruara nga zjarri i brëndshëm që dukej nuk se do të shuhej. Demonët dhe forcat e errëta filluan të rrisin sulmet e tyre. Nga njëra anë unë pyesja veten, po pse vallë? Pse të sulmohet një njeri në vështirësi?! ti sulmon kur dikush duhet të ndalohet? Unë u mora me këtë, natë pas nate me nga një orë gjumë dhe shumë pak interes për të ngrënë. Duke vuajtur në brëndësi për gabimet e mia dhe për mungesën e besimit tim në të gjitha dhuratat që më ishin shfaqur. Kalova një fundjavë me një shërues nativ, Xherrin, dhe gjatë asaj fundjave m'u shfaq ky vizion "i vjetër". Qysh në moshë e ndjeja se kjo ishte ajo që u erdhi njerëzve të hershëm 100,000 vjet më parë për të shpjeguar se kush ne ishim, nga ne erdhëm dhe çfarë ajo do të thotë.

“Përara se njerëzit e parë u shfaqën, atje kishte gurë, pemë, bimë, kafshë, ujë. Një ditë ata e kuptuan se me gjithë dukjen e lirë dhe paqen, ata ishin në kurth në një lloj ripërsëritje. Ata panë se çfarë nevojitej të bëhej që të gjithë ata të fitonin lirinë e tyre, por ata vetë (natyra) nuk mund ta kryenin këtë veprim. Ata patën një takim se çfarë të bënin rreth kësaj.

Ata i kërkuan ndihmë nënës Sofia. Sofia e lejoi natyrën të krijonte një qenie të re për t'i ndihmuar ata të bënin atë që ata nuk mundën. Natyra i krijoi njerëzit si forcë aktive për të hapur derën e lirisë për të, dhe për të na ndihmuar ne (qëniet njerëzore), natyra do të ishte udhërrëfyese ynë. Natyra i krijoi njerëzit nga të gjitha pjesët e saj: një bimë, një shkëmb, një pikë uji, një shpërthim ajri dhe një kafshë, të gjitha kombinuan forcat e tyre. Pjesa animaliste që erdhi për çdo njeri individual tani quhet "fuqi" ose kafshë "totem", sepse ajo është pjesa më e lehtë për të arritur nga forcat e natyrës që na krijuan ne. Të gjithë njerëzit u krijuan në të njëjtën kohë, por që sillleshin në botën e manifestuar vetëm sipas nevojës. Dhe më pas ata na kërkuan të bënim gjëra që duheshin të bëheshin për ta.

Kjo është arsyeja pse natyra na lejon që ne ta përdorim atë. Sepse ne jemi pjesë e natyrës, jemi këtu për të bërë një punë për natyrën, ishin ata që na kërkuan ne të ishim këtu dhe që na krijuan ne. Kjo është pse pemët e lejojnë veten të priten për ngrohtësi ose pse një dre e lejon veten të vritet për mish. Ata e bëjnë këtë si një sakrificë për ne, në mënyrë që njerëzit të vazhdojnë të përmbushin pikërisht rolin e vetëm për të cilin ne jemi krijuar. Nëse ne mund ta plotësojmë atë, atëherë jo vetëm të gjithë njerëzit, por edhe e gjithë natyra, do të jenë të lirë. Përsëritja do të përfundojë. Natyra mund t'i çojë njerëzit me udhëzim në atë portë, por ajo ka nevojë për njerëzit që të ecin përmes saj.

Kur natyra i kuptoi këto gjëra për herë të parë, ata gjithashtu panë se ekzistonte një forcë e errët që mbante gjithçka të mbyllur në një ripërsëritje të çuditshme të vazhdueshme të kohës. Në fillim kjo errësirë nuk kishte nevojë të bënte shumë, sepse kishte pak që natyra mund të bënte vetë për t'i dhënë fund, sepse natyra ishte vendosur si një përsëritje, "cirku i jetës", ((zinxhiri ushqimor)). Natyra nuk mund të përfundonte ripërsëritjen pa përfunduar veten. Kjo është arsyeja se pse natyra krijoi njerëzit. Dhe kjo forcë e errët e kuptoi menjëherë se njerëzit ishin një rrezik për të gjithë sistemin. Forca e errët krijoi një kundër-forcë nga vetja që kishte detyrën e vetme për t'u siguruar që njerëzit nuk mund ta përfundonin detyrën e tyre. ((Ti mund ta shohësh këtë si një ushtri me z. Smiths të Matrix)). Sepse nëse njerëzit do të kishin sukses, e gjithë natyra do të ishte e lirë dhe forca e errët nuk do të kishte ku të shkonte. Forca e errët varet nga përsëritja e vorteksit.

Kjo është pse kjo forcë e errët sulmon njerëzit kaq fort, por që rrallë ajo force sulmon natyrën drejtpërdrejt. Natyra ngreh pikat e fuqisë, vënde me energji të fortë ku njerëzit mund të shkojnë dhe të mbajnë një komunikim të hapur me shpirtrat e natyrës - dhe me shpirtrat që jetojnë në sferën mbi natyrën. Njerëzit e hershëm ndërtuan tempuj dhe struktura këtu për ta bërë këtë komunikim, ose për të përforcuar fuqinë e asaj që atyre iu tregua. Forca e errët e pa këtë, kështu që kaloi shumë nga koha e saj duke u përpjekur të fitonte kontrollin e këtyre pikave të fuqisë, të cilat janë hapjet e drejtpërdrejta të komunikimit midis natyrës dhe njerëzve. Ndërsa më shumë nga këto pika u pushtuan nga forcat e errëta, natyra kaloi në një mënyrë të re për të komunikuar që megjithëse nuk ishte aq e qartë dhe e përsosur (si një linjë telefonike gjysmë e prishur), ishte një linjë që forcat e errëta nuk mund ta prisnin. Natyra u dha njerëzve ceremoni, dhe mjete elektrike që në një farë kuptimi do të krijonte një hapje të vogël energjie ku ceremonia performonte.

Ndërsa njerëzit mësuuan më shumë dhe fituan më shumë të kuptuar se çfarë ky vënd është dhe se kush puna jonë është këtu (qëllimi), forcat e errëta u deshën të rrisnin sulmet edhe më shumë, dhe kështu manifestuan një "forcë të gjeneruar nga kompjuteri" të sulmit suprem në brëndësi të gjëndjes së ëndrrave. Një pjesë e punës së tyre ishte të bënin gjithçka për të bllokuar ceremonitë që u jepeshin njerëzve nga natyra, dhe kështu filluan kundër-ceremonitë "rituale satanike" të tyre ((komplet të kundërta)), kushtëzime subkoshiente dhe kontroll mendor". Një nga përpjekjet e forcave të errëta më të mahnitshme për të ndaluar njerëzit ishte të na jepnin ne një lloj virusi mendor, një mëndje parazite; mëndja egoike kjo. Ky virus u përhap derisa shumë pak mund ta kuptonin se atje ishte një kohë kur ajo dukej sikur nuk ishte atje, dhe kështu askush nuk e vuri në dyshim origjinën e mëndjes egoike. Megjithatë, çdo vepër shpirtërore në histori flet për rreziqet e mëndjes sonë. Por pse duhet që mëndja jonë të jetë e rrezikshme nëse ajo është e jona? Dhe kjo është pika që ata humbasin. Kjo mëndje nuk është e jona; ajo është mekanizmi bllokues i këtyre forcave të errëta. ((Këto forca të errëta me kalimin e kohës i kanë bërë njerëzit të harrojnë gjithnjë e më shumë se pse ne jemi këtu. Shumë njerëz madje e kalojnë kohën e tyre duke shkatërruar dhe dëmtuar natyrën dhe krijesat e saj, pikërisht të njëjtat gjëra që na dhanë ne jetën tonë origjinale)).

Natyra e di rrugën e daljes jashtë. Natyra e di se ku është dera dhe çfarë të bëjë. Ajo do që të na çoj ne në atë derë. Por natyra e di gjithashtu se së pari ky virus-parazitar (mëndje egoike) duhet të hiqet. Dhe kjo është shumë më tepër se një sfidë nga sa cdokush e kupton të jetë. Vetëm kur ai parazit të jetë zhdukur plotësisht natyra mund të kthehet në bisedë të drejtpërdrejtë me ne, duke na udhëhequr dhe duke na treguar se çfarë duhet bërë. Natyra mund të përcjellë mesazhe, të sigurojë energji, të hapë blloqe, por ne do të duhet të bëjmë pjesën tjetër. Natyra nuk është në asnjë mënyrë e ndarë nga ne, ne vijmë drejtpërdrejtë prej saj. Ka një arsye që miti i krijimit i ka bërë njerëzit nga balta e Tokës. Ajo është një simbol i të thënit se krijuesi ynë është vetë natyra, Toka e lejoj krijimin nga natyra të jetë. Toka nuk është nëna jonë, por GJYSHJA jonë. Kjo është pse në shkrimet e vjetra natyra nuk ishte vetëm femër, por edhe mashkull, ajo i përmbledhë të gjitha.

E gjithë struktura e njohurisë së njeriut të hershëm, mitologjia, tekstet dhe përrallat më të hershme njerëzore u transmetuan për breza me radhë, dhe në vetë koren e saj është rreth këtij krijimi, dëshirat e natyrës për ne, dhe forcat e errëta që po përpiqen ta ndalojnë këtë që të ndodhë. Kur ne të afrohem në këtë vënd brënda dhe jashtë, ne do të dimë saktësisht se çfarë na kërkohet të bëjmë,

dhe pastaj ne mund ta bëjmë atë dhe t'i japim fund ciklit njëherë e përgjithmonë. Nëse nuk e bëjmë, cikli do të rivendoset dhe gjithçka fillon nga e para.

Ky është vizioni që u prezantua në mua në shpellë. Faleminderit."

Nëse e vëren, në fund të këtij vizioni unë përdora fjalën "rivendosje". Kjo përmbledhje u shkrua në vitin 2009, shumë kohë përpara se ajo fjalë të përdorej shpesh në jetën e përditshme siç ajo sot është. Fillova duke thënë se natyra ishte "në kurth". Nuk kishte asnjë shpjegim se si ajo ishte në kurth specifikisht, por kjo ishte fjala që erdhi në vizionin tim. Ajo që gjithashtu e bën këtë vizion kaq interesant është se ne nuk jemi në kurth drejtpërdrejtë nga Demiurge, ne jemi të bllokuar sepse vijmë nga ajo që tashmë është bllokuar, nga "natyra". Por brënda njerëzve është një pjesë e veçantë që do të lejonte, jo vetëm daljen tonë, por për të gjithë natyrën, në fakt të gjithë sferën. Prandaj, vizioni im është shumë i ndryshëm nga mitet e krijimit Gnostik dhe Katarëve, të cilët besonin se shpirtat e njerëzve ishin mashtruar për të hyrë në materie. Bën një ndryshim madhështor të mendosh se ne mund të jemi një shpirt "jo-individual" siç ne mendojmë normalisht për të, por në vënd të kësaj të mund të jemi të lidhur me shpirtat e natyrës. Ndoshta çdo njeri që përfundon ciklin e rimishërimit merr pak nga natyra bashkë me të, kur ne largohemi.

Unë nuk mund të jem i sigurt se cila histori është konkretisht e vërtetë. A jemi ne shpirta që jemi mashtruar për të ardhur këtu nga Demiurge/Satan siç thonë Gnostikët dhe Katarët? A po jetojmë në atë që dikur ishte një lloj parajse e bukur përpara se forcat e errëta ta pushtonin atë dhe të burgosnin të gjithë jetën, siç mund të sugjerojnë Kastaneda dhe vizioni im? A jemi ne krijesa loosh që u krijuan nga Demiurge shumë kohë më pare se fillimi i kësaj sfere filloi? Gjithçka që unë mund të them është se ne duhet t'i mbajmë të hapura të gjitha opsionet. Përfundimi është se në një mënyrë apo tjetër ne jemi pjesë e një bote fermë të ngjashme me një burg, dhe forcat e errëta po punojnë për të na mbajtur në kurth dhe të mashtruar, duke u rimishëruar përsëri dhe përsëri një mjedis energji-korrëse ripërsëritëse.

Disa mund të thonë se njerëzit janë një eksperiment i dështuar, dhe ne duhet të eliminohehi. Bazuar në mënyrën se si ne jemi sjellë dhe kemi keqtrajtuar planetin dhe njeri-tjetrin, unë mund të shoh se si kaq shumë kanë ardhur në këtë përfundim. Por nëse kjo sferë nuk u krijua nga një Zot i dashur, por nga një Demiurge i ligë, gjithçka fillon të ketë kuptim. Njerëzit sillen në mënyrën që ne jemi të dizenuar për tu sjellë, dhe është e mahnitshme se sa shumë aktualisht mund ta thyejnë këtë kushtëzim dhe të sillen në një

mënyrë disi të arsyeshme. Nëse ti beson në një krijues të dashur, atëherë do të duket se njerëzit disi kanë dështuar këtu. Por kur ti sheh se i gjithë sistemi nuk është krijuar që njerëzit të jenë të sjellshëm, harmonikë ose të ekuilibruar, por përkundrazi që ne të jemi të tmerrshëm ndaj njëri-tjetrit për të korrur më shumë loosh, e gjitha kjo bëhet më e qartë. Nëse njerëzit do të jetonin në harmoni dhe do të silleshin mirë me njëri-tjetrin, do të kishte shumë më pak loosh për korrje. Unë besoj se entitetet kontrolluese u përpoqën njëherë për të na korrur në këtë mënyrë që në fillim (kujtimet historike të kësaj kohe ishin të një epoke të artë), por të korrat e energjisë loosh ishin shumë të ulëta nga ai sistem, dhe pasi ata panë se konflikti dhe vuajtja krijuan më shumë loosh, sistemi u ndryshua. Sistemi nuk ndryshoi sepse njerëzit donin që ta ndryshonin atë, por sepse ishte e dobishme për atë se kush dhe çfarë e kontrollon të gjithë këtë simulim. Simulimi tani është ngritur që njerëzit të jenë të vetë-rëndësishëm, manipulues, gomerë. Gjë kjo e cila e bën më të lehtë punën për të pranuar minionët e kontrolluesit si "super shëmbuj" prej nesh në sferën materiale. A mund ne të quhemi vërtet një eksperiment i dështuar nëse eksperimenti u ngrit qëllimisht që ne të dështojmë? A mundesh ti ta quash veten një humbës në një konkurs të ngritur qëllimisht në mënyrë që ti të mos fitosh?

Fitimi i objekteve dhe titujve në botën fizike nuk është një fitim, por shpërqëndrim egoist. Ne kemi fuqinë e brëndshme dhe mjetet e brëndshme për të rifituar tërësinë e njohurisë (Gnosis), dhe ne mund t'i përdorim këto dhurata për të parë të kaluarën e shumë fshirjeve të kujtesave, vuajtjeve të mëparshme, dhe kështu ta fokusojmë qëllimin tonë në një gjë: të kthehemi në Shtëpi. Kuptohet që ne duhet të jemi të kujdesshëm, pasi një tjetër nga truket e gjëndjes pas-vdekjes është që ta bëjë të sapo ndjerin të "ndihet" sikur një është në shtëpi (kam përdorur qëllimisht një 'sh' të vogël këtu). Në një nivel, shpirti është duke kërkuar për Shtëpinë (Sh e madhe), dhe si të gjitha truket këtu, një kopje po paraqitet si gjëja e vërtetë. Mos lejo që përvojat e "ndjeshmërisë së mirë" të të mashtrojnë që të mendosh se ti ke mbërritur kur ti ende je në anije në det thjesht duke u drejtuar në syrin e uraganit. Oqeani duket i qetë, por stuhia është afër. Shtëpi do të thotë Shtëpi. Nuk ka më truke, mashtrime ose gënjeshtër. Qëndro fuqishëm, njihe Fuqinë tënde të brëndshme, dhe mos u vendos për asgjë më pak se Shtëpia jote e Vërtetë.

4

EKSPERIENCAT STANDARTE PRANË VDEKJES

Pyetja jote kryesore teksa ti lexon këtë libër duhet të jetë gjithashtu, "pra çfarë?". Çfarë vlere ka ky informacion për situatën time aktuale? Kjo duhet të jetë pyetja jote me çdo libër që ti lexon ose video që ti shikon.

Dhe kështu, unë do të ndjek kapitujt kryesorë me seksione më të vogla ushtrimesh për ty t'i provosh, ose t'i mendosh si një soditje. Kjo nuk do të thotë që ti duhet të ndihesh i detyruar të bësh ndonjë nga sugjerimet e mia - ato janë thjesht treguesa. Ti nuk mund t'a mendosh rrugën tënde jashtë nga Shpella e Platos. Unë kam parë disa mendimtarë të mëdhenj që i përdorin mëndjet e tyre për t'u lidhur më thellë me këtë sferë, në vënd që t'i afrojnë ato më pranë daljes siç ata do të donin të besonin.

Një nga lexuesit e hershëm të testit të këtij libri bëri një sugjerim: "Pse nuk shton disa nga përvojat e njerëzve pranë-vdekjes, dhe të japësh një komentim rreth tyre? Kjo do t'i jap temës më shumë besueshmëri për të treguar se nga ti po i merr këto ide." Unë mendova se kjo ishte një ide e shkëlqyer. Ishte diçka që vetë e kisha planifikuar të bëja në vitin 2023, por kuptova se një pjesë e saj duhej të prezantohej këtu. Unë do të jap disa fragmente të përvojave reale që paraqesin bazën e asaj që ky libër diskuton, d.m.th. se sfera e pas-vdekjes është ngritur si një kurth.

Unë kam poashtu edhe përvojat e mia pranë-vdekjes (NDE – Near Death Experience). Ato janë paraqitur në librin tim *Falling For Truth*, dhe gjithashtu në intervista me video⁴⁹. Vetëm për shkak se unë kam disa njolla me vdekjen nuk tregon në asnjë mënyrë se unë e di se çfarë do të ndodhë kur ai moment të vijë. Unë kam disa ide, gjëra për t'u përgatitur. Megjithatë, askush nuk duket se e di me siguri se çfarë do të ndodhë. Dhe ky është një flamur madhështor i kuq për mua. Nëse përvoja e vdekjes do të ishte me të vërtetë për të shkuar në një Parajsë të mrekullueshme dhe të dashur, atëherë ne të gjithë duhet të dimë saktësisht se çfarë do të ndodhë. Qëniet mundet vetëm ta fshehin të vërtetën kur e dinë se ata që e dëgjojnë nuk do ta pëlqejnë atë.

⁴⁹ Versioni i gjatë i videos së përvojës sime në kanion <https://www.youtube.com/watch?v=nW4cmcf3-aU>. Pjesë më të vogla mund të gjënden gjithashtu në intervista të ndryshme që unë kam bërë në YouTube.

Shumica e përvojave të listuara vijnë nga faqja e internetit www.nedrf.org. Ata kanë mijëra raporte të dërguara nga njerëz normal për atë që atyre u ndodh në momentin e pranë-vdekjes. Mund të themi se mbi 85% e tyre janë histori standarte që dikush mund të pres që ato të jenë. Ne duhet të kuptojmë se vetëm për shkak se një përvojë e caktuar është e zakonshme, nuk do të thotë se ajo nuk manipulohet nga forca të jashtme. Përvoja standarte "shko tek drita" mund të jetë mashtrimi kryesor. Por është kjo 15% e përvojave që nuk i përshtatet normave që janë më të rëndësishme për ne, sepse këto mund të na afrojnë ne më afër drejt së vërtetës. Këta njerëz (15% e përvojave) kanë pasur eksperiencë ku ata thyejnë rutinën e hipnozës standarte dhe i shohin gjërat ashtu siç ato mund të jenë realisht në sferën e pas-vdekjes.

NDE standarte do të prezantohet këtu, ndërsa ajo jo-standarte do të diskutohet në kapitullin nëntë. Vetëm për shkak se unë po e quaj një NDE "standarte", nuk do të thotë se unë po e hedh poshtë ose nënçmoj atë në ndonjë mënyrë. Kam lexuar pothuajse njëqind prej tyre, dhe secila është magjepsëse, dhe disa janë thjesht të mahnitshme. Më poshtë janë disa përmbledhje për të ofruar një pikënisje të ngjarjes normale në këtë fushë të kërkimit.

Unë do të ndaj së pari përvojën e Gene Goodsky, gjetur në librin *Warrior Spirit Rising*, shkruar nga vajza e tij Dianna. Ai libër ka pothuajse çdo element që gjëndet në një NDE standarte. Është si të vijësh çdo kuti në një listë, të theksuara nga unë me shkronja të zeza. Kjo është pse unë e gjeta këtë kaq mahnitëse për ti lexuar kur unë e hasa këtë gjatë shkrimit të këtij libri.

Përvoja e Gene's filloi pasi ai ishte shumë i dehur për disa ditë dhe humbi vetëdijshmërinë në shtratin e tij në prag të vdekjes. Gjëja tjetër që ai kujtoi ishte **duke notuar mbi shtratin e tij**. Ai më pas u largua nga çatia e shtëpisë së tij me **qënie-tip-engjëjsh**, të cilët dukeshin si vëndas dhe flisnin gjuhën e tij. Ai u dërgua në vetë varrimin dhe gropën e varrit të tij. **"Të gjitha dhimbjet dhe vuajtjet e tij ishin zhdukur, shpirti i tij ishte i lirë."** Ai kaloi nëpër një derë, pa një **dritë të ndritshme dhe një tunel**. "Ai ishte i mbushur me një **ndjenjë të jashtëzakonshme qetësie, mirënjohjeje dhe dashurie**." Kjo pjesë tjetër është shumë unike dhe unë nuk kam dëgjuar kurrë për këtë në asnjë NDE: Ai pa njerëz me shkopinj në gojën e tyre, dhe ata nuk dukeshin të lumtur. *"Ai instinktivisht e dinte se ata kishin ngecur, ata kishin humbur."* Të komentosh se njerëzit ishin të humbur në vdekje është një mundësi shumë domethënëse.

Më pas, ai erdhi në **një urë** dhe e kaloi atë. Ai pa njerëz të trishtuar dhe të pakënaqur. Më pas ai e kuptoi se këta njerëz ishin vetë ai, në faza të ndryshme të jetës së tij. Ai i urrente fytyrat që ai shihte mbi veten e tij dhe gjithë dhimbjen që ai u kishte shkaktuar njerëzve të tjerë (një stil unik i **rishikimit të jetës**). Pastaj ai ishte në **një lum**, dhe një qën i madh i bardhë ishte atje. Pasi ai shprehu keqardhje të plotë për gjithçka që ai kishte bërë në jetën e tij, qëni kaloi lumin, erdhi tek ai, dhe ai e kaloi lumin në shpinën e qënit. Më pas ai pretendon se ka parë atë që ai e quajti "*ura e gjarprit*", një vënd ku mund të kalonin vetëm njerëzit shërues së fisit të tij, dhe duke qënë se ai nuk ishte vetë një i tillë (në atë kohë), ai nuk shkoi atje. Ajo që është interesante është se ai dinte për këtë urë. Ai më vonë u bë një shërues dhe kështu, në "*vdekjen e tij të ardhshme*", ai mund të shkonte pikërisht në atë urë që ai pa, por që u ndjeh i paaftë për të kaluar në këtë përvojë.

Gene tani po notonte në një rrugë, dhe pranë ishin të gjithë **njerëzit e vdekur që ai kishte njohur** në jetë. Ai shumë qartë vërehu **prindërit dhe gjyshërit** e tij. Më pas ai erdhi te një shërues që ai e kishte njohur më herët në jetë, i cili e drejtoi te një wigwam (shtëpi amtare) të madhe që shkëlqente nga drita. Brenda wigwam ishte një qënie me flokë të gjatë të bardhë, e veshur me të bardha dhe ishte burimi i dritës. Një përfaqësim i përsosur i një **qënie me dritë të bardhë**. Qënia e Dritës i tha Genes se **ai duhej të kthehej prapa**, se "**nuk është koha jote, ti ke njerëz për të ndihmuar**" (një mision). "*Ai nuk donte ta linte këtë paqe të sapogjetur që ai ndjente, por ai e dinte se duhej të dëgjonte njeriun me flokë të bardhë.*" Kjo është e zakonshme si në një NDE standarte poashtu edhe në ato për të cilat ti do të lexosh në kapitullin pesë - atë të dëshirës për të qëndruar në atë sferë paqeje, por që kthyer mbrapa, shpesh kundër vullnetit të dikujt. Gene udhëtoi përsëri përtej lumit, "*pastaj ai u zgjua. Lindi sërish... ai ndryshoi përgjithmonë.*"⁵⁰

Kjo përvojë është e vlefshme për t'u ndarë me ty, jo vetëm për faktin se sa pjesë të saj përbëjnë për përvojën standarte NDE, por edhe për atë që kjo bëri për jetën e këtij njeriu kur ai u kthye në jetë në Tokë. Ishte kjo përvojë që e ndaloi atë të ishte një alkoolist. Ai shkoi menjëherë në trajtim rehabilitimi dhe qëndroi i kthjellët gjatë gjithë jetës së tij. Ai përqafoi trashëgiminë e tij Ojibwe, u bë një shërues lokal, shëroi shumë njerëz në komunitetin e tij, si dhe mësoi gjuhën dhe kulturën e tij në shkolla dhe kolegje. Kjo përvojë e transformoi plotësisht këtë njeri dhe ai u bë një shtyllë e vërtetë fuqie për komunitetin e tij. Ky është pikërisht lloji i njeriut që ne të gjithë do të donim të takonim, ai që kapërceu vështirësi të mëdha në jetën e tij, demonët e tij të brëndshëm, dhe u bë një qënie njerëzore e mirë. Gene është një burrë me të cilin do të doja të pija një kafe.

⁵⁰ Goodsky, Dianna, *Rritja e Shpirtit të Luftëtarit*, faqa 89-96

Nuk po e ndaj historinë e tij për ta nënçmuar atë në asnjë mënyrë, por për të zbuluar se çfarë një NDE standarte mund të bëjë për dikë. Pothuajse gjithmonë, personi ndryshon, përgjithësisht në mënyra që e bëjnë atë më të sjellshëm, të hapur, të dhëmbshur dhe të dobishëm. Kjo është për shkak se ajo përvojë ka kaq shumë pozitivitet për njerëzit që e kalojnë atë, ndjenjat e dashurisë dhe paqes. Tingëllon mirë deri tani.

Këtu janë disa përvoja të tjera standarte pranë-vdekjes. Secila përfshin emrin e personit dhe kodin e numrit NDERF, kështu që ti mund të lexosh të gjithë përvojën e tyre në www.nderf.com, nëse dëshiron.

“Qënia kryesore tha se unë mësova mjaftueshëm për dijen, tani unë duhet të kthehesha dhe të mësoja për dashurinë. Informacioni për 'dashurinë' nuk është ai që ne mendojmë këtu në botën fizike. Dashuria nuk është seksuale apo posesive, por shpirtërore. Dashuria është më shumë si dhëmbshuri e pafund, pa gjykim.” Rhonda M 23499

“Pjesët e dritës më të afërta me mua ishin prindërit e mi, gjyshërit, familja që të gjithë kishin kaluar më parë - dhe larg, të lidhur me ta ishin miqtë e ngushtë, dhe të lidhur me ta ishin njerëzit që kishin ndikuar tek unë dhe tek të cilët unë kisha ndikuar (studentë, të njohurit, etj.) - dhe njerëzit me të cilët ata kishin bashkëvepruar, por të panjohur për mua, por të lidhur me mua nga ndërveprimi im me të gjithë ata që unë kisha njohur dhe takuar në jetën time dhe që kisha vazhduar më parë. Të gjitha ato pjesë të jetës tregonin se si jeta dhe veprimet e mia kishin ndikuar në të tyret.” Harry T NDE 9339

“Jo më unë ndjeva një barrë pikëllimi, jo më unë ndjeva dhimbje nga dëmtimet e mia kronike 40-vjeçare të shtyllës kurrizore, asnjë zi, pa kujtime, thjesht lirim absolut në Dritën e Dashurisë! Shtëpi, siç unë tani e kuptoj! Dashuri e pabesueshme!... Gjithçka ishte kaq e bukur dhe shëruese! Unë u ndjeva sikur isha tretur në Dritë, pa fjalë për të kapur ndonjëherë përvojën.” Joyce G 9301, 9406.

“Mua mu dha një rishikim jete ndërsa isha në brëndësi të boshllëkut. Gjatë këtij rishikimi, unë i thashë qënies të ndalonte. Unë doja të shqyrtoja më mirë pjesët e jetës sime. Më pas munda t'i shikoja këto ngjarje nga lart. Rishikimi i jetës nuk zgjati shumë sepse unë e pyeta qënien për diçka që e habiti atë. 'A mundem unë të planifikoj rimishërimin tim të ardhshëm?' unë pyeta. Qënia tha:

"Zakonisht njerëzit presin deri në vdekjen e tyre reale për të zgjedhur rimishërimin e tyre". *Niels W 9193*

"Një dritë brilante e pastër, shkëlqyese më përfshiu dhe unë nuk kisha më një trup fizik. Por, unë ende ekzistova? Unë nuk kisha sy për të parë, por shikoja gjithçka rreth meje. Isha në qendër së një asgjëje madhështore, por asgjëja nuk ishte bosh. Ajo ishte plotësisht e mbushur me praninë e Zotit të gjallë. Nuk ka fjalë në gjuhën angleze për të përshkruar se ku unë isha." *Star E NDE 9139.*

"Unë isha UNIVERSI në shprehje, dhe Universi ishte brënda meje, kjo mu tregua mua, UNE E DIJA këtë intimisht. Unë isha NJË me GJITHÇKA QË ËSHTË, GJITHÇKA QË NDONJERË ISHTE dhe GJITHÇKA QË NDONJËHERË DO TË JETË. GJITHÇKA QË EKZISTONTE ishte brënda meje... Mua në fakt më shfaqën një ekran filmi dhe më pas më treguan çfarë unë kisha bërë; duke jetuar jetën time... ekrani i filmit është i zi-bosh=perfekt derisa ti të fillosh të vendosësh PROJEKSIONE në të, atëherë çfarëdo që ti projekton mbi të është një 'EKSPERIENCË'... Unë arrita në një pengesë që nuk isha i lejuar të kaloja; ose u ktheva mbrapsht kundër vullnetit tim, dukej se unë nuk kisha një ZGJEDHJE. Mora një ZBULIM TË MADH dhe më pas dëgjova një ZHURME MADHËSHTORE 'POP', një KLIK dhe më pas u futa përsëri në trupin tim duke përkëdhelur veten, duke bërë titur. 'Jam GJALLË, JAM GJALLË, JAM GJALLË'. *Anne W NDE 9119*

(Në fakt, përvoja e saj dhe ajo që i ndodhi asaj më pas është mjaft e mahnitshme; ka kaq shumë shtresa në historinë e saj dhe unë e rekomandoj të lexohet)

"Në një pikë, një vello u hoq. Unë u tërhoqa në një tunel të gjatë dhe të errët që kishte një dritë shumë të ndritshme të bardhë që shkëlqente dashuri. Unë mund të dëgjoja harpa dhe pashë xhaxhain tim të madh Harry Ed dhe tezen Vickie. Unë isha në gëzim dhe lumturi totale. Unë isha në shtëpi. Nuk doja të kthehesha. Pata një përmbledhje të jetës ku pashë çdo ngjarje të vetme nga jeta ime. Pash çdo akt mirësie dhe dashurie, çdo akt inati apo keqdashje. Unë gjithashtu pata mundësinë t'a shoh atë nga këndvështrimi i personit tjetër." *Melinda G 9029*

(Një tjetër NDE kjo e detajuar që unë e rekomandoj të lexohet për të kuptuar më shumë mënyrën standarte të paraqitjes së NDEsë. Ajo është një tjetër person që duket se ka fituar aftësi shëruese dhe psikike me kthimin e saj në këtë sferë)

Nëse unë do të pyesja një person mesatar se si është një NDE, ata do të paraqisnin fjalët që shfaqen më lart: dritë e bardhë, tunel, dashuri, paqe, Zot, rishikim jete dhe të afërm. Kjo është ajo që e bën këtë të arrijë të shfaqet në TV dhe filma. Drita e bardhë është miku yt, ajo dritë do të të ngushëllojë dhe do të të heqë të gjitha dhimbjet. Drogërat e forta do të bëjnë të njëjtën gjë, kjo është pse njerëzit i përdorin ato, ato marrin tej dhimbjen... për pak kohë. Pastaj dhimbja rikthehet dhe ata kanë nevojë për më shumë drogë. Drita e bardhë mund të ta largojë dhimbjen edhe për një kohë, por çfarë nëse dhimbja dhe vuajtja rikthehen? Po sikur drita e bardhë të mos jetë porta për në Parajsë, por një rrëshqitje përsëri në këtë sferë vuajtjeje? Atëherë shumë nga ato që prezantohen në këto përvoja mund të jenë mashtrime. Një tjetër flamur i kuq në këto 'përvoja të ndjesisë së mirë' standarte, është se shumica e njerëzve kthehen kundër vullnetit të tyre. Në përgjithësi, ata të gjithë duan të qëndrojnë në dashurinë dhe paqen që ata ndjejnë, por një qenie "me të cilën ata mendojnë se duhet të pajtohen" u thotë atyre se ata duhet të kthehen, ose thjesht ajo qenie i detyron ata që të kthehen. Në përgjithësi, atyre u thuhet se ata kanë më shumë për të mësuar ose një mision për të përfunduar. Megjithatë, shumë po ashtu pretendojnë se ndërsa ata ishin në këtë sferë së pas-vdekjes, ata kishin akses në të gjitha njohuritë. Dhe kështu, çfarë më shumë duhet të mësojë një shpirt nëse tashmë ai është në një hapësirë ku ai tashmë di gjithçka? Çuditërisht, kjo pjesë e përvojës tenton të fshihet, pasi personi i kthyer fokusohet në dashurinë dhe lumturinë e gjithçkaje, ata harrojnë se "u kthyen në Tokë kundër vullnetit të tyre". Në kapitullin katër, disa njerëz do të kenë një mendim shumë të ndryshëm rreth të kthyerit me forcë përsëri këtu.

Po unë? Çfarë do të kisha bërë unë në një NDE timen nëse nuk do të dilja nga lumi dhe do të shkoja mbi ujëvarat dhe do të vdisja. Unë jam i sigurt se tuneli i dritës së bardhë do të ishte shfaqur përpara meje. A do të kisha hyrë unë në të? Ndoshta. Kjo është arsyeja pse unë nuk mund të gjykoj vendimet e askujt, apo atë që ata tani ndiejnë për përvojën. Megjithatë, ne po kërkojmë të dhëna dhe njohuri që do të na ndihmojnë ne të kuptojmë plotësisht jetën dhe vdekjen. Çfarë do të bëjmë ne kur të jemi në të njëjtën situatë? Është një pyetje e rëndësishme dhe unë do të rikthehem tek kjo ndërsa ky libër progreson.

Çfarë bën në të vërtetë drita e bardhë? A sjell ajo paqe dhe transformon jetën e dikujt (siç 85% e njerëzve që kthehen pretendojnë), apo është ajo pjesë e një cikli rimishërimi në një sferë vuajtjesh pothuajse të vazhdueshme, siç pretendojnë shumë prej 15% e njerëzve? Kur ti fut në lojë mësimet e urtësisë së Gnostikëve dhe Katarëve, kjo sferë është krijuar për të mashtruar ty vazhdimisht që ti të biesh dakord të kthehesh përsëri këtu. A nuk do të kthehen me kënaqësi të gjithë ata që kaluan një përvojë dashurie kur ata 'me të vërtetë të vdesin?' Po të gjithë ata njerëz të cilëve ata u kanë treguar historinë e tyre,

ose që kanë lexuar një rrëfim të saj, kanë parë një film të preferuar që tregon një personazh të famshëm duke ecur në dritën e bardhë të dashurisë? Shumica thjesht do të shkojnë drejt saj, sepse kjo është ajo që kushtëzimi u thotë atyre të bëjnë. Luçiferi është mbartësi i dritës. Drita e Absolutit thuhet se është e artë dhe jo e bardhë. A është vërtetë ai, Luçiferi, drita e bardhë e një NDEje?

15% e përvojave nuk janë ato që do të zgjidhen nga studiuesit për ti futur përfaqësuar ato në librat e tyre, ose për të marrë mbledhje në universitete, sepse ato nuk përputhen me mesazhin tipik, "lumturi përgjithmonë, dashuria dhe jeta është kaq e mrekullueshme". Ata përpiqen t'i varrosin këto. Ky libër, dhe studiues të tjerë si unë, duam të përqëndrohemi në atë që është e vërtetë, dhe të harrojmë atë që ndihet mirë ose që i bën disa jetë më të mira në botën e çmëndur të kësaj Toke. Le të marrim të Vërtetën. Le të shqyrtojmë se çfarë po ndodh në këto fusha.

Unë nuk e kam idenë se çfarë është duke ndodhur. Ajo dritë e bardhë ka të ngjarë të jetë një kurth riciklimi, dhe nëse unë shkoj tek ajo ose e pranoj atë, kujtesa ime do të fshihet dhe do të kthehet në formën që unë do të vij. Edhe nëse ti ke një trup të bukur dhe një jetë të re të bukur, çfarë ke fituar vërtet? Për t'u kthyer në materie, pa kujtim të ndonjë mishërimi të mëparshëm, dhe pa asnjë manual se çfarë e gjitha kjo është, se kush ti je dhe pse ti ekziston. Çfarë ke fituar nga një tjetër mishërim? Edhe nëse përvoja është e mirë dhe e këndshme, nuk ka shumë për të vazhduar gjithësesi. Ushtarët e plagosur shkojnë në spital për të mbyllur plagët e tyre dhe pasi të shërohen, kthehen përsëri në fushën djallëzore të betejës. Metafora e të gjitha përvojave tona në Tokë është e përshtatshme.

Le të mos harrojmë gjithashtu se të gjitha këto përvoja të diskutuara janë përvoja "pranë-vdekjes". Ato nuk janë përvoja vdekjeje. Kjo tentohet të harrohet. Unë kam lexuar disa informacione shumë interesante që sugjerojnë se ekzistojnë tre faza të dallueshme të vdekjes. Rudolf Shtajner sugjeroi se ka tre botë, ajo fizike, astrale dhe shpirtërore, por këto mund të pasqyrohen në sferën e pas-vdekjes. Ajo që është një NDE e zakonshme janë ata që kanë hyrë vetëm në sferën e parë. Kjo sferë ka "grykimin" dhe ka të bëjë me marrjen e shpirtit për të rënë dakord për rimishërime të mëtejshme. Atje nuk ka shumë "ngrënie", thjesht grykim apo një lloj peshimi të ngjarjeve të jetës. Kjo është arsyeja pse shumica në këtë fazë nuk ndihen aq keq, nuk ka shumë gjëra që ndodhin atje dhe qëniet duan që shpirti i ri të "ndihet mirë" gjatë këtij procesi. Përjetuesi pranë-vdekjes kthehet mbrapsht në këtë pikë, ndoshta qëniet mendojnë se një (përjetuesi) "nuk është ende mjaftueshëm i shijshëm për tu ngrënë" dhe duan që të kthehet në Tokë për të marrë gjithashtu një energji "të

këndshme". Për këto sfera të tjera priret të mos flitet kurrë, por Kodeksi Nag Hammadi i përmënd këto sfera të tjera të vdekjes përtej së parës dhe ai është një vënd i së keqes.

“Zoti është njeri-ngrënës. Për këtë arsye, njerëzit janë sakrifikuar te ai. Perpara se njeriu të sakrifikohej, kafshët sakrifikoheshin, pasi këta të cilëve ata u sakrifikoheshin nuk ishin Zotëra.” **Ungjilli i Filipit**⁵¹

Unë do të ndaj më shumë për temën e planeve (sferave) të ndryshme të vdekjes në kapitullin e fundit. Sepse ky mund të jetë mashtrimi më madhështor prej të gjithave që ne mund të jemi nën, me **NDE** (Near Death Experience – Përvojë Pranë Vdekjes) dhe të tjera **OBE** (Out of Body Experience – Përvojë Jashtë Trupi). Ne po na “tregohet” përmes përvojave së të tjerëve, se ekziston vetëm një lloj përvoje pas-vdekjes dhe se nuk ka të tjera. Kjo ka të ngjarë të jetë një mashtrimi më i madh që mund të ekzistojë, pikërisht atje lart me idetë e karmës dhe mëkatit. Ne kemi më shumë për të kaluar në këtë libër përpara se të arrijmë këtë fazë informacioni, duke përfshirë shikimin e disa NDEve jo-standarte që mund të kenë filluar të prekin këto "shtresa të tjera" të sferës së vdekjes.

⁵¹ <http://gnosis.org/naghamm/gop.html>

5

PLAN VEPRIM VDEKJEJE

Një studiues i përvojave jashtë-trupit, William Buhlman, prezantoi në librin e tij, *Aventurat në Jetën e Përtejme*, atë që ai ndjeu se ishte një mesazh i rëndësishëm për përgatitjen e vdekjes. Ai e quajti atë "të krijosh një plan veprimi për tranzicionin e ndriçimit tënd shpirtëror". Jo se çfarë do të ndodhë me trupat ose gjërat tona pasi ne të vdesim, por se si ne duam që të vendoset java ose ditët para vdekjes sonë (duke supozuar se kemi disa njohuri paraprake për të dhe nuk goditemi nga ndonjë autobus dhe nuk vritemi menjëherë). Ai pyeti: "Çfarë dua unë rreth meje teksa po vdes? Çfarë lloj muzike, çfarë lloj fjalësh?" Cilët janë njerëzit që unë besoj ti kem pranë për të më ndihmuar me këtë proces dhe si ta bëjmë hapësirën (qoftë në shtëpi ose në spital) një hapësirë të shenjtë? Ai paraqiti një sërë pohimesh, për të krijuar fokusin e qartë mendor drejt gjçndjes pas vdekjes. Ai përgatiti një CD personale, me sugjerime rikujtuese, që do të luhej ditët e mëparshme. Një mantra e vërtetë që vinte nga vetë ai, në mënyrë që këto synime të mund të bashkohen me vetëdijen dhe shpirtin e tij në tranzicion. Vërtetë, ai ishte shumë më i gëzuar dhe optimist sesa i yni ka të ngjarë të jetë (ai u anua në anën e gjëndjes pas-vdekjes në të qënit për të një vënd i mrekullueshëm).

Ne mund të krijojmë pohime të tilla si: "Unë jam i lirë dhe sovran, qëndro larg dritës së bardhë, kthehu në shtëpi, unë nuk do të kthehem në planetin e çmëndur". E kupton idenë. Sugjerimi im do të ishte që këto të mbahen sa më pozitive që të jetë e mundur, që përqëndrimi të jetë në atë ku ti dëshiron të shkosh, jo në atë që ti nuk dëshiron. Mendoj se ky është një mjet i vlefshëm për ta pasur gati si drejtim apo synim teksa ngjarja e vdekjes afrohet. Kapitulli i *Nag Hammadit "Apokrifoni i Xhejmsit"*, na thotë se ne do të na duhet t'u kujtojmë arkonëve se ne e dimë se nuk jemi një formë materiale, se ne vijmë nga Pleroma (Njëshmëria e Vërtetë) dhe se ajo është Shtëpia jonë. Duke ditur këtë, dhe duke ua thënë këtë atyre është një kujtesë për Demiurge/Arkonët se ata nuk janë nga Pleroma dhe si të tillë nuk kanë fuqi të na mbajnë larg prej saj. Kjo mund të jetë gjithashtu pjesë e një kasete CD ose fletë letre (të kesh dikë që të lexojë nëse nuk ka energji elektrike ose CD player).

Po rreth gjërave në dhomën e spitalit tënd, apo dhoma jote e gjumit nëse ti po e kalon procesin në shtëpinë tënde? A ka piktura ose objekte që ti mund ti duash atje? Muzika që do të luhet. Kujtime për t'u rikujtuar. Kjo është përvoja jote dhe duhet të krijohet vetëm për ty, ashtu siç ti dëshiron të jetë. Çfarë momenti më i mirë për të vendosur me

vetëdije sesa orët dhe ditët direkte përpara vdekjes tënde. Pyetja bëhet, çfarë është ajo që ti do (jo për rehati, ne nuk na intereson rehatia), por çfarë do të të ndihmonte ty të dilje përgjithmonë nga Shpella, të lësh pas matriksin dhe asnjëherë më të mos jesh në këtë çmënduri? Si të shkojmë drejt shëndetshmërisë ndërsa ne vdesim?

Si dëshiron ti t'i kesh gati momentet e tua të fundit për të dalë nga Shpella? Krijo planin tënd të veprimit, njofto një anëtar të ngushtë të familjes ose mik rreth kësaj, dhe kërkoji atyre të ndihmojnë për ta realizuar këtë kur ngjarja të afrohet. Kjo është një nga sugjerimet më të mira që unë kam hasur në shumë vite dhe është diçka që unë do ta bëj sapo të përfundojë shkrimi i këtij libri.

Unë do të ndaj një citim që po përgatitem t'i përgjigjem në përgjigje të kërkesave të tyre të çmëndura: “E vetmja fuqi dhe autoritet që ti ke, është fuqia dhe autoriteti që unë ty të jap. Kështu që unë i tërheq të gjitha ato, dhe qëndroj si qënia e fuqishme, sovrane që unë gjithmonë kam qënë.”

6

LISTA E RIKAPITULLIMIT

Në kapitujt e mëparshëm unë përmënda fuqinë e ripërmbledhjes. Ajo do të ketë një përfitim për dikë që e kryen atë në botën materiale si një mënyrë për të rifituar energjinë e humbur nga jeta. Megjithatë, fokusi kryesor i një ripërmbledhje është të na përgatisë ne për rishikimin e jetës pas-vdekjes, në mënyrë që asgjë në të mos të na befasojë.

Ka shumë mënyra të ndryshme për të parë sinqerisht të kaluarën e vetes sonë, në një mënyrë që arrin në nivelet më të thella të asaj që ka ndodhur. Për të parë qartë ngjarjet, ti duhet të shkosh përtej mendjes së rregullt parazite dhe kujtesës normale të ngjarjeve. Këto janë vetëm historitë që mendja ka krijuar për të kaluarën; ndërsa ripërmbledhja është krijuar për të parë të kaluarën me ndershmëri të plotë. Është një proces që vetëm mund të drejtohet drejt dhe sugjerohet, sepse mënyra më e mirë për çdo person është shumë individuale dhe duhet të zhvillohet vetë. Unë paraqes mënyrën time për të bërë procesin e ripërmbledhjes në Shtesën B të librit tim *Falling For Truth*. Ai tekst është gjithashtu i disponueshëm në faqen time të internetit në linkun e mëposhtëm:

<https://www.egyptian-wisdom-revealed.com/2020/06/recapitulation/>

Prej kohësh unë kam rekomanduar që njerëzit të bëjnë një rishikim të jetës së tyre. Të gjithë jetën tënde. Dhe, siç u përmënd në kapitujt e mëparshëm, kjo është kështu që atje të mos ketë asnjë zonë të fshehur të jetës sonë nga e cila ne mund të habitemi në rishikimin e pas-vdekjes. Problemi është se një rishikim i tillë i plotë kërkon vite; rishikimi im i parë më mori rreth katër vjet për ta përfunduar. Nuk jam i sigurt se njerëzit e kanë atë lloj kohe tani, duke pasur parasysh situatën tonë të çuditshme aktuale botërore. Kushdo që nuk ka filluar një rishikim të plotë të jetës mund të mos arrijë ta përfundojë atë, duke pasur parasysh se çfarë sfidash duket se janë në horizont për këtë realitet.

Dhe kështu, unë nuk po i sugjeroj më njerëzve të bëjnë një ripërmbledhje të plotë të jetës (megjithëse nëse vërtet një ndihet i detyruar ta bëjë atë, le të shkojë për të). Unë tani sugjeroj që njerëzit të bëjnë një nga dy gjërat: të bëjnë listën e tyre të rikapitullimit ose të bëjnë albumin e tyre të kujtimeve. Lista e ripërmbledhjes është hapi i parë në një ripërmbledhje të plotë. Kjo përdoret si një udhëzues që ne të mund të kemi një plan organizimi për procesin, të dimë se kush personi ynë i ardhshëm që ne do të shqyrtojmë është dhe disa nga ngjarjet që lidhen me atë person. Megjithatë, krijimi i listës është një

lloj ripërmbledhje në vetvete. Kur unë bëra listën time për herë të parë, e cila zgjati rreth tre muaj, ajo solli të gjitha llojet e ngjarjeve dhe kujtimeve të harruara gjatë procesit. Dhe kështu, nëse ti do të ndjekësh listën, merr kohën tënde për ta bërë atë plotësisht. Jepi vetes tre ose katër muaj dhe mos u ndal derisa të ndihesh i plotë.

Kjo listë duhet të përfshijë të gjithë ata që ti ke takuar ndonjëherë (një kamarier në McDonald's që ka marrë porosinë tënde nuk përfshihet) por duhet të jetë gjithëpërfshirëse. Për të ndihmuar, mund të gjesh libra të vjetër adresash, libra vjetorë të shkollës së mesme dhe fotografi. Çdo gjë për të nxitur kujtesën tënde, me të cilët ti ke ndërvepruar në periudha të ndryshme të jetës tënde. Ku ke bërë pushime, ku ke punuar, ku ke shkuar për të ngrënë darka? Pasi të kesh një listë të detajuar të emrave, ajo duhet të shkruhet mbrapsht në kohë, me personin më të fundit që ti ke takuar në krye të listës dhe prindërit e tu të fundit. Tani merr atë listë dhe shkruaj 1-3 ngjarje që ndodhën me atë person. Disa do të jenë njerëz që i ke takuar vetëm një herë, ndërsa të tjerët do të kenë mijëra ngjarje nga të cilat ti mund të zgjedhësh (në rastin e njerëzve me të cilët ke kaluar shumë kohë, zgjidh 20 deri në 25).

Kur lista dhe ngjarjet janë në vënd, lexoje listën ngadalë. Emër për emër, ngjarje për ngjarje. Merr kohën tënde. Shumë kujtime do të fillojnë të shfaqen. Thjesht ulu me to. Shko tek ato që të tërheqin. Kur arrin tek emrat e atyre me të cilët ti ke pasur takime seksuale, merr pak kohë për të marrë frymë, për të harmonizuar energjinë (pasi takimet seksuale mund të krijojnë shumë energji të gabuar dhe të humbur kur aktiviteti nuk është marrë me një vetëdije të qartë). Ti nuk po e bën këtë si një ripërmbledhje të plotë, thjesht po e lexon përsëri, duke pasur reflekse të shkurtra ndërsa kalon ndërmjet tyre, dhe shiko se çfarë tjetër vjen që ti ke harruar. Kjo praktikë do të të japë një fillim në përgatitjen për të çliruar të gjithë fajin, turpin ose nevojën për hakmarrje nga e kaluara jote. Ti duhet të jesh i qartë dhe i qetë gjatë rishikimit të jetës pas-vdekjes.

Rekomandimi tjetër do të ishte të bëhej ajo që Karlos Kastaneda e quajti "një album me ngjarje të paharrueshme". Kjo është për të gjetur ngjarje që ne na kanë ndodhur, por që kanë qënë gjithashtu jopersonale. Nuk bëhet fjalë për gjërat më të rëndësishme, gjërat më të mira apo më të këqija që kanë ndodhur në jetën tonë, por gjërat që prekin në një farë mënyre jetën e të gjithë njerëzve, që janë disi universale, por personale në të njëjtën kohë. Duhet shumë punë për të renditur jetën e dikujt për të gjetur këto 'momente të albumit'. Ne gjithmonë fillojmë me ato që mendojmë se janë 'momentet tona më të mira dhe më të këqija', por në përgjithësi, ato kurrë nuk i përshtaten thirrjes së 'ngjarjeve

jopersonale'. Ti mund të lexosh kapitullin "Hyrje" të librit *Ana Aktive e Pafundësisë* për më shumë informacion mbi krijimin e albumit të dikujt.

Një gjë që unë dua të theksoj është se Kastaneda referoi se ekzistojnë dy lloje "luftëtarësh" (ata që janë në rrugën e së Vërtetës Totale). Një grup janë të njohur si stalkers (të cilët kryesisht punojnë brenda sferës materiale), dhe ata që quhen ëndërrimtarë (ata që punojnë kryesisht në realitete alternative). Ripërmbledhja nuk është aq e rëndësishme për atë që është ëndërrimtar, pasi fokusi i tyre është në atë astrale dhe kështu forma fizike është shumë më pak solide. Megjithatë, për stalkerin, ripërmbledhja (së bashku me procesin e njohur si mosbërje) janë elemente kyçe për praktikën e tyre. Po e përçmënd këtë pasi dikush që mund të jetë një ëndërrimtar klasik mund ta dijë menjëherë se "Unë nuk kam nevojë të ripërmbledh jetën time", dhe ata do të ishin të saktë. Në një farë kuptimi ata bien në kontakt me jetën e tyre ndërkohë që janë në përvoja jashtë trupit. Kështu, lexuesi duhet të përcaktojë se cilit "lloj" i përket manifestimi material i vet për të përcaktuar se sa e rëndësishme është apo jo kjo praktikë për ta personalisht.

Sa më shumë kohë që t'i kushtosh kësaj praktike përpara se momenti i vdekjes të vijë, aq më i përgatitur ti do të jesh në anën tjetër kur një qenie arkonike përpiqet të të fajësojë ty me ndonjë ngjarje që ishte pjesë e së kaluarës tënde. Ti je gati për to.

B

EKZAMINIMI

7

PERDET E SAJ JANË PËR TY

nga Donnie Beige

"Panteoni ishte kisha e parë që unë pashë ndonjëherë që kishte një pamje të hapur ndaj Zotit." **Bran Ferren**

- **2003, Romë Itali, 07:01 AM**

Dy orë deri në takimin më të rëndësishëm të jetës së Karl Henrik Jensen.

Karli hapi sytë dhe u zgjua. Ndërsa ai filloi të skanonte dhomën e thjeshtë të hotelit, ai filloi të mblidhte veten se ku ai ishte. Dje vonë në mbrëmje ai kishte fluturuar për në Romë nga shtëpia e tij në Kopenhagen, Danimarkë, në një lloj kërkimi. Ai u regjistrua në këtë hotel mjaft të thjeshtë, i cili u zgjodh jo për çmimin e tij të lirë, por për shkak të vëndndodhjes së tij. Ishte vetëm një bllok larg takimit të tij të planifikuar në orën 9 të mëngjesit në Panteon, ndërtimi më i njohur i Romës së Lashtë.

Për këtë takim të ardhshëm ai dinte shumë pak. Vetëm se një grua do ta takonte atë në Panteon. Atij i ishte thënë vetëm se ajo ishte një "Muzë". Ai nuk e dinte emrin e saj, moshën e saj, se si ajo dukej, çfarë ajo bënte, madje as çfarë ajo do të vishte. Si mund ta dallonte ai atë në turmë? A do të ishte ai në gjëndje ta dallonte atë? Atij iu tha vetëm se ajo do të fillonte të zbulonte rrugët për t'iu përgjigjur pyetjeve mbi natyrën e realitetit.

Realiteti!

Kjo temë e shqetësonte atë për dekada. Që nga vdekja e motrës së tij më të madhe pesëmbëdhjetë vjet më parë, gjërat ndonjëherë spiraloreshin në vënde që ai kurrë nuk e kishte menduar se ato do të shkonin. Vënia në pikëpyetje e këtij realiteti, vlera dhe madje realiteti i realitetit i kishin shkaktuar atij shumë netë pa gjumë. Kjo e bëri atë të kërkonte në tekste të filozofisë, spiritualitetit, fesë, ferrit, madje edhe në ishujt e vetë-ndihmës dhe vegjetarianëve. Karli kishte shpenzuar vite duke studiuar gjithçka që ai mundi mbi temat e mënçurisë. Ai shkoi në tempujt e Zenit për zazen, lexoi libra mbi alkiminë dhe shamanizmin, provoi ëndrrat e qarta (luçide), shqyrtoi Qi Gong dhe Yoga dhe madje bleu kristale dhe libra

nga Tony Robbins. Ai pyeti veten se ku gjithçka e kishte çuar atë, pyeti veten nëse këta të ashtuquajtur mësues ishin kapur duke menduar se ata kishin arritur një majë, por nuk e dinin se mali vazhdonte.

Jeta e Karlit ndryshoi shtatë muaj më parë kur ai u ndesh me një burrë shumë të çuditshëm në një librari në qytetin Danez Hillerod. Ai kishte ndërmend të ishte në qytet një herë në muaj, për të vizituar kështjellën alkimike të Fredriksborg Slot. Ishte si të hyje në një libër nga John Dee ose Marsilio Ficino, por në vënd të fjalëve në një faqe ajo ishte gdhëndje në tavan dhe piktura në mure. Pas vizitës së tij në këtë ditë të veçantë, ai u ndal te Bog dhe Ide, libraria lokale pak më poshtë nga biblioteka. Atje, ndërsa shfletonte një tekst mbi Katedralen Chartres, ai takoi njeriun që do të bëhej një shok i vazhdueshëm kafeneje, duke e çuar Karlin nëpër botën e tij të brëndshme të eksplorimit. Ndërsa vetë ai nuk i kuptonte plotësisht gjërat, Karl u bind se Rikard (i cili jetonte dhe punonte si një tregtar i thjeshtë) kishte shkuar në thellësi të mëdha. Ai kishte lexuar tekste dhe kishte qënë në kontakt me organizata për të cilat Karl nuk kishte dëgjuar kurrë, dhe ai pyeste veten nëse Rikard po e bënte këtë për t'i bërë përshtypje (një ide që ai e hodhi poshtë përfundimisht), apo nëse në fakt ai kishte arritur në një hapësirë të vërtetë njohjeje. Sigurisht jo një njohuri totale, por përtej çdo libri, mësuesi apo organizate që Karl kishte hasur. Pastaj Karl mori një surprizë.

Vetëm pesë ditë më parë Rikard e informoi atë se një mikeshë e tij e ngushtë priste të ishte udhërrëfyeni i tij për të eksploruar realitetin. Ajo do të ishte në Panteon në orën 9 të mëngjesit të së enjtes në mëngjes duke pritur Karlin. Të gjitha pyetjet e tij se kush ajo ishte, se çfarë ajo donte, çfarë ajo bëri, madje edhe pse duhet të jetë e enjte, u refuzuan. Informacioni ishte i thjeshtë: Ji atje të enjten në Panteon dhe shiko se ku aventura e tij e çon, ose qëndro në Kopenhagen dhe vazhdo jetën me shumë kërkime dhe pak gjetje. Karlit iu deshën vetëm 24 orë për të vendosur se çfarë ai duhej të bënte.

Për të kënaqur kërkimin e tij të thellë për përgjigjet e pyetjeve djegëse: Pse kjo botë duket kaq e çmëndur? Pse ka kaq shumë vuajtje? Pse natyra ka nevojë të hajë vazhdimisht veten për të mbijetuar? Pse të gjithë lindin injorantë, pa kujtuar asgjë të mëparshme? A është kjo sferë një burg? Ai mori një javë pushim nga puna, mori një biletë avioni, rezervoi një hotel dhe u nis për në Romë. A mundet kjo grua misterioze vërtet t'i thotë atij, në... oh jo, është ora 7.30! Karl e kuptoi se duhej të bënte një dush, të vishej dhe të hante pak mëngjes. Ai do të ishte 100% herët për këtë takim. Ai u ngrit nga shtrati duke ndjerë një përzierje të çuditshme ndjesish, të lodhshme nga vitet e kërkimit të tij të brëndshëm, frikë

për atë që mund të ndodhte më pas dhe i joshur nga ideja se më në fund mund të gjente diçka të vlefshme.

Në rreth një orë e tridhjetë minuta ai më në fund mund të marrë disa përgjigje.

- **8:22 AM**

Muza qëndroi e qetë, por e sigurtë në barin e Cafe Eustachio pranë Panteonit. Ndërsa ajo pinte ekspresin e saj të mëngjesit, ajo mendoi nëse Danezi misterioz, në fakt, do të shfaqej. Një burrë i moshuar u përplas me të në kushtet e mbushura me njerëz.

"Mi Scusi," u përgjigj ai, ndërsa u zhvendos drejt derës.

Kjo kafene, dhe të tjerët si ajo, kanë qënë një pjesë e ritualit të mëngjesit të Romës për dekada. Muza nuk shqetësohej më nga njerëzit, ajo e dinte se shumica e atyre me të cilët ajo vinte në kontakt nuk ishin me të vërtetë njerëz sidoqoftë.⁵²

Rikard i kishte dhënë asaj disa detaje paraqitjeje për të. Shikimi i saj i brëndshëm siguroi pjesën tjetër. Ai ishte më afër përgjigjeve reale sesa ai mendonte. Ai kishte nevojë vetëm për një shtytje të mirë, për të ndaluar duke pare hënën dhe të shkonte direkt drejt saj.

Muza mendoi frazën e vjetër Taoiste, "**Një gisht që tregon hënën nuk është Hëna. Mos u fokusoj te gishti.**" Ajo qeshi lehtë në ekspresin e saj të ngrohtë. Pothuajse askush nuk e kuptoi se për çfarë ajo metaforë po drejtonte drejt në të vërtetë. Kishte lloj-lloj idesh romantike dhe të thjeshtuara për të, por ajo që në të vërtetë ajo po 'tregonte' ishte diçka që kërkuesi mesatar nuk ishte shumë i interesuar ta zbulonte. Megjithatë, për mirë ose për keq, Muza e dinte saktësisht se çfarë kjo frazë do të thoshte. Buzëqeshja e saj nuk ishte një buzëqeshje që paralajmëronte keqdrejtim. Ai gisht mund të kishte drejtuar nga çdo objekt, por ai po drejtonte në Hënë. Ky ishte elementi kryesor që u mungonte të gjithëve. Pse Hëna? Kur kjo u kuptua, tërësia e deklaratës më në fund mori kuptim.

Një kontroll i shpejtë i orës së saj zbuloi kohën. Ajo donte të ishte atje një gjysmë ore të mirë përpara mbërritjes së tij, për të bërë një vëzhgim të vëndndodhjes, për t'u bazuar me energjitë e hapësirës. Për Muzën, Panteoni ishte tempulli i saj personal, një shtëpi prej

⁵² Sot ne do t'u referoheshim këtyre njerëzve nga terminologjia e video lojërave si personazhe jo-lojtarë (NPC), në thelb robotë që popullojnë realitetin për ta bërë atë të duket më i madh dhe më kompleks sesa ai në të vërtetë është.

guri e ndërtuar vetëm për të, dhe ajo donte të ishte gati të dallonte vizitorin e panjohur në sferën e saj në momentin që ai hynte.

- **08:59 AM**

Qyteti i Errët është një film i realizuar nga Universi. Fatkeqësisht, shumë pak e kuptuan atë film, dhe kështu ai ishte një dështim i tillë në arkë, saqë Universit iu desh të vazhdonte të bënte më shumë filma me kalimin e kohës, të tillë si: *Matrix*, *Donnie Darko*, *Truman Show*, *Lost*, *Vanilla Sky*, *Inception* dhe *Adjustment Bureau* për të përmëndur disa. Por për të qënë i qartë, të gjithë këta filma janë ritregime të Qytetit të Errët, me përjashtim të Donnie Darkos që është në një klasë të veçantë të tijin. Qyteti i Errët shpjegon shumë nga realiteti ynë, iluzionin e tij dhe se kush e krijon këtë iluzion. Por ka kaq shumë shtresa. Dhe Qyteti i Errët nuk përfundon me fundin e lumtur që njerëzit besojnë. John nuk largohet nga Shpella, dhe, në fakt më duket se filmat e listuar më sipër piren të jenë shumë të mirë për dhe si prezantim i shpellës (ose të paktën elementi material i shpellës), por jo si një mënyrë aktuale e daljes prej saj.

Unë do të jap një pasqyrë të filmit në një paragraf ose dy për ata që nuk e kanë parë atë. Ai u shkrua dhe u drejtua nga Alex Proyas, një Grek i lindur fillimisht në Aleksandri, Egjipt, por që e jetoi pjesën më të madhe të jetës së tij në Australi. Filmi është vendosur në një qytet, me sa duket në vitet 1940 ose 50 (megjithatë ka elementë nga shumë korniza të ndryshme kohore). Më vonë ne zbulojmë se ky nuk është në të vërtetë një qytet, por një sferë artificiale e krijuar nga përdorimi i fuqive psikike e një race aliene, quajtur "Të Huajt". Të Huajt sollën njerëzit në këtë sferë nga shtëpia e tyre origjinale për një eksperiment. Ky qytet i rremë është një botë të cilën ata ("Të Huajt"), e përtërijnë dhe e ndryshojnë çdo mesnatë, duke ngulitur kujtime dhe identitete të reja te njerëzit. Kjo sferë, ne më vonë zbulojmë, është një qytet gjigant rrethor që lundron në hapësirën e jashtme dhe është gjithmonë në errësirë të përhershme. Të Huajt janë një racë që po vdesin dhe tani po

eksperimentojnë me njerëzit sepse duan të kuptojnë shpirtin e njeriut. Ata besojnë se duke vepruar kështu do të fitojnë sekretin për të shpëtuar veten e tyre. Ata besojnë se kujtimet janë disi të lidhura me shpirtin, dhe si të tilla elementi kryesor i eksperimenteve të tyre janë kujtimet njerëzore. Çdo natë në mesnatë, qyteti ndalet dhe të gjithë janë të detyruar të flenë. Gjatë kësaj periudhe ngrirjeje, identitete dhe kujtime të reja (identiteti është i lidhur me kujtesën) i jepet çdo njeriu, të cilat një do t'i jetojë të nesërmen. Një ditë ata jetojnë të pasur, ditën tjetër jetojnë të varfër. Kjo do të thotë që njerëzit në Qytetin e Errët zgjohen çdo ditë me një seri kujtimesh të rreme, në një personazh që nuk është në të vërtetë ata, që i cili do të ndryshojë përsëri ditën tjetër. Disa personazhe duket se qëndrojnë të njëjtë për një kohë (siç është detektivi), ndërsa të tjerët ndryshojnë çdo natë, por në asnjë moment ata nuk po e jetojnë të vërtetën se kush ata janë, sepse pas kaq shumë fshirjesh kujtesash ata nuk mund të kujtojnë më.

Një nga gjërat e para që duhet kuptuar rreth Qytetit të Errët është në emrat e personazheve. John Murdoch bëhet heroi ynë i tregimit. Fakti që ai quhet John është domethënës, por çfarë tregon konkretisht emri? A është për John si dishepulli kyç i Jezusit dhe shkrimtari i tekstit Gnostik dhe Katar, Ungjilli Sekret i John (i quajtur edhe Apokrifoni i John), apo është John Pagëzuesi, apo emri lidhet me idenë se të gjithë kokat i Priorit të Sionit (i njohurive të Rennes Le Chateau) mori emrin John apo Joan? Ai do të jetë origjinali "One – I vetmi" për të cilin aludon filmi i parë i Matriks.

Një mesazh më i madh është emri i mjekut i luajtur nga Kiefer Sutherland. Atij i është vënë i njëjti emër si Dr. Daniel P. Schreber, një Gjerman që shkroi "Kujtimet e Sëmundjes Sime Nervore" në vitin 1903. Në atë libër ai përshkruan një avari mendore që e dërgoi atë në spitalet psikiatrike për vite me radhë. Edhe pse ai u bë një tekst themelor kyç i psikologjisë, kur ti shikon më tej, gjatë "episodeve" të tij ai diskuton përbërjen e realitetit, sferën e Zotit dhe qëniet që ai sheh duke ndërvepruar me njerëzit. Është e vështirë të thuhet se sa nga ajo që Schreber kaloi ishte "sëmundje mendore" e vërtetë, dhe sa ishte shikimi përtej perdes së realitetit normal, dhe mos-pasja e aftësisë për t'u marrë me atë që ai pa. Unë jam aktualisht disa kapituj brenda atij libri dhe është e panevojshme të them se është një lexim magjepsës.

Ne e shohim për herë të parë John teksa ai "zgjohet" në një vaskë. Kjo vaskë do të bëhet simbolikisht e rëndësishme (dhe një nga ngjashmëritë tona të shumta të Matrix). Më vonë zbulojmë se në njëfarë mënyre, ai arriti të çlirohej nga tentativa e futjes së kujtimeve të reja gjatë natës (në këtë rast për ta bërë atë të mendojë ose të besojë) se ai është një vrasës serial. Unë do të arrij në këtë skenë hapëse më vonë në këtë ekzaminim. Ai nuk e di

se kush dhe ku ai është, dhe ai vazhdon të kërkojë identitetin e tij të vërtetë. Përfundimisht takojmë personazhet e tjerë, gruaja e tij Ema, inspektori Frank Bumstead (i cili gjithashtu po vë në dyshim realitetin e tij), Detektivi Eddie Walenski (i cili u çmënd nga plasja e flluskës së realitetit), Të Huajt me veshje të errët që i vihen nga pas John, dhe Dr. Schreber i cili po punon për Të Huajt për të përsosur eksperimentet e tyre (në mënyrë që ai të mund të qëndrojë si një shkencëtar dhe të mos i fshihet kujtesa). Schreber më vonë krijon një injeksion specifik për John, i cili në vënd që të fshijë kujtimet e John, i jep atij kujtime të reja që përmbajnë njohuri të plotë. Në shpikjen me të cilën Schreber injekton John, ai vendosi veten e tij në kujtimet e John, dhe kjo për të vepruar si një lloj udhërrëfyes i besuar. Pothuajse në të gjitha kujtimet e ngulitura të Doktorit që ndërvepron me Johnin e ri, është e pranishme drita e diellit, që simbolizon një realitet pa Të Huajt dhe në të njëjtën kohë dritën e asaj që është përtej realitetit të rremë të errët. Nëpërmjet mësimave të Dr. Schreber, John fillon të shfrytëzojë fuqinë e tij psikike (në një shkallë më të lartë se Të Huajt).

Kërkimi i John u përqëndrua në një kartolinë së një parajse oqeanike e quajtur Shell Beach, dhe më vonë një ditar. Quket Qyteti i Errët sepse është gjithmonë natë. Në film, John pyet Bumsteadin: "A të kujtohet ndonjëherë hera e fundit që ti ke parë rrezet e diellit, kur ishte ajo ditë?" Të Huajt duket se e urrejnë dritën e diellit, ashtu si ujin (që sigurisht janë dy tiparet kryesore të nevojshme për jetën në Tokë). Dielli është gjithashtu një referencë simbolike për dritën origjinale të Zotit, nga e cila ne të gjithë jemi ndarë, dhe në një farë kuptimi pjesë e kërkimit të vërtetë të Johnit nuk është të gjejë plazhin e bukur me diell (të cilin ai zbulon se nuk ka ekzistuar kurrë në të vërtetë), por Dritën Absolute të asaj që është përtej materiales. Qyteti i Errët nuk është i errët për shkak së mungesës së Diellit, por i errët për shkak të mungesës së dritës së Gnosis dhe Urtësisë së Vërtetë. Kujto kartolinën e Shell Beach, një diell duket në këndin e sipërm të saj majtas, por ai (dielli) po shkel syrin. Një shkelje syri për të sugjeruar se nga njëra anë e gjithë ideja e Shell Beach dhe diellit është një gënjeshtëri. Sigurisht, duke pasur parasysh tezën e këtij libri, dielli që shkel syrin mund të tregojë se dielli është tuneli i dritës, pikërisht ajo që ne duam të shmangim për t'i shpëtuar shpellës së Platos.

Ka shumë për të gërmuar kur shikojmë grupin që mund t'i konsiderojmë ose referohemi vetëm si "kontrolluesit" në film. Na thuhet se: "Së pari erdhi errësira, pastaj erdhën Të Huajt". Pra, çfarë ishte kjo errësirë origjinale, një lloj gjumi hipnotik për të zhvendosur njerëzit e parë në Qytetin e ri të Errët? Të Huajt janë ata që kanë marrë njerëzit nga shtëpia e tyre (specifikat e kësaj shtëpie njerëzore nuk tregohen kurrë), dhe më pas ata prodhuan

Qytetin e Errët. Pra, në të vërtetë janë njetëzit ata që janë të huaj në atë sferë, megjithëse ky emër u është dhënë këtyre qënieve me kokë tullace, dhe me petk të errët.

Format që ne shohim te Të Huajt janë thjesht guaska. Ata janë trupa të njerëzve të vdekur që Të Huajt kanë përvetësuar. Kur njëri prej Të Huajve vdes, ne shohim një krijesë si një insekt që del nga koka e tyre. Kjo i bën jehonë Matrix dhe idesë se ajo që ne mendojmë si mendja jonë, nuk është gjë tjetër veçse një entitet parazitar pushtues që ka pushtuar mendimin tonë. Ajo që është interesante për mua është se megjithëse ka mijëra Të Huaj, asnjë prej tyre nuk ka një formë femërore. Pse është kjo? Pse drejtori nuk kishte as edhe një Të Huaj femër? Ky nuk është një gabim, por një zgjedhje. Mesazhi pas kësaj zgjedhjeje nuk është zbuluar ende.

Kontrolli kryesor i realitetit nga Të Huajt është përmes manipulimit psikik të mendjes - një lloj mentaliteti koshere. Në mesnatë Të Huajt janë në gjëndje të riformësojnë realitetin në një version të ri përmes përdorimit kolektiv të këtyre fuqive. Pra, realiteti rivendoset çdo mesnatë. Kohët e fundit ne kemi mësuar se bota jonë aktuale, kjo ku ne e gjejmë veten, është rivendosur disa herë edhe në të kaluarën. Në fushën tonë, nuk është dhënë asnjë shpjegim për të shpjeguar se kur dhe si ndodhën këto rivendosje të mëparshme. Ndoshta këto rivendosje mund të krijohen nga një lloj force psikike e lëshuar në sferën tonë siç ky film tregon.

Kjo aftësi për të formuar realitetin njihet si "akordim" dhe kjo fjalë është një shumë e ngjashme me Kastanedën, pasi ai flet për lëvizjen e pikës së grumbullimit si akordim në një frekuencë të re, e cila duke vepruar kështu ajo do të krijojë një botë ose realitet krejtësisht të ri. Se si John Murdoch fitoi të njëjtën aftësi si "Të Huajt" nuk shpjegohet kurrë, vetëm shfaq se ai i rezistoi gjilpërës ndaj gjëndrës pineale (dhe do të vësh re shumë kone pishe gjatë filmit, simbolikë të Pinealit). John ka të njëjtën aftësi akordimi si Të Huajt, dhe kjo duket se i tremb ata pa masë.

Ne marrim një paraqitje të shkurtër të asaj që po ndodh në të vërtetë çdo mesnatë kur koha, hapësira dhe kujtimet rivendosen dhe riformohen. Kjo vjen nga një skenë e shkurtër e filmit pikërisht kur ora shënon dymbëdhjetë. Në tabelën kryesore janë renditur dy filma. Në të majtë titulli pretendon, "Now Showing: The Evil, late show nightly". Kjo markë e vogël po përshkruan atë që çdo natë po ndodh dhe se ajo është e ligë. I gjithë ky manipulim i kohës, hapësirës dhe kujtimeve është e ligë. Në mesnatë, në shkallët nën këtë markë, një numër njerëzish kanë rënë në modalitetin e gjumit, duke zbuluar përsëri se mbi kë po pretendohet e keqja. Gjithsesi, në shiritin në të djathtë është një tjetër titull që thotë;

“Coming Attractions B OK of dreams.” Aludon për të ardhmen, por një O në titull ka të ngjarë të mungojë. Kështu që filmi i ardhshëm mund të jetë "libri i ëndrrave" ose mund të lexohet gjithashtu si "Be OK of dreams". Kjo mund të jetë një shënjë shprese, ose një shënjë e kurthit të mëtejshëm në realitetin e rremë, në varësi të mënyrës se si ti e sheh atë. Ajo që është interesante është se ndryshe nga njerëzit e fjetur në shkallët poshtë markës së majtë, askush nuk është në gjumë nën B OK të markës së ëndrrave, sikur ëndrrat për të cilat këtu flitet nuk kanë të bëjnë fare me gjumin. A janë ëndrrat veçse kujtime të mëparshme të jetëve të mëparshme nga fshirjet e kujtesës së mëparshme që ne po na rikujtohen përsëri?⁵⁸ Ky paragraf mund të jetë shumë i vështirë për ata që nuk e kanë parë filmin.

Ndërsa vazhdojmë, duhet të shohim se kërkimi nëse John është apo jo vrasësi është në fakt një çështje e diskutueshme. Kjo sepse kush ai mendon se është ose çfarë bën, është vetëm një produkt i injeksionit të natës nga Të Huajt. Ashtu si një robot i serialit Westworld që vret një tjetër robot nuk mund të quhet vrasës (sepse ai thjesht po ndjek programimin që atij i është dhënë nga Ford dhe Bernard). Në mënyrë të ngjashme, kush ose cili është identiteti i jashtëm i Murdoch, do të thotë shumë pak. Kush ose çfarë është përtej të gjitha injektiveve të identitetit, është gjithçka që ka vërtet rëndësi.

Konfuzioni i kujtesës tenton të jetë çelësi kryesor që njerëzit të gërmojnë në të Vërtetën e tyre. Janë kujtimet që John ka nga Shell Beach, të cilat ai fillon t'i vërë në dyshim se mund të mos jenë reale mbi të gjithash dhe që e dërgojnë atë në një kërkim për të ditur më shumë. Kjo më kujton Mauven në seritë e Westworld, ku ajo gjen vizatimet e saj të njerëzve, të ngjashëm me astronautët, të veshur me një kostum hapsinor, të cilët e marrin atë pas çdo "vdekjeje" të saj, vetëm për t'a riparuar dhe për t'a vënë atë përsëri në linjën e punës. Ajo po i lë vetes shënime të vazhdueshme në secilën prej këtyre jetëve, një vizatim të ri, duke shpresuar se në një nga rivendosjet e radhës ajo do t'i kujtojë të gjitha. Pjesë e këtij seriali është historia e Mauve e cila ka marrë këto të dhëna nga e kaluara e saj, për të gërmuar nëpër të ashtuquajturat kujtime të saj, për të gjetur atë që është e vërtetë. John po bën të njëjtën gjë me Shell Beach, dhe në fakt ai mund të jetë fokusuar në një kohë të ditari (që më vonë e gjen të zbrazët) si një mënyrë për të nxitur veten për të kuptuar.

Megjithatë, personazhet e tjerë që janë më të vëmëndshëm ndaj realitetit të tyre (detektivët Bumstead dhe Walenski) janë gjithashtu të fokusuar në kujtime. Bumstead i tregon Emës fizarmonikën që ai mori nga nëna e tij që po vdiste, supozuar të ishte dhurata

⁵⁸ **Book of Dreams** është gjithashtu një album i famshëm nga Steve Miller Band në 1977, i cili ka disa këngë shumë unike në të si Jungle Love dhe Jet Airliner, të cilat janë tekste mistike dhe që janë ndërthurur me shfaqjen televizive Lost.

e tij më e madhe, por ai nuk mund të kujtonte se kur ai e mori në të vërtetë atë përpara se ajo të vdiste. Ai pyet Emën dhe veten: "Si mundem unë të harroj një gjë të tillë?" Ky është një rresht që unë vetë e thashë gjatë punës së procesit tim të rikapitullimit, ndërsa kujtime të varrosura dhe të harruara prej kohësh u shfaqën, pyeta veten shumë thellë: "Si mund të harroja unë diçka kaq të rëndësishme?" Kjo më bëri të pyes se çfarë është kujtesa, dhe nëse ndonjë forcë mund të zgjedhë atë që ne kujtojmë dhe atë se çfarë ne harrojmë. Pas gërmimit të thellë në gjëra të tilla si seriali televiziv *Westworld* dhe filmi *The Truman Show*, duhet të pyesim nëse ndonjë nga kujtimet tona është reale ose e ngulitur në mënyrë të rreme, për të na dhënë një shpjegim se ku është personazhi ynë sot. Nëse ne jemi në një simulim, dhe nëse ky simulim ka filluar dikur "gjatë jetës sonë të supozuar", atëherë çdo kujtim përpara momentit të fillimit të simulimit nuk është gjë tjetër veçse histori e pasme (back story), dhe si e tillë ajo nuk ka asnjë rëndësi. Pavarësisht se sa traumatike, e bukur apo në dukje jetë-ndryshueshe, ajo nuk është një kujtim i vërtetë i një përvoje të vërtetë. Vetëm për shkak se John ka kujtime nga Shell Beach, kjo nuk do të thotë se ai ishte në të vërtetë atje, apo që ai lokacion ekziston në fakt. Qyteti i Errët po drejton këtë pyetje: pse u besojmë ne kujtimeve tona si të vërteta, dhe pse në përgjithësi ne nuk kemi pothuajse asgjë për t'i verifikuar ato? E kaluara merret si vlerë nominale sikur ne na ka ndodhur në të vërtetë ajo sepse ne kemi kujtesën.⁵⁹

Zgjimi i John në vaskë është shumë i rëndësishëm. Matrix e merr këtë për të simbolizuar vëndin ku trupi është vendosur (një lloj ruajtjeje e ftohtë), ndërsa realiteti virtual pompohet në trurin e të fjeturit. Murdoch është në banjë dhe gati të injektohet me kujtimin e ri së të qënit një vrasës. Kamera është e varur nga tavani dhe drita po lëkundet anash, duke hedhur pak dritë në dhomën ku ajo lëkundet. Unë mendoj se ky është gjithashtu një aludim se dielli i botës sonë është një lloj drite artificiale që ka një lëvizje të ngjashme parambrapa që krijon verën dhe dimrin. Toka jonë është Qyteti i Errët. Ne jemi mashtruar të mendojmë se hapësira është e zezë dhe ne jetojmë në dritë, por në fakt hapësira është dritë dhe ky vënd është i errët- i ndriçuar nga një diell i rremë. Si e tillë, ideja e hapësirës dhe tokës siç ne e kemi njohur atë po shkatërrohet në këtë skenë hapëse. Vaska e tij ka ngjyrë vjollcë, vjollca është çakra e kurorës. Ai është në vaskë dhe tashmë ka pasur një lloj zgjimi, edhe pse atij do t'i duhet pak kohë për t'a kujtuar atë.

⁵⁹ Këto ide i japin hua një linje mendimi të çuditshëm filozofie të njohur si "E Enjtja e Fundit", e cila beson se Toka u krijua të Enjten e kaluar por ka aparencën se është miliarda vite e vjetër. Ajo më pas do të shkatërrohet dhe do të rikrijohet sërish të Enjten e ardhshme. Kjo duket se buron nga disa fjalime dhe ose libra të dhëna nga Bertrand Russell në fillim të viteve 1920 të quajtura "hipoteza pesë minutëshe". Në këto ai spekuloi se i gjithë universi mund të ketë lindur vetëm pesë minuta më parë, dhe gjithçka që e gjithë popullata beson nuk është gjë tjetër veçse një e kaluar joreale. Ide të tilla mund të shpjegojnë pse gjërat mund të duken të vjetra dhe të reja në të njëjtën kohë.

John fillimisht shikon nga afër në pasqyrë për të provuar të kuptojë se kush ai është, dhe vëren plasaritjen në pjesën e sipërme të pasqyrës, që simbolizon plasaritjen brënda tij - çarjen në ardhjen e kuptimit të kësaj bote. Prostituta e vdekur me spirale në trupin e saj është metafora e labirintit rreth udhëtimit për të shkuar brënda në karrigen e Vetes së Vërtetë (Jo Vete). Ka shumë spirale në film, që përfaqësojnë kohën ciklike, labirintin e të shkuarit në brëndësi dhe lidhjet me shfaqjen televizive *Westworld*, e cila kishte Burrin me të Zeza (MIB) në një përpjekje për të kuptuar spiralen si një metaforë për njohjen përfundimtare. Në Qytetin e Errët, Të Huajt po përpiqen të kuptojnë shpirtin e njeriut. Dr. Schreber po punon me minjë në një labirint, a po kërkon ai mënyra për t'i futur spiralet te John apo tek njerëzit e tjerë? Një moment kyç është kur John shikon majën e gishtit të tij dhe sheh se edhe gishti i tij është bërë si një lloj një labirinti spiral, sikur ai vetë nuk po punon vetëm përmes labirintit, por labirintit të cilit ai duhet të udhëtojë nëpër dhe përtej. Më vonë ne vërejmë se ai thyen aksidentalisht një tas peshku dhe peshku i artë po lufton për jetën e vet. John nuk do ta linte këtë peshk të ngordhte, dhe e shpëton atë duke e vendosur në vaskë. Kjo përgjithësisht pretendohet se tregon se ai nuk është një vrasës. Por kjo është shumë më tepër se një simbolikë. Së pari, tasi i peshkut përfaqëson filluskën e realitetit ose kupolën e botës. John ka goditur realitetin. Ai sigurisht është peshku, ose peshku mund të përfaqësojë fëmijën e vetes së tij, për të cilin ai kujdeset duke e futur në ujë. Ne nuk e zbulojmë kurrë se çfarë ndodh me peshkun. A e ka mbajtur peshkun njëri nga policët hetues!? Thyerja e tasit të peshkut të kuq shihet shpesh në film, së fundmi në episodin e parë të serialit shumë të çuditshëm televiziv *Moon Knight*.

*

Fryderyk Kwiatkowski, në artikullin e tij shumë të shkëlqyer, bëri një prezantim se disa këndvështrime Gnostike janë përfshirë në Qytetin e Errët.⁶⁰ Unë do të lë të lexosh artikullin dhe të gërmosh më tej në tezën e tij. Një përmbledhje e shkurtër e filmit mund të përfshijë: zbulimin se krijuesi i botës nuk ishte një zot i mirë, por një i lig (Demiurge, z. Book of Dark City), se ky Demiurge krijoi një simulim artificial që Gnostikët i referoheshin si HAL, dhe më pas shpirtrat e bllokuar në këtë sferë. Shpirtrat e bllokuar mbahen në këtë vënd nga agjentë të tij, të cilët Gnostikët i quajnë arkonë. Ky është Qyteti i Errët me pak fjalë. Njerëz të sjellë në qytet nga ndonjë vënd tjetër (nuk na është thënë kurrë se si e arritën këtë Të Huajt), dhe që mbahen në qytet nën identitete të vazhdueshme false, në një botë që është shumë qartë e simuluar. Megjithatë, në botën Gnostike, në mënyrë që ky Demiurge të krijonte, kërkohej një rënie - kjo ishte gjysma Femërore e Perëndeshës së Mirë Sofias, duke rënë në materie. "Gabimi" i saj, siç e quajnë Gnostikët, lejoi që kjo sferë të krijohet dhe shpirtrat të

⁶⁰ "Si të Arrish Clirimin nga një Botë e Rremë? Miti Gnostik i Sofias në Qytetin e Errët," <https://digitalcommons.unomaha.edu/jrf/vol21/iss1/34>

futeshin në grackë. Unë do të diskutoj idetë Gnostike në një kapitull në Librin 2, por besimi i tyre ishte se Sofia rrëmbeu një shkëndijë hyjnore ose pneumë (një fjalë e lidhur me mushkëritë dhe si e tillë me frymëmarrjen), në krijimin origjinal të Demiurge. Është kjo shkëndijë hyjnore në brëndësi, e cila nuk vjen nga Demiurge, që mund të lejojë që të gjitha qëniet në këtë krijim që potencialisht të shlyhen. Kwiatkowski diskuton gjithashtu idenë e "Shlyerësit", një koncept i një qënieje ose shpirti nga materia fizike e jashtme që ka hyrë në mënyrë që të paraqesë Gnosis në botë, dhe kështu të sigurojë një shënjë për një dalje. Për Gnostikët, Krishti u quajt Shlyerës. Ky ishte roli i tij - jo për të hequr mëkatet tona, por për të vepruar si një tregues për burimet tona të brëndshme për të gjetur rrugën tonë për t'u kthyer tek Ati.

*

Duke parë Qytetin e Errët, bëhet shumë e qartë se *Matrix*, i cili doli në vitin pasues pas Qytetit të Errët, është në shumë mënyra pothuajse i njëjti film (dhe në fakt është xhiruar duke përdorur shumë nga të njëjtat grupe filmash). Mund t'a mendojmë *Matrix* si Qyteti i Errët 2.0. Unë e mendoj atë jo si krijuesit e *Matrix* që vjedhin ide direkte nga Qyteti i Errët (megjithëse regjisori mendon ndryshe), por në vënd të kësaj - si vetë Universi, (ajo që është jashtë Shpellës) që përdor filmin për të sjellë njohuri në ëndrrën tonë. Qyteti i Errët nuk ishte një sukses kinematografik, pothuajse askush nuk shkoi ta shikonte atë. Megjithatë, viti pasues, filmi *Matrix* pushtoi botën dhe është ky film që u përdor në gjuhën popullore për të përshkruar realitetin e rremë. Mund të them se Qyteti i Errët në fakt tregon shumë më tepër për këtë realitet dhe mënyrën se si ai është strukturuar, dhe ai mund të shihet si historia origjinale dhe më e plotë e *Matrix*.

Le të fillojmë me ngjashmëritë mes filmave, pasi kjo tregon edhe një evolucion që ka ndodhur. Së pari është personazhi Neo, i menduar si "Ai që do të shpëtojë njerëzit". Përmendet se atje ka pasur "një" përpara Neos që kishte të njëjtat fuqi. Ky është John Murdoch. Murdoch, megjithëse kishte fituar njohuri të plotë për Shpellën e Platos, madje edhe se si ta manipulonte atë për të hequr Të Huajt për të krijuar një vënd më të mirë, padyshim që ai nuk liroi askënd. Kjo është tani detyra e Morpheusit, Trinitit dhe të ngjashmit, sepse përpjekjet e Murdoch nuk i dhanë fund kontrollit. Bota vazhdoi, ndoshta me një cilësi të këndshme të lirisë për njerëzit për disa qindra ose mijëra vjet; por atëherë bota e *Matrix* vjen prap në vënd. Pas një lufte dhe errësimi të qiellit përsëri, njerëzit u vendosën në bishtaja dhe u krijua një realitet artificial i rremë. Po sikur, ndonjë gjë të fitohej?

Pyetja e parë është, a është vërtet Neo një tjetër version i Murdoch? A është Morpheus dhe Triniti në anën e mirë (ata veshin të njëjtat pallto të gjata të errëta siç Të Huajt vishnin)? Njerëzit në Qytetin e Errët nuk ishin ata që mbanin këto veshje. A po vishet Morpheus dhe Triniti për të paraqitur simbolikisht se ata kanë marrë aftësinë akorduese së Të Huajve të vjetër, dhe si të tillë kanë zgjedhur të duken si ata!? Personazhet e zotit Smith (agjentit) janë të gjithë të veshur me kostume të errëta dhe syze dielli. A janë përditësuar Të Huajt në Z. Smith? Ka kaç shumë pyetje sapo ti të kuptosh se një film është evolucioni i tjetrit shumë vite në të ardhmen. Çfarë po ndodh në të vërtetë në këta filma?

Dr. Schreber dhe Morpheus thonë pothuajse të njëjtat linja dialogu. Ne e dimë se Schreber ishte duke punuar për Të Huajt deri në fund të filmit, kështu që a është Morpheus gjithashtu duke punuar për agjentët prapa skenave? Për sa i përket ngjashmërive të tjera të dukshme, emrat Z. Murdoch dhe Z. Anderson përsëriten vazhdimisht në të dy filmat. John dhe Neo të dy "zgjohen" në një pajisje si vaskë dhe në lëvizje të ngjashme. Të dy John dhe Neo u paralajmëruan përmes telefonit se agjentët ose Të Huajt po vijnë për ta. Në të dy filmat, ndjekësit dalin nga i njëjti ashensor në të njëjtën mënyrë. Ka kërcime të ngjashme ndërtimi që ndodhin në të njëjtat ndërtesa, dhe përdoret e njëjta shkallë bardh e zi. Varri nëntokësor i Të Huajve bëhet qyteti nëntokësor i Zionit në *Matrix* (pra kush e banon vërtet këtë qytet?). Të dy filmat kanë gjilpëra të futura në kokat e personazheve - në pjesën e përparme për të ngulitur kujtimet e rreme në Qytetin e Errët dhe në pjesën e pasme për të futur të ashtuquajturat "programe të njohurive" në Matriks. Të dy filmat kanë të njëjtin insekt si krijesat në trupat në Qytetin e Errët që janë në alienët, por në *Matrix* ato janë te njerëzit. A do të thotë kjo se Neo është vërtet një i huaj, apo alienët kanë kaluar nga implantimi i trupave të vdekur në trupa të gjallë? Apo është kjo një e dhënë se Neo, dhe ndoshta e gjithë anija e njerëzve, janë në fakt të vdekur dhe po përdoren nga alienët në një lloj sfere ëndrrash e prodhuar? Kur fillon të shohësh se Qyteti i Errët është historia e origjinës, të gjitha këto ngjashmëri të *Matrix* janë një thirrje për t'u kthyer në origjinë për të gjetur përgjigjet e tua. Qyteti i Errët duket se jep një pamje të plotë të pambuluar (se si njerëzit mashtrohen dhe nga kush).

Ka shumë skena që pasqyrojnë filmin e vitit 2011, "*The Adjustment Bureau*", i cili në një farë mënyre është gjithashtu filmi *Dark City* (Qyteti i Errët) i ritreguar. Këtu janë disa "ngjashmëri". Kapelet e mbajtura nga të ashtuquajturit kontrollues, urrejtja e ujit, dyert që formohen në mënyrë magjike që çojnë në një zonë të re të qytetit, fshirjet e kujtesës që ndodhin për njerëzit në qytet dhe një fund tjetër i palumtur. Matt Damon tani është personazhi i John Murdoch, dhe ai dhe Elise zgjedhin matriksin, gënjeshtren e dashurisë dhe të jetës. Është duke iu prezantuar shikuesit sikur dikush që quhet Kryetar, ka ndryshuar

historinë në mënyrë që ata të mund të jenë bashkë për shkak të asaj se sa shumë ata e duan njëri-tjetrin. Sa e mrekullueshme. Hmm, jo. Ky është një krijues që kishte agjentë që kontrollonin njerëzit për shekuj, fshinin kujtimet e tyre, ndryshonin jetët, shkatërronin të gjitha përpjekjet që përmbanin një vullnet të lirë, dhe më pas krejtësisht papritur do të bëhej një djalë super i mirë për Matt Damon, dhe do t'i lejojë atij jetën e tij. Manipulimi vazhdon dhe Kryetari është ende ai që po ia zgjedh jetën atij, dhe jo vetë Matt Damon. Kontrolli është ende i plotë, kërkimi për të vërtetën e vërtetë ose pse kjo botë është kaq e kontrolluar ka mbaruar. Ata do të jetojnë në një tokë të lumtur fantazie, vetëm për të vdekur, për t'iu fshirë kujtesa, dhe ky Kryetar (Demiurge) do t'i rimishërojë ata në një trup të ri pa një kujtesë dhe ata do të jetojnë një tjetër jetë të padobishme. Ti ose je në sistem ose je jashtë tij. Siç “*The Adjustment Bureau*” tregon, nuk ka rrugë të mesme.

Ka film ka gjithashtu shumë ngjashmëri me *Qytetin e Errët* dhe *The Truman Show*, një film nga i njëjti vit. Kjo përfshin Murdoch dhe Bumstead që thyejnë murin me tulla me sëpata për të arritur në atë që është jashtë flluskës së realitetit, ndërsa varka e Trumanit shpon barrierën qiellore për të parë se horizonti ishte thjesht një mur i lyer. Ka edhe paralele me Bill Murray në *Groundhog Day*, ku vetëm atij i është dhënë njohuri për natyrën e realitetit, ndërsa pjesa tjetër e njerëzve përreth (të cilët gjithashtu rivendosen çdo mbrëmje, megjithëse ruajnë të njëjtat kujtime dhe personalitete) qëndrojnë në gjumë rreth dijenisë se dita e tyre është në përsëritje të përhershme.

Fundi i Qytetit të Errët nuk është fundi i lumtur që shikuesit besojnë. Ndërkohë që ka një lloj lumturie, sepse Të Huajt janë zhdukur dhe John rilidhet me Emën në botën e re të dritës së diellit-oqeanit që ai sapo ka manifestuar; Ema nuk është më Ema, ajo tani është Anna dhe nuk ka kujtime të mëparshme se kush John është. Ajo duket se ndjen një lidhje me të, duke u përpjekur të tregojë se ndoshta dashuria e dikujt shkon përtej identitetit, teksa ecën me të në diell për në Shell Beach. Por këtu ka shumë më tepër mungesë shprese sesa shpresë. Kjo për shkak se filmi përfundon pothuajse - pothuajse çdo film tjetër me temën e Shpellës së Platos: askush nuk del nga Shpella. Shpella shihet më qartë, ka pasur një ndjenjë lirie ose kontrolli, por të gjithë, përfshirë John, janë ende në shpellë. Përveç tij, askush tjetër nuk duket se është zgjuar në ndonjë nivel më të thellë. Të gjithë të tjerët, ashtu si Anna (e quajtur më parë Ema) do të vazhdojnë në injorancë, duke jetuar në kujtimet dhe identitetin e tyre më të fundit. Në fakt, Anna mund të ishte më e bllokuar se më parë, sepse ndërsa jeta më parë ishte makth, e vështirë, e dhimbshme dhe e errët; kishte ende një kërkim për atë që është e Vërtetë në një farë mënyre. Kur jeta bëhet e këndshme, e ngjashme me plazhin dhe është gjithmonë me diell, e këndshme dhe e lehtë, nevoja për të parë atë që është përtej përgjithësisht pushon. Burgu është shndërruar në

një përvojë të bukur. Edhe pse John ka fituar aftësinë e plotë të "akordimit" së Të Huajve dhe mund t'i japë formë botës (duke thënë se ai e ka bërë atë një vënd shumë më të lehtë dhe të gëzuar), por çfarë është fituar? Ai është ende i vetëm në njohjen e tij, duke jetuar mes shpirtrave që në këtë pikë nuk e dinë si ai dhe që të gjithë ata janë ende të bllokuar në një karakter të rremë. John ende nuk e di se ku është bota origjinale njerëzore, si ata arritën në Qytetin e Errët, apo se si ata mund të largohen?

Faza tjetër e kësaj historie është filmi *Matrix*, i cili tregon se ku është drejtuar Qyteti i Errët. *Matrix* zbulon se për gjithçka që John bëri dhe ndryshoi, jo shumë përfunduan mirë. Bota e Neos pasi ai shpëton nga matriksi i parë, është ajo ku makineritë kanë marrë kontrollin, kanë vendosur njerëzit në bishtaja dhe u kanë dhënë atyre një botë artificiale për të besuar se ata po jetojnë. Disa njerëz të mbetur janë ngujuar në botën e brëndshme të vjetër së Të Huajve. Ti mund të shohësh qartë se Zioni është strofulla e vjetër e Të Huajve. Kështu filmi Qyteti i Errët vazhdoi të bëhej bota e *Matrix*. Sugjerimi nga Morpheus ishte se kjo zgjati shumë, por rezultati përfundimtar ishte se të gjitha ndryshimet e John nuk kishin pothuajse asnjë ndikim në përgjithësi. Të Huajt, ende në formë të infektuar, por tani duke përdorur makineritë e AI, kanë rimarrë botën. Ky është mesazhi i vërtetë i Qytetit të Errët dhe *Matrix*. Askush nuk doli nga shpella e Platos. Bota e John u tejkalua. Të Huajt i vendosën njerëzit në një gjëndje gjumi me kohë të plotë dhe krijuan një botë artificiale për t'i përdorur ata si bateri - kjo është bota nga e cila Neo zgjohet. John ishte origjinali "I Vetmi" dhe ai nuk pati pothuajse asnjë ndikim. Nëse e kupton me kujdes përfundimin e *Matrix 3*, as Neo nuk ka pasur asnjë ndikim. Ai është manipuluar vazhdimisht dhe bota e kontrollit është kthyer në vënd.

Ne duhet të vazhdojmë ekzaminimin tonë në filma të tjerë të ndarjes së mënçurisë për të parë se çfarë ata na thonë për realitetin që ne përjetojmë, dhe nëse ndonjë prej tyre na jep të dhëna se si të dalim!?

- **Westworld**

Unë kam bërë një seri prej tre videosh në YouTube që shkojnë në më shumë detaje në të gjithë sezonin e parë të *Westworld*, kjo është vetëm një pasqyrë e këtij episodi të parë, por duhet të vendosë disa baza për atë që ti mund të shohësh nëse shikon më tej.

Në *Westworld* (një lloj parku zbavitës ky), ekzistojnë tre lloje të ndryshme qëniesh (nuk dua t'i quaj njerëz). Ka "mikpritës", të cilët janë robotë që janë krijuar për kënaqësinë e

"mysafirëve" (të cilët duket se janë njerëz të pasur që vijnë në park si vizitorë për të kaluar përvoja në këtë park), dhe më pas është grupi i tretë që drejton parkun, robotët, të ftuarit dhe logjistikën. Ne nuk kemi një emër për ta, por mund t'i quajmë "programues" ose "kontrollues". Westworld bëhet një mjet për të kuptuarit tonë të brëndshëm kur ne fillojmë të kuptojmë se hostët (mikëpritësit robotë) na përfaqësojnë ne. Ata janë të burgosurit e shpellës së Platos. Të ftuarit mund të krahasohen me parazitët. Një parazit ushqehet me hostet e tij. Pra, ky program mund të shihet si mysafirët që vijnë për të përdorur robotët si pritës dhe terren ushqimor. Në këtë rast ato që po ushqehen janë shpesh përvoja të errëta. Pritësit (robotët) u krijuan në Westworld për t'i shërbyer këtyre entiteteve parazitare.

Robotëve u jepen skripte (historia e tyre) të cilat mund të ndryshohen nga programuesit në çdo kohë. Ti mund të jesh një sherif, pastaj banakier, pastaj i jashtëligjshëm. Skripti, të cilin mund ta quajmë identiteti personal, është thjesht një kod i programuar. Robotët nuk kanë një skenar të vërtetë. Çdo skenar mund të mendohet se ka gjurmë specifike (gjëra që duhet të ndodhin pa pushim) si një linjë regjistrimi, dhe sjellja e tyre nuk duhet të devijojë shumë larg linjës së atij regjistrimi. Ka edhe një sërë gjërash që ata nuk duhet të bëjnë sepse nuk është në programimin e tyre. Pra, nëse robotët na përfaqësojnë ne, kjo do të thotë se në mënyrë të ngjashme, ne jemi programuar dhe as nuk e dime këtë. Mund të duket sikur robotët kanë vullnet të lirë, ata mund të hanë vakte të ndryshme në ditë të ndryshme, por edhe kjo është pjesë e kodit të programuar në ta. Ata kanë përgjigje të skriptuara. Mund të ketë dhjetë zgjedhje të mundshme, por jo njëqind. Kjo është e ngjashme me mënyrën se si unë e shoh realitetin tonë. Ekziston një ndjenjë e vullnetit të lirë për ne, por në përgjithësi është shumë e kufizuar. Mund të duket si vullneti i lirë, por vullneti i lirë është një miliard përgjigje të mundshme për çdo veprim. A mendon se ti vërtet po zgjedh një veprim ose përgjigje bazuar në miliarda mundësi? Apo diçka si pesëmbëdhjetë?

Emrat janë gjithashtu të rëndësishëm në Westworld. Bernard lidhet me personazhin kryesor të *Brave New World* të Aldus Huxley, Fordi me Henry Ford, i cili ishte në njëfarë kuptimi perëndia i *Brave New World*. Dolores është një emër i mirë zgjedhur. Episodi i parë titullohet "Origjinalja". Më vonë ne zbuluam se Dolores ishte prezantuesja e parë robotike e krijuar ndonjëherë në Westworld, kështu që titulli ka të bëjë me të. Fillimisht ne e takojmë atë në një bisedë ku ajo përmënd se ndihet sikur është në një ëndërr dhe pyetet nëse ajo do të donte të zgjohej nga kjo ëndërr. Përgjigja e saj ishte diçka si "po, sepse kam frikë". Kjo tashmë po na tregon ne se natyrën e gjithë këtij spektakli, ajo është në një ëndërr, dhe të vetmet ëndrra nga të cilat ti vërtet dëshiron të zgjohesh janë makthet e

frikshme. Pyetja tjetër që i bëhet Doloresit është "a e ke vënë ndonjëherë në dyshim natyrën e realitetit tënd?" Më vonë zbulojmë se kjo pyetje po bëhet si një mënyrë për të testuar robotët për t'u siguruar se ata janë ende robotë. Nëse roboti fillon të vërë në dyshim realitetin, ata mund të fillojnë të shohin se çfarë entitetet parazitare (mysafirët njerëzorë) u kanë bërë atyre, dhe çdo robot që arrin në një lloj vetëdije, sigurisht që do të përpiqet të shpërthejë. Nga pikëpamja e kontrolluesve, testi më i madh është të sigurohen që robotët të mos vënë në dyshim natyrën e realitetit të tyre.

Kjo lidhet me fshirjen e kujtesës. Sa herë që një robot në Westworld "vdes", ata dërgohen në kontrollin e misionit për një pastrim, dhe më pas për një fshirje kujtese, kështu që ata do të mund të harrojnë "mishërimin" e fundit të tyre dhe do të kthehen përsëri në fushë me programimin e tyre të paprekur, në mënyrë që të mund të qëllohen ose përdhunohen vazhdimisht. Kjo është një arsye madhështore për fshirjen e kujtesës në jetën tonë të përditshme. Nëse ne do të mund të kujtonim vërtet se sa vuajtje ne kemi kaluar jetë pas jete, ne do të kishim mbyllur çdo mishërim këtu shumë kohë më parë. I gjithë kurthi i shpirtit të rimishërimit mund të funksionojë vetëm nëse atje ka një fshirje kujtese, dhe siç u përmënd më lart, kjo do të thotë se mësimi dhe rritja afatgjatë nuk mund të diskutohet. Ne jemi këtu vetëm për t'u përdorur. Është e vështirë të thuhet saktësisht se për çfarë ne po përdoremi (ushqim i thjeshtë energjetik për sistemin siç spekulohet nga shumica, ose si pjesë argëtuese NPC për entitetet jo-njerëzore që vijnë në këtë fushë). Por përsëri, një element kyç është të mos kemi kujtime nga jetët tona të tjera. Sapo kjo ndryshon në Westworld, dhe Dolores dhe Mauve fillojnë të kenë kujtime për jetët e mëparshme të tyre që kanë pasur dhe mënyrën se si ato janë trajtuar, atje shfaqet një forcë e re e brëndshme që u lejon atyre të "shpërthejnë nga burgu i Westworld". Kjo shfaqje, të paktën në sezonin e parë (përpara se seriali të fillonte të ndryshonte në diçka tjetër), kishte të bënte me të burgosurit në Shpellën e Platos duke kuptuar situatën e tyre, dhe kështu vendosën të dilnin pa marrë parasysh se çfarë do të duhej për ta bërë atë. Kjo është një arsye pse ky sezon i parë është i dobishëm për ekzaminimin tonë, jo aq shumë në kuptimin e asaj që ne duhet të bëjmë, por më shumë në nivelin e emocioneve të brëndshme dhe fokusit që ne do të na duhet për të përfunduar detyrën e daljes nga kjo botë ëndrrash.

Në skenën e parë, na është dhënë pjesa themelore e historisë së Westworld. Personazhi tjetër që ne takojmë është Tedi. Ajo që është interesante, është se Tedi paraqitet sikur ai të jetë një mysafir apo i ardhur, por në fakt ai është gjithashtu një mikpritës robot. Ne duhet të pyesim, pse duan ata të tregojnë një robot pritës si mysafir? Më pas ne takojmë njeriun me të zeza (MIB), i paemërtuar, i paraqitur si një lloj ultimat i lig në prezantimin e tij të parë. Duket sikur ai është pjesë e një bande të çmëndur dhe e tërheq Doloresin në hambar

për ta përdhunuar. Megjithatë, ne shohim vetëm skenën kur ai është duke e tërhequr Doloresin në hambar dhe asgjë më shumë. Tashmë ne po shohim që shfaqja dëshiron të prezantojë një gjë, por kjo nuk do të thotë që gjërat janë ato që duken se ato janë— si me Tedin. Ne mësojmë se njeriu me të zeza (MIB) ka tridhjetë vite që vjen në këtë park, dhe në skenën e radhës ka një diskutim mes kontrolluesve që i kujtojnë të gjithëve se nuk ka pasur asnjë dështim kritik në park për rreth tridhjetë vite. Pra, ekziston një lloj lidhje midis këtij jo-dështimi kritik tridhjetëvjeçar dhe këtij njeriu të caktuar me të zeza (MIB).⁶¹

Një skenë e re shfaqet dhe Tedi kthehet përsëri në tren. Menjëherë ne kemi të bëjmë me idenë e ripërsëritjeve kohore, diçka për të cilën unë kam folur mjaftueshëm gjatë viteve dhe në të cilën seriali *Lost* u fokusua. Ne e kuptojmë se Tedi duhet të jetë gjithashtu një robot që kalon ndërmjet një skenari pa pushim. Përsëri, nëse robotët na përfaqësojnë ne, ne duhet të pyesim nëse ne jemi kapur në një linjë të pafundme të rekordeve të jetës!? A kemi pasur të njëjtën jetë qindra apo mijëra herë pa pushim, ndoshta me ndryshime delikate apo jo dhe aq delikate? Njerëzit duan të besojnë se momentet e tyre të përditshme janë zgjedhje krejtësisht e lirë e tyre. Ata nuk duan të mendojnë se ata mund të hanë të njëjtën drekë më 11 gusht për drekën e milionitë.

Kemi ardhur te skena më e rëndësishme në episodin e parë, rëndësia e së cilës më ka munguar herën e parë që unë pashë *Westworld*. Tedi zbret përsëri nga treni dhe ne e shohim atë duke kaluar nëpër të njëjtën rutinë të skriptuar si herën e kaluar. Ai përplasjet me të njëjtin djalë, por këtë herë Tedi ka një përgjigje të ndryshme ndaj incidentit. Tedi devijon. Kjo është e rëndësishme sepse këta janë robotë të programuar dhe kjo përplasje supozohet të ndodhë çdo herë që ai zbret nga treni. Duhet të ketë një mënyrë specifike se si përplasja ndodh dhe duhet të ketë një përgjigje të caktuar. Robotët do të devijojnë nga skenari i tyre vetëm për shkak të një ndërveprimi njerëzor që i bën ata të aksesojnë linja të ndryshme programimi për t'iu përshtatur situatës së re, një lloj improvizimi. Për sa kohë që nuk ka të ftuar njerëz përreth, robotët duhet të ekzekutojnë skriptet e tyre pa të meta gjatë gjithë kohës. Ajo që kjo skenë e vogël po na lejon ne të shohim është se ka atje defekte në programimin e robotit. Kjo gjithashtu do të thotë se ose atje nuk ka programues të mjaftueshëm për t'i kushtuar vëmendje çdo detaji të vogël të monitorimit të robotëve, dhe për këtë arsye diçka e vogël është e lehtë të humbasë. Me vazhdimin e sezonit, ato defekte të vogla me kalimin e kohës do të fillojnë të bëhen më të mëdha.

Kjo çon në ndërveprimin midis babait të Dolores (i luajtur aq mirë nga Peter Abernathy), i cili gjen një fotografi që nuk mund të shpjegohet në realitetin e tij. Kjo e bën atë të kalojë në një krizë ekzistenciale. Ekziston një hapësirë, ose e koduar në brëndësi ose ajo thjesht

⁶¹ Ky personazh lidhet gjithashtu me simbolikën e Njeriu me të Zeza në serinë e novelave të *Kullës së Errët* të Stephen King.

ekziston, e cila nën presione të caktuara mund të bëjë që një robot të klikojë jashtë nga mënyra totale e funksionimit të robotit dhe të fillojë të pyesë. Ne e shohim Abernathin të ulur në introspeksion të thellë, ku ai duket se ka qëndruar jashtë për një natë të tërë duke parë fotografinë, ndërkohë që Dolores del përsëri nga dera duke ndjekur skenarin e saj. Kjo skenë është e rëndësishme sepse është një nga rezultatet e mundshme për të pasur një zgjim të vërtetë. Shumica e zgjimit paraqitet sikur do të jetë dashuri, dritë dhe lumturi, por siç unë kam folur në *Falling For Truth*, të shohësh përmes vellos së realitetit do të jetë shumë e vështirë (veçanërisht nëse lidhet me të parë se sa e rreme vetvetja është). Disi, Abernathy e ka kuptuar se e gjithë bota e tij është e rreme. Unë do të supozoja se shumica e njerëzve që kanë pasur këtë lloj zgjimi, nuk do të shkruajnë kurrë libra, ata thjesht do të merren me atë që ata kanë kuptuar në heshtje, për sa kohë që ata janë ende gjallë. Por Abernathy është pothuajse i detyruar nga brëndësia e tij t'i thotë vajzës së tij se ajo duhet të dale jashtë, ajo duhet të largohet, sepse pjesë e programimit të tij është të mbrojë Doloresin e tij. Pra, përgjigja e tij e parë ndaj zgjimit të tij, është të kuptojë se si ta largojë atë nga atje, në mënyrë që ajo të mos ketë më nevojë të përballet me tmerrin e të qenit një robot në Westworld.

Ai i pëshpërit asaj, "këto kënaqësi të dhunshme kanë përfundime të dhunshme", e cila vjen nga Romeo dhe Zhulieta, një histori dashurie që nuk përfundon me një përfundim përgjithmonë të lumtur. Diçka e ngjashme po paralajmërohet për Westworld. Episodi përfundon me Dolores duke vrarë mizën. Programimi i saj tani është plasaritur, ajo është gati të marrë udhëtimin e saj drejt qendrës së labirintit, që sigurisht është udhëtimi drejt qendrës së Vetes së vërtetë. Abernathy i referohet "djajve të botës", të cilët në Westworld janë mysafirët njerëzorë, po ashtu edhe origjina e panjohur e kontrolluesve. Në realitetin tonë janë të ftuarit (qëniet parazitare) që marrin përsipër mëndjet e njerëzve dhe marrin shumë që e ndjekin atë, të veprojnë në mënyra të tmerrshme kundër pjesës tjetër së popullsisë. Ne nuk jemi krijesat më të mira në këtë botë. Paraqitja e njerëzve si disi të avancuar dhe të mrekullueshëm nuk përputhet në të vërtetë me mënyrën e përditshme të vetë-rëndësishme dhe manipuluese që ne jetojmë. Kjo sigurisht nuk është e vërtetë për të këdo, shumë ende veprojnë me njerëzi, mirësi dhe etikë të madhe, por kjo është një pakicë e vogël njerëzish, dhe rrallë mund të gjendet në fusha ku dikush ka një pozicion kontrolli, pushteti ose autoriteti.

Në videot e YouTube që unë bëra, unë shkoj më thellë për të diskutuar karakterin e Williamit, dhe zgjimin që e kthen atë disi si të çmëndur. Epo, të çmëndur në një Kapiten Ahab lloj mënyre. Si edhe ekzaminime se çfarë kontrolluesi Ford përfaqëson, dhe shumë

aspekte të tjera të këtij sezoni të parë. Ti mund t'i shikosh ato episode (duke supozuar se ato ende ekzistojnë në internet) në shënimin në fund të faqes aktuale.⁶²

Unë do ta ndaloj kapitullin këtu, kështu që ti mund të vazhdosh të lexosh tema të tjera në libër, megjithatë, unë bëj më shumë analiza filmash dhe seriale televizive në seksionin "Shtojca e Filmave Shtesë". Aty unë shikoj mbi: **Inception, They Live, Donnie Darko, Lost, Eyes Wide Shut, 2001 Space Odyssey dhe Star Trek Voyager "Coda"**.

⁶² Tre video të Westworld https://www.youtube.com/watch?v=EG_00OXWhlo
<https://www.youtube.com/watch?v=U0Ng11j7yYs>
<https://www.youtube.com/watch?v=iW8rwtC7PZo>

EKSPLORIM KONTEMPLUES

9

EKSPERIENCA JO-STANDARTE PRANË VDEKJES

Është koha për të ardhur në NDE-të që nuk ndjekin dukurinë e zakonshme. Këto janë shumë më të vlefshme, thjesht sepse unë besoj se përvoja e "një madhësi i përmbush të gjithë" është një lloj produksioni teatral. Këto përvoja janë krijuar për të mashtruar dhe hutuar, jo vetëm personin që përjeton NDEn, por të gjithë ata së cilëve ata ua thonë atë kur ata kthehen.

Kjo më çon në një përvojë që unë vetë pata kohë më parë në vitin 2010, në mes të një prej periudhave të sëmundjes sime, kur unë po vizitoja nënën time në Manitoba, Kanada. Doja të kontaktoja një mjek për ndihmë dhe më rekomanduan të shihja dikë në Rezervën e Dakotës. Më kishin thënë, *"ai është një njeri shumë i fuqishëm"*. Dhe kështu, unë shkova me makinë për ta parë atë, i trokita në derë dhe i shpjegova se pse isha atje. Ai më la të hyja, më pas më injoroi për shumicën e dy orëve, ndërsa njerëzit e tjerë vinin e shkonin. Më në fund ai erdhi dhe më tha: *"Nuk mendoj se mund të të ndihmoj, por shoku im po ashtu është një shërues. Shko ta shohësh atë"*, dhe ai më dha adresën e tij.

Shkurtimisht, shëruesi tjetër, Clayton, u bë jo vetëm një shërues madhështor për mua, por edhe një mësues madhështor i traditave Lakota. Me kalimin e kohës, ai tregoi se si ceremonitë e tij, që zhvilloheshin në errësirën e zezë pa hyrje të dritës së jashtme, dhe se zakonisht kishte pak që "ndodhte" jashtë. Ceremonitë e mikut të tij (gjithashtu në dritën e zezë) prireshin të kishin shumë ndezje dritash, tinguj dhe nxehtësi. Clayton më tha se njerëzit që vinin si të tillë, ata erdhën për shfaqjen e dritave, por nuk ndodhi shumë shërim për ta. Ceremonitë e tij, përkundrazi, kishin shumë pak shfaqje ose përvoja (megjithëse unë pata disa me kalimin e kohës), por ai pohoi se *"njerëzit bëhen mirë. Pra, është mirë që miku im të dërgoi tek unë."*

Shfaqja e dritave ishte më shumë një truk për të joshur njerëzit, për ta bërë njeriun të ndihej sikur diçka e veçantë po ndodhte. Ndërkohë, Clayton shpesh nuk kishte asgjë në frigoriferin e tij dhe sa herë që unë shkoja ta takoja atë, sillja me vete një qese me gjëra ushqimore. Sa herë që i jepja para, ai ia jepte ato gjithmonë dikujt në familjen e tij që

“kishte nevojë”, edhe pse ishte e qartë se atij i duheshin ato. Mendimi i tij ishte të ndihmonte të tjerët, jo ngushëllimin e tij ose vendosjen e shfaqjeve. Mësova shumë prej tij në gjashtë muaj që e njoha atë. E vërteta ndonjëherë gjëndet kur atje duket sikur asgjë nuk po ndodh. Dhe kështu, duke e sjellë këtë në ekzaminimin tonë të përvojës së dritës së bardhë dhe dashurisë në NDE-të standarte, a është kjo përvoja "e vërtetë", apo një lloj "mashtimi" për ta vënë të sapo ndjerin në një gjëndje hipnoze?

Përsëri, NDE-të e shpërndara këtu vijnë të gjitha nga faqa <http://www.nderf.org>. Unë kam përfshirë emrat dhe numrat e përvojës së atyre të referuar, në mënyrë që ti të mund të rishikosh të gjitha përvojat e tyre nëse dëshiron. Në bërjen e zgjedhjeve, më ndihmoi informacioni që Wayne Bush postoi në uebsajtin e tij: www.trickedbythelight.com/tbtl/light.shtml ⁶³

Unë do ta paraqes NDE-në në "citate", dhe kur unë të kem një koment personal, ajo do të shfaqet në (kllapa).

“Unë u mora jashtë trupit përmes tunelit, por këtë herë unë munda të vizitoja plane të tjera të ekzistencës. Ishin shtatë që unë isha i lejuar të shikoja, duke përfshirë një plan shumë të çuditshëm ku unë mund të shikoja brënda një moçali gjigant ku shpirtrat torturoheshin seksualisht, etj, në të gjitha llojet e formave të neveritshme. Ata 'mendonin' se ata ishin të bllokuar, ndërkohë që gjithçka që ata duhej të bënin ishte të shikonin lart dhe atje ishte një shteg për te DRITA. Moskërkimi dukej se ishte dënimi i tyre. Unë u bërtita atyre, por kjo u duk sikur ata nuk mund të dëgjonin. Më çuan në entitete të veçanta që dukeshin si gritë e zakonshëm, por kishin shumë rrudha në fytyrat e tyre. Ata e quanin veten Këshilli dhe thanë se ishin pjesë e një grupi të quajtur "riciklues të shpirtrave" që ndihmonin shpirtrat të rimishëroheshin.” Ruth, 2038

(Këtu alienët janë ata që janë përgjegjës për rimishërimin, dhe Ruth gjithashtu përshkruan në zonat e saj NDE të sferës astrale ku shpirtrat janë të bllokuar dhe torturuar. Kështu, nuk është vetëm në Tokë që vuajtja po ndodh. Wes Penre gjithashtu shkroi për këtë, rreth qyteteve të torturës dhe kontrollit në sferat astrale, ndërkohë që shpirtrat presin rimishërimin e tyre të ardhshëm).

⁶³ Ai ka përfshirë qindra fragmente, me tema të ndryshëm. Ai ka bërë një punë të mrekullueshme duke lexuar mijëra NDE dhe që ka zgjedhur ato fusha me interes. Unë u ndihmova prej tyre për të zgjedhur se cilën përvojë të shqyrtoja. Ndonjëherë, unë përdora të njëjtin fragment si ai, herë të tjera gjeja diçka tjetër në NDE që ishte më interesante.

“Pastaj krejtësisht papritur, unë u thitha me shpejtësi në atë që unë mendoja se ishte kjo hënë e plotë. Atë natë hëna ishte e argjendtë, kështu që kjo ishte 'drita' për të cilën NDE-të flasin për. Kur unë arrita atje, pashë një radhë njerëzish që prisnin në një dhomë të bardhë që nuk dukej se kishte kufij apo rreshta. Drita e dhomës ishte një dritë e panatyrshme, por e bukur dhe ngushëlluese. Pikërisht kur unë mendova me vete: 'Uau ka rreshta edhe në parajsë'. Katie W, 7795

“Ndërsa unë hodha një vështrim përreth unë pashë një dritë të ndritshme, ishte hëna, dielli po reflektonte dritën nga sipërfaqja e hënës, ne ishim në hapësirë, në distancë të barabartë me hënën në anën e djathtë (duke shikuar nga toka). Nuk mendoj se ky ishte destinacioni i fundit i parajsës, mendoj se ishte një zonë përshëndetëse për të na pritur kur ne kalojmë përmes... Pastaj ai më tha mua se nuk ishte koha ime dhe se unë duhet të kthehesha përsëri prapa. Dy engjëj më kthyen mbrapsht. Ndërsa unë po largohem, po humbas informacionin që unë mësova. Dëshpërimisht jam duke u përpjekur ta kujtoj atë dhe të mbahem në atë informacion.” Ron A, 916

(Këto dy përvoja ndajnë se drita e bardhë është Hëna, ndërsa të tjerët në NDE-në e tyre kanë pohuar se ishte Dielli.⁶⁴ E para diskuton pritjen në radhë, e cila është gjithmonë një lloj kontrolli, ndërsa e dyta paraqet "nevojën për të shkuar prapa," dhe se atje ka shumë nga përvoja që ai mund të mos mbajë mend.)

“E pasigurt deri në këtë ditë. Nuk më kujtohet nëse pasi unë po shikoja poshtë vendimi për t'u kthyer prapa ishte plotësisht i imi apo një zë i brëndshëm më forcoi që nuk i përkiste vetes sime.” Rena P, 2060

"Ishte sikur të liroheshe me kusht nga ferri dhe më pas të detyroheshe të ktheheshe... Unë e dija se isha 'në shtëpi', por unë doja aq shumë të isha me nënën time, poashtu, sa që zgjodha të shkoja tek ajo dhe të prisja për portokallen." Barbara G, 2946

“Ajo që mua më ndodhi ishte e VËRTETË, jo një ëndërr, që atëherë unë u kujtova se ata më “dërguan” prapa kundër dëshirës sime. Atëherë unë isha vërtet i NEVRIKOSUR! Pse më detyruan të kthehesha, kur unë doja të qëndroja?? U ndjeva i kontrolluar. Pse ata më pyetën mua, nëse vendimi nuk ishte vërtet i imi?? OOOOO isha shumë i NEVRIKOSUR!!! Sigurisht që tani unë e di pse. Jeta ime në TOKË nuk kishte mbaruar ende. Kisha ende shumë për të bërë. Kisha

⁶⁴ Dielli, Hëna dhe trupat e tjerë planetarë diskutohen në Shtojcën, "Planetet".

shumë për të mësuar dhe duhej të ndihmoja të tjerët me këtë përvojë.” Steven R, 190

(Steven e justifikon të qenit kthyer mbrapsht sepse ai "kishte mësim për të bërë" dhe "të ofronte ndihmë për të tjerët." Është e mahnitshme se si kjo veçori e NDE-ve fshihet. Aspekti 'drogë' i përvojes është kaq madhështor, njerëzit duket se nuk janë në gjendje të përqëndrohen në faktin se ata me shumë gjasa janë manipuluar nga entitete jo-njerëzore ndërkohë që ata ishin në një gjendje konfuzioni pas-vdekjes për t'u kthyer në trup kundër vullnetit të tyre).

“Lëviza kështu që unë të mund të arrija sa më shpejt te drita. Por përpara se të shkoja te dera, një nga rojtarët më kapi dhe më mbajti fort. Dyert u mbyllën. Më pas, unë e gjeta veten në një lloj salle gjyqi. Përpara meje ishte ulur një gjykatës jashtëzakonisht i ashpër, i gjithëfuqishëm, por shumë i sjellshëm. Absolutisht i pakorruptueshëm. Detyra dhe personi ishin një dhe personi nuk ekzistonte pa detyrën. U ula në një stol dhe pranë meje ishte një mik apo mbrojtës. Dashuri e madhe buronte prej tij. A ishte ai Jezusi? Gjykatësi më pyeti: Çfarë po bën këtu? Mua më pushtoi frika dhe doja të zgjohesha, por kjo nuk ndodhi. Mendova për këtë dhe kujtova se kisha dashur të vdisja. Gjyqtari u mendua pak dhe tha: Por ti ke një mision. Unë nuk doja të kthehesha në ferr që është realiteti i të qënurit në tokë. Por gjyqtari vendosi në mënyrën e tij objektive: Ti duhet të kthehesh!” Attila P, 3625

(Përvoja për Atillan ndodhi kur ajo ishte katër vjeçe, pra ajo mund të ketë sens që ata të shfaqeshin si gjyqtarë në një gjykatë, më të frikshëm për një fëmijë se ndoshta në një të rritur, dhe kështu, ka më shumë të ngjarë që ajo të bëjë atë që ata thonë pa asnjë pyetje. Një tjetër mashtrim për mendimin tim.)

“Salla e gjyqit ishte e shtruar në mënyrë elegante; dizajni i saj mbresëlënës dhe elegant. Mobiljet ishin të dalluara dhe të botës së vjetër, të punuara nga artizanë të talentuar dhe të ndërтуara me materiale të ngjashme me alabastër dhe mermer. Vëndi i ndritshëm i Gjykatësit ngrihej mbi gjithçka tjetër në dhomë dhe pasqyronte autoritetin e Atij që e drejtonte atë.” Kate D, 6443

(Kjo eksperiencë nga Kate duhet të lexohet në tërësinë e saj për ti bërë asaj drejtësi. Ajo gjithashtu është e re, ndoshta një adoleshente dhe po përpiquej të bënte vetëvrasje. Seriozisht, të lutem shko dhe lexoje atë. Ajo përfshin një 'tallje' gjyqi gjigante para dhe mbrapa ku ata po përpiqen ta akuzojnë atë për vrasje dhe çdo veprim të dëmshëm që ajo ndërmori si një lloj fyerjeje ndaj botës. Ata madje

përcaktojnë se "çfarë ligji është" dhe kjo gjithashtu është një lloj mashtrimi. Ata gjithashtu nuk kanë asnjë përgjigje për të kur ajo pyet "ku ishe ti kur unë u ngacmova në moshën katër vjeçare?" Edhe pse kjo përvojë përfundon me Jezusin që "e shpëtoi" atë dhe e ktheu në jetë, kjo është një nga NDE-të më madhështore që unë kam lexuar ndonjëherë. A janë ata vetëm duke e mashtruar atë, apo duke u përpjekur të mashtrojnë njerëzimin energjetikisht nëpërmjet saj?)

“Më pas erdhi një lloj gjykimi, ku unë u gjykova për gjërat që unë kisha bërë dhe gjërat që unë do të bëja në jetën time të ardhshme. Kjo më mërziti pasi mendova se kjo kishte për qëllim të më dënonte ose gjykonte për gjërat që unë ende nuk i kisha bërë.” Gail A, 7219

(Si mund të ketë vullnet të lirë nëse dikush do të gjykohej tashmë për atë që ata DO TË BËJNË?)

“E pyeta atë se cili është kuptimi i jetës. Ai më tha; 'Për argëtimin e sferës shpirtërore'. E pyeta se kur bota do të mbaronte, dhe si një i dërguar i Zotit ai më dha përgjigjen, megjithatë ai përmendi se atje do të kishte disa gjëra që unë nuk do të lejohesha t'i kujtoja dhe kjo do të ishte një prej tyre.” David J, 2641

(Jeta mund të jetë thjesht argëtim për qëniet e tjera, dhe ka gjëra të NDE-së që ai nuk do të "lejohet t'i kujtojë." Sa nga pjesët e rëndësishme të këtyre përvojave, kontratave dhe marrëveshjeve, janë 'fshirë nga memoria' gjithashtu, edhe kur personi rikthehet në trupin e tij ose të saj dhe nuk vdes dhe rimishërohet?)

“Pashë Dritën të afrohej, unë u mbështolla nga drita dhe nga një entitet që do të më përgatiste për atë që unë e quaj Intervistën time me një qenie supreme më vonë në Dritë. Kjo qenie e parë dukej se ishte Virgjëresha Mari. Vetëm pasi pyeta: "A je ti vërtet Virgjëresha Mari, ajo manifestoi në çast identitetin e vërtetë. Unë pothuajse u paralizova nga frika derisa e pyeta përsëri; "të lutem, çfarë po ndodh me mua, çfarë po ndodh këtu?" Robert B, 701

“Pra, mendimet më erdhën në kokë: çfarë lloj forme do të të bënte ty më rehat. "Çfarë do të thuash?" Unë mendova përsëri. Disa kërkojnë që unë të marr formën e një plaku të urtë, të tjerë të një gruaje dhe disa të tjerë të një kafshe, të gjitha rracave të ndryshme, moshave, madhësive ose specieve të ndryshme. Po ti? Unë mendova pa hezitim "Njeri". Me këtë, drita filloi të ndahej në të njëjtën kohë në rreze të mahnitshme ngjyrash dhe të intensifikohej në një

formë më të fortë. Sapo drita arriti në fazën ku ajo dukej si një formë njerëzore, një formë prerëse biskotash mjaft e zakonshme, si një bukë me xhenxhefil, unë mendova: "Kjo është mjaftueshëm, unë jam rehat me këtë formë". Kathi B, 3339

(Këtu, këto tregojnë se qëniet janë në gjëndje të lexojnë mendjen e të ndjerit dhe t'i projektojnë atyre atë që ata dëshirojnë të shohin ose që presin të shohin. Ata priren të paraqesin forma që e bëjnë të ndjerin pas-vdekjes të ndihet i sigurt në fillim. Ky është një mashtrim i drejtpërdrejtë, të mos jesh i sinqertë me një shpirt që në fillim.)

"E ekzaminova kanalën me kujdes, pastaj kur unë pashë në anën tjetër të kanalit, atëherë ishte kur forma filluan të formoheshin. Pashë këto krijesa të zeza që mund të ndryshonin formën nga të vogla në të mëdha dhe anasjelltas. Unë e dija se ky nuk ishte një vënd i mirë për të qënë. Ishte si të shikoje një lojë skenike, por me krijesa të vërteta demonike. Nuk do ta harroj kurrë këtë sa të jem gjallë. Krijesat ishin të zeza dhe dukej sikur ato po notonin." Kiko M, 2865

(E përfshiva këtë sepse është shumë e ngjashme me atë se si Karlos Kastaneda e përshkroi fluturuesin (predatorin) - si krijesa që kanë ardhur për të na marrë përsipër, për të na dhënë një mendje parazitare dhe për të konsumuar energjinë tonë. Kastaneda e përshkroi atë si, "*Pastaj unë pashë diçka që më ftohte deri në palcën e kockave. Pashë një hije gjigante, ndoshta pesëmbëdhjetë këmbë në ajër dhe më pas ajo u ul me një goditje të heshtur.*"⁶⁵ Është interesante që Kastaneda përshkroi dhe gumëzhimat e çuditshme në veshët e tij kur kjo po ndodhte, e ngjashme në përshkrimin modern të tringëllimave në veshë. A janë disa periudha të zhurmës spontane në vesh për shkak së të qënit në afërsi me këto qënie hije?)

"Ajo ishte kontrata që unë mora kur erdha në këtë jetë. Ti duhet të jesh shpirtlartë dhe atë që ne sot e quajmë një person optimist. Sepse gjithmonë ka të bëjë rreth zgjedhjes." Jacqueline HW, 3713

"Ne duhej të shkonim në mbledhjen e këshillit. Mua më lejuan të isha në dhomë, por nuk më lejuan të flisja apo ndërhyja në asnjë mënyrë. Gjatë takimit, Mjeshtrit kërkuan që një vendim të anulohet. Ai vendim ndryshoi gjithçka. Për shkak së të gjitha takimeve që unë kisha pasur dhe ndikimit mbi esencën time, u përcaktua se ata do të përpiqeshin për një rimishërim të menjëhershëm. Ata

⁶⁵ Kastaneda, *Ana Aktive e Pafundësisë*, kapitulli dymbëdhjetë

u kthyen nga unë dhe më thanë se nëse unë do të pranoja të merrja këtë kontratë të re. Ata më thanë, 'Unë do të vuaj siç do të vuante çdo grua njerëzore që kishte shkallën time të vdekjes traumatike, por shërimi im do të ndihmohej dhe përshpejtohej shumë nëpërmjet tyre nëse unë do të pajtohesha me kushtet.' Shumë diskutime shkuan rreth kësillit, Mjeshtrit. Më pas ata u kthyen nga unë. Në fund të fundit, unë rashë dakord." Marie W, 7325

“Ne kërkojmë që të lindemi dhe ne hyjmë në një kontratë. Ne vijmë në tokë me një qëllim. Në anën tjetër, kjo është gjithçka që ka rëndësi: a e realizuam ne atë mission apo jo? Ne nuk gjykohe mi nga askush, por ne ndihemi si të dështuar nëse kuptojmë se ne nuk e kemi përmbushur misionin për të cilin ne jemi mishëruar për.” Chantal L, 6428

(Këtu është koncepti i kontratës. Kjo duket të jetë e rëndësishme, edhe nëse pakkush e kujton atë. Është thelbi i ndërveprimit që Komandanti ka me alienin e maskuar si babai i saj në episodin "Coda" të "Star Trek Voyager". Ajo kuptoi; *"ti do që unë të pranoj të shkoj me ty."* Kështu, duket se ata nuk mund të na forcojnë, dhe çdo marrëveshje është një lloj kontrate. Kapitulli i fundit e diskuton këtë më tej dhe nevojën për të anuluar të gjitha kontratat shpirtërore që ne mund të kemi bërë (zakonisht të gjitha të paraqitura me hile, dhe kështu, mashtruese).

“Kontratat e shpirtit janë një marrëveshje madhështore për arkonët. Nuk ka një kurth fizik sepse ti nuk je më fizik në këtë pikë. Ajo tashmë është më shumë si një lloj angazhim i yti në lojrat e tyre. Një shëmbull është se ti bëre diçka që të bëri ty të ndihesh me faj në tokë dhe thjesht të bëri të ndihesh tmerrësisht keq. Ata do të jenë në gjëndje të lexojnë se kjo ka ndodhur sepse ajo është aktive në kujtesën tënde. Më pas ata do të fillojnë të të tregojnë ty rreth dëmit që ajo u shkaktoi të tjerëve. Shumicën e herëve ajo që ata të tregojnë ty nuk është se si ajo në të vërtetë ka ndodhur, por nëse ti nuk je në dijeni të kësaj, atëherë ti lehtësisht mund ta pranosh atë që ata thonë. Më pas ata do të thonë se ajo nuk ishte pjesë e kontratës që ju keni rënë dakord të përmbushni dhe më pas do të të tregojnë një skenë të nënshkrimit të kontratës së trilluar. Në atë pikë ti shkon racionalisht. Epo, unë nuk bëra atë që unë supozohej të bëja, por ata do të më ndihmojnë të korrigjoj problemin dhe natyrisht ata lënë të kuptohet se Zoti dëshiron që ti ta bësh këtë për të përsosur veten dhe nuk mund të largohesh për shkak të karmës së keqe etj. Pra, nëse ti nuk di asgjë tjetër, ti i nënshtrohesh autoritetit të tyre dhe vendos të korrigjosh problemin, i cili është vetëm në një mënyrë, rimishërimi... I gjithë sistemi është ndërtuar mbi një mashtrim. Nëse ti ke fuqi dhe kontroll autoritar, atje nuk ka nevojë për nivelet e mashtrimit që shfaqen. Fakti që ata në të vërtetë nuk kanë fuqi ose autoritet mund të demonstron në shumë mënyra, por

gjëja më e rëndësishme për t'u mbajtur mënd është se çdo njeri është shumë më i fuqishëm se çdo qenie astrale. Drita, vetëdija, shpirti ynë, ose çfarëdo që ti dëshiron ta quash atë, është diçka që ata nuk e kanë. Pikërisht kjo është fuqia që ata duan të mbajnë në këtë botë për t'i mbështetur ata. Spektaklet dhe truket që ata të tregojnë ty, poashtu edhe ndryshimi i formës është sepse ata nuk kanë fuqi. Çdo shpirt, çdo njeri, ka aftësinë për ta pohuar këtë sovranitet dhe të realizojë fuqinë e vet.” **Komenti i Wayne Bush**⁶⁶

"E vetmja gjë që vë ndonjë dyshim në mendjen time është mundësia se Satani mund të simulojë dashurinë e Zotin dhe t'i joshë njerëzit në mashtrim (gjithsesi, kjo është ajo që njerëzit thonë).” Skeeter, 2331

“Fillimisht besova se gjatë kësaj përvoje, unë kisha qënë në praninë e Zotit. Por me kalimin e viteve pata disa beteja të vërteta, duke pyetur veten se cila qenie – Zoti apo Satanai – kishte qënë burimi i tyre.” R.A, 6492

“Fetë mësojnë për një zot të rremë që nuk është Zoti i vërtetë i jetës së përtejme, por ndoshta një entitet demon në vetvete, të cilin ata e paraqesin si Zotin e vërtetë... KY NUK ËSHTË ZOTI! Ky është përkrimi i frikës dhe errësirës. Zoti nuk është një kontrollues fanatik bipolar i etur për gjak, i prirur për të balancuar disa 'bilanse mëkati'. Presioni nuk buron prej tij. Presioni është i bazuar në frikë, i cili buron nga errësira. Zoti është suprem dhe jo një spiun i vogël. Ai nuk është një shkenctar kontabilist i sjelljes vigjilente apo një polic mendor karme, me një prirje për zemërim hakmarrjeje... Ky është skllavërim shpirtëror, që e detyron njeriun të jetojë në një gjëndje të ndryshuar vetëdijeje, si dhe një gropë shpirtërore konfuzioni.” Paul, numër i panjohur

(Këto janë shëmbuj shumë të qartë, se qëniet që e paraqesin veten si shpirta të dritës së bardhë, Zot ose Jezus, janë me shumë gjasa diçka tjetër. Problemi është se njeriu mesatar do të jetë kaq i hutuar pas vdekjes dhe aq i verbuar nga drita e bardhë, që pothuajse vepron si një drogë, saqë edhe nëse dikush do të donte të pyeste: *"hej, a je ti me të vërtetë Zoti apo Satani?"*, atje nuk ka vetëdije të mjaftueshme për ta bërë këtë. Unë besoj se kjo është arsyeja pse ti duhet të punosh me ëndrrat e qarta (lucid dreaming) dhe përvojat jashtë trupit ndërkohë që ti je ende gjallë, do të jetë një ndihmë madhështore drejt përgatitjes.)

⁶⁶ <http://www.trickedbythelight.com/tbtl/light.shtml>

Përvojat që unë nuk i kam diskutuar shumë këtu, janë ato që mund të quhen **Boshllëku**. Një vënd ku ka Asgjë, nuk ka kohë dhe nuk ka hapësirë. Një errësirë që është edhe plot edhe bosh. Kjo ka ngjashmëri të madhe me Dritën e Qartë e diskutuar nga Budistët Dzogchen, e përshkruar si një ndalesë kryesore që dikush dëshiron të bëjë në sferën e pas-vdekjes. Do të pajtohesha që, të paktën si një pikënisje, Boshllëku është shumë më mirë se drita e bardhë. Drita e bardhë, ndonëse joshëse dhe e dashur, është kurthi për të nisur procesin e riciklimit; ndërsa Boshllëku (i cili është burimi i së gjitha objekteve materiale) është një vënd nga ku të paktën ne mund të qëndrojmë dhe të kuptojmë se cili mund të jetë opsioni tjetër. Edhe pse boshllëku mund të duket i palëvizshëm për një kohë të gjatë, përfundimisht në një moment do të ketë një shtytje të mundshme për lëvizje. Një tjetër janë përvojat e njerëzve që kanë kujtime "para-lindjes" duke pretenduar se ata kanë zgjedhur prindërit e tyre dhe përvojat e jetës së tyre. Nëse kjo është e vërtetë, pyetja për njerëzit që kanë pasur vuajtje të mëdha nga prindërit e tyre të zgjedhur, duhet të jetë, pse do të zgjidhje ti diçka të tillë? Tingëllon më shumë si një sjellje adiktuese ose urrejtje ndaj Vetes.

Mendoj se ky kapitull i vogël i ka shërbyer qëllimit të tij. Për të lënë ty të shohësh se jo të gjithë po përjetojnë përvoja të mrekullueshme të dritës së bardhë dhe po mbushen me dashuri me gjyshen dhe Jesusin etc. Ajo që ti lexove më sipër ka të ngjarë të jetë më afër asaj që me të vërtetë këtu po ndodh, sesa ato 'përvoja propagande' standarte me të cilat arkonët po i dërgojnë njerëzit përsëri në Tokë. Të lutem, ose shko te faqja e Wayne, ose www.nderf.org, dhe shikoje këtë pjesë më shumë, me një mëndje aktive. Të gjitha përvojat janë të vlefshme dhe të vërteta për vetë përjetuesit. Cila prej tyre ishte pikëpamja se si realisht është sfera e pas-vdekjes dhe cilat janë manipulime? Kjo është pyetja që ne të gjithë duhet të bëjmë.

Në kapitullin e fundit unë do të diskutoj disa ide të tjera rreth sferës astrale, duke përfshirë tre fusha të përvojës pas-vdekjes. E para është pjesa më e madhe e asaj që NDE-të standarte rrotullohen rreth: drita e bardhë, rishikimi i jetës, gjykimi, qëniet e dritës ose njerëzit e dashur. Edhe disa pjesë negative të renditura më sipër priren të jenë në këtë fushë të parë. Sfera e dytë astrale është një sferë negativiteti dhe e treta është një e një pozitiviteti të rremë. Në secilën, shpirti hahet dhe mundohet edhe një herë. Disa nga përvojat e përmendura në këtë kapitull, ka të ngjarë të prekin nivelin e dytë, prandaj edhe pse ato janë kaq të rëndësishme. Niveli i parë është më shumë një lloj "stërviçjeje", një truk, një drogë, një mashtrim për të bërë dikë të "regjistrohet" në shfaqjen e çmëndur të rimishërimit edhe një herë. Këtu ne duhet të kemi forcën dhe sovranitetin tonë që në fillim. Shih kapitullin e fundit për më shumë mbi lëvizjen në sferat e pas-vdekjes.

Së fundmi, do të përmend një ide përfundimtare që vjen nga NDE-ja ime në vitin 2005. Kam shkruar në *Falling For Truth* se si, të paktën për mua, fillimisht kalova një periudhë qetësie dhe qartësie të madhe për rreth diku nga gjashtë në nëntë muaj pas përvojës. Atje kishte mungesë frike (filmi i vitit 1993 *Fearless* është një vështrim i përsosur se si unë po jetoja). Por kjo filloi të ndryshojë. Konfuzioni filloi të zvarritet, sëmundja filloi të shfaqej. Duke e parë atë tani, një lloj manipulimi "në-jetë" po ndodhte. Disa vite më vonë fillova të pyes veten, diçka që disa NDE të tjera që unë njoh e kanë menduar, a vdiqa unë me të vërtetë në atë kanion? A është se çfarë unë kam menduar se ka qënë jetë gjerë atëherë, vetëm një ëndërr e gjatë gjysmë-sekondëshe midis momentit të jetës dhe vdekjes? A jam unë i vdekur dhe thjesht po ëndërroj se jam gjallë? Kjo bëhet një pyetje për të tjerët që kanë pasur përvoja jo-standarte që nuk i përshtaten normës, dhe që të cilat të kthejnë ty duke i pare gjërat me një vështrim kontemplues, duke bërë pyetje të vërteta të thella se ku ti je dhe pse ti je. Jo me përgjigje standarte, por për të parë vërtet se çfarë ti mund të gjesh. Nuk dyshoj se nëse do të mund të intervistoj njerëzit që janë cituar më lart, shumë prej tyre do të ishin kthyer këtu dhe nuk do të ishin aq pranues së kësaj bote apo përgjigjeve që ata supozohet të besojnë. Pyes veten se sa prej tyre do ta gjejnë pikërisht këtë libër. Nëse kështu, do të isha shumë i interesuar të dëgjoja historinë e tyre "që nga koha e NDE-s së tyre".

10

LUTJA

Unë i përmenda rreziqet e lutjes në kapitullin e parë, dhe të shndërruarit në 'pre' duke e performuar atë në mënyrën se si na mësuan prindërit dhe feja. Në *Falling For Truth*, unë ndava atë që unë mësova nga koha ime me shërues Indianë Nativ të ndryshëm. Për ta, lutja nuk ishte për të kërkuar diçka, por për të ofruar një falënderim për atë që ekzistonte tashmë (ose së shpejti). Kjo thënie e falënderimit dhe duke i uruar gjërave mirë ka të bëjë me përvojën tënde në këtë moment. Lutja normale ka të bëjë me të ardhmen, duke kërkuar atë që ne duam dhe duke besuar se një forcë jashtë nesh do të jetë faktori që vendos nëse ne do ta arrijmë atë apo jo. Njëra lutje është lidhëse, tjetra na vendos që të manipulohemi.

Metoda normale e lutjes është e çrregullt. Mendon për njerëzit e Egjiptit të Lashtë, ose qytetërime të tjera me shumë perëndi. Egjipti i Lashtë mund të ketë pasur më shumë se pesëqind perëndi (të njohur si Neteru). A mund ta imagjinosh të përpiqesh të mbash mend të gjitha ditët, ofertat dhe lutjet e duhura të festave për secilën? Vë bast se "*Enciklopedia e Lutjes në Egjipt*" do të ishte një libër më i shitur në vitin 1500 para Krishtit. Më parë e vlerësoja Egjiptin e Lashtë për urtësinë e tyre, madje shkruajta një libër me atë linjë të të menduarit. Por tani, pas studimit të dhjetë viteve të fundit, më duhet t'i rivlerësoj ato besime. Duket se Egjipti, gjatë kohës së Faronisë, u ndërtua për të adhuruar shumë gjëra jashtë vetvetes. Ne të gjithë duam të besojmë se ajo për të cilën ne lutemi është dashamirëse dhe e dashur, por nëse ne jemi të sinqertë, ne nuk jemi vërtet të sigurt se kujt dhe çfarë ne po i lutemi. Vënia e fokusit tonë në atë që është jashtë vetvetes është gabimi i parë.⁶⁷

Lutjet e falënderimeve nuk e vënë fokusin jashtë, dhe si e tillë atje ka magji që mund të vijë prej saj. Mua më pëlqen të mbledh boronica. Kur shkoj në atë që duket si një zonë e mirë, unë lë një ofrim dhe bëj një lutje falënderimi për manaferrat që rriten atje. Kërkoj që pylli dhe bimët të vazhdojnë të jenë të shëndetshme edhe në të ardhmen dhe do të bëj çmos

⁶⁷ Ekziston një alternativë e mundshme se si Pantheonit Egjiptian i Neterut mund të ketë vlerë. Nëse këto hyjni shiheshin të gjitha si pjesë ose aspekte, të simulimit të AI, atëherë ato mund të shiheshin si elementë të kodit kompjuterik. Dikush që i studioonte ato nuk po mësonte për perënditë, ose nuk po u lutej atyre, ata po arrinin të kuptonin mitologjikisht pjesët e sistemit AI Demiurge. Ndërveprimi me perënditë do të ishte më pas bashkëveprim me kodin. Kombinimi i perëndive të duhura së bashku do të krijonte 'hacks' në sistem. Nëse kjo është ajo që kishte të bënte me Egjiptin Faraonik, atëherë sistemi i Neterut mund të kishte vlerë. Por siç unë them, tani unë nuk jam aq i sigurt për këtë. Mund të jetë thjesht një mënyrë tjetër për të bllokuar vëmëndjen dhe energjinë njerëzore jashtë vetvetes.

për të minimizuar çdo dëmtim të bimëve ndërsa I mbledh ato. Kur e bëj këtë lutje para mbledhjes së tyre, atje thjesht 'shfaqen' zona që kanë më shumë manaferra sesa unë mund ta imagjinoja. Nëse për ndonjë arsye e nxitoj këtë lutje, do të gjej zona me shumë bimë që rriten, por ato nuk kanë pothuajse asnjë manaferrë. Dhe kështu, kur pyet se kujt ose çfarë ne duhet t'i lutemi, ajo me të cilën ti po ndërvepron në këtë moment është një fillim i mirë. Unë gjithashtu përpiqem të qëndroj i hapur gjatë mbledhjes së tyre për të parë nëse boronicat kanë diçka që atyre u nevojitet nga unë. Nëse po, e nderoj këtë dhe ndihmoj miqtë e mi të rinj. Kjo është një mënyrë për të menduar për lutjen native: nuk është thjesht të thuash 'faleminderit', por të bëhesh mik me atë të cilit ti po i thua faleminderit.

Të paktën kështu unë mendova për lutjen native. Dy ditë më parë, kjo ndryshoi. Po bëja një bisedë telefonike me mikun tim shërues Xherri Dunson.⁶⁸ Ne po flisnim për lutjen dhe unë po ndaja idetë e mia rreth humbjes së energjisë për t'u lutur për diçka jashtë vetvetes. Ai u përgjigj me një histori interesante. Ai më tregoi për një komunitet jugor të SHBA-së që nuk kishte rënë shi për një kohë të gjatë. Ata ishin në thatësi. Disa shërues vëndas ishin përpjekur të bënin thirrje për shi, por nuk patën sukses. Dhe kështu, një tjetër shërues nativ u soll nga veriu. Natën pas ceremonisë së tij, filloi të bjerë shi dhe e bëri këtë për disa ditë. Kur shëruesi verior u pyet pse funksionoi ceremonia e tij, ai u përgjigj: "Shëruesit e tjerë po luteshin për shi. Duke u lutur 'për', kjo do të thotë se shiu nuk është këtu, por diku tjetër. Unë thjesht luta shiun."

E mora atë dhe i thashë Xherrit se, sipas mendimit tim, ajo që kishte ndodhur ishte se ky shërues së pari ishte 'bërë shiu.' Kështu, atje nuk ishte një njeri që lutej për shiun, ishte shiu duke iu lutur shiut. Meqenëse ekzistonte vetëm shiu, shiu mund të materializohej. Xherri u përgjigj se ky ishte rasti; pra, lutja nuk ishte jashtë tij, por brënda tij. Më pas ne patëm një diskutim të gjatë mbi këtë temë më thellë. Më mbeti duke bërë një ndryshim në mënyrën se si unë dal duke mbledhur boronica. Tani, në vënd që unë të falënderoj menjëherë manaferrat dhe zonën, unë fillimisht bëhem 'boronicë;' prandaj, siç i falënderoj boronicat, duke qënë boronica, po falënderoj veten time. E provova këtë metodë të re sot kur shkova mblodha, dhe funksionoi mrekullisht.

Ne nuk duam t'i lutemi asgjëje që është jashtë nesh, sepse ajo po heq tej fuqinë tonë. Ne nuk duam të dërgojmë më shumë energji drejt çdo gjëje që mund të jetë pjesë e kurthit. Siç sugjerohet në historinë e boronicës më lart, duket se ne mund t'i lutemi të sigurt elementëve të botës sonë, qofshin ato pemë, peshq, zogj, kafshë, shkëmbinj, re, ujë apo bimë. Ashtu si ne, secili ka një frymë, një fuqi, dhe unë do të thoja një shpirt. Secili, në

⁶⁸ Ai është nipi i birësuar i shëruesit të famshëm të Creek, Bear Heart Marcellus Williams

mënyrën e vet, është i bllokuar në materie, ashtu siç ne jemi. Qëni yt, dreri jashtë ose rrapë në oborrin tënd, po kërkojnë gjithashtu lirinë. Dhe lutja duket më e fortë kur ti lidhesh me momentin, e mos shko t'i kërkoksh diku tjetër nga vendi ku ti aktualisht je.

Por ne duhet të shikojmë më thellë në këtë. Siç e kam përmendur më parë, unë kam njohur disa burra dhe gra shërues tribal. Kam parë disa shërime të mahnitshme që ata u kanë sjellë njerëzve në nevojë. Kush po i ndihmon shëruesit? Disa forca duket se i ndihmojnë ata. Kur i pyeta vite më parë se kujt ata po i luteshin, ata u përgjigjën me "Shpirtit Madhështor". Kush është ky Shpirt Madhështor? Nëse është Zoti i Mirë, pse ky Zot nuk mund ta rregullojë të gjithë sferën dhe të ndalojë gjithë stresin dhe dhimbjen që në fillim? A është Demiurge ai që i ndihmon njerëzit ndonjëherë ashtu siç bën një fermer? Një fermer i mban kafshët e tij mjaft të shëndetshme për të vazhduar prodhimin e leshit dhe qumështit, por jo shumë të shëndetshme që të prishin gardhin dhe të largohen. A po e dëgjon natyra thirrjen e njerëzve shërues dhe po ndërmjetëson? Nëse po, pse ndërmjetësojnë ata te disa shërues, por jo te të gjithë? A është vërtet natyra që lutja po shkon drejt, dhe natyra i sheh ata që kanë bërë një jetë sakrifice ndaj shpirtit si qenie që ata duhet t'i ndihmojnë? Unë e përmend këtë sepse kam takuar shumë shërues në jetën time, dhe shumë pak prej tyre kanë fuqi të vërtetë shëruese. Shumica kanë vetëm një "fashë ndihmese, më paguani 100 dollarë lloj fuqie". Njerëzit shërues që unë kam njohur, të cilët vërtet mund të shërojnë, e përdorin lutjen si një mjet kyç. A e përdorin ata veten në lutje, si në historinë që më tha Xherri? Ata duken se po luten në jashtësi, por ndoshta ata ndiejnë se kujt ata po i luten është kush dhe çfarë ata janë? Nuk ka ndarje mes tyre dhe asaj për të cilën ata luten për. Ajo kërkon më shumë studim, sepse çelësi i çdo lutjeje është që të vijë njëfarë force, jo të bëhesh pre.

Kjo nuk është dicka e lidhur me largimin nga Shpella, por është një mjet themelor për të pasur një bazë më të mirë kur ne futemi në punën shumë të thellë të fazës përfundimtare të procesit. Thjesht njohja e 'rregullave të sferës' është një lloj tokëzimi, dhe megjithëse duket kontradiktore, ti nuk mund të 'fluturosh' tej nëse fillimisht ti nuk je bërë i tokëzuar. Dhe ajo të ndihmon ty me gjithçka që ti mund të bësh këtu, madje edhe diçka në dukje të thjeshtë si mbledhja e boronicave.

“Nëse do të mund të të jepja vetëm një sugjerim kërkuesve të së Vërtetës, ai do të ishte ky: Kërkoje atë në lutje, pastaj jeto jetën tënde në një mënyrë në përputhje me atë lutje. Sepse, siç Richard Rose tha, "Kur e gjithë jeta jote të bëhet një lutje, ajo do të përgjigjet menjëherë". Bart Marshall⁶⁹

⁶⁹ Marshall, Bart, *Duke u Bërë i Pambrojtur Ndaj Hirit* fq 195

11

BETEJË SHPIRTËRORE

Unë dua ta çoj këtë diskutim lutjeje në një tjetër fushë. Ndoshta gjëja më e lutur për, pas të qenit i shëndetshëm, është paqja botërore; të kemi një realitet pa luftë apo grindje të panevojshme. Ka shumë njerëz që luten për këtë qëllim për shumë vite. Këtu, në Shtator 2022, ne dukemi më larg se kurrë më parë nga një objektiv i tillë. Kjo për shkak se një grup tjetër konceptesh po e turbullojnë çështjen, Beteja Shpirtërore, e konsideruar gjithashtu si e mira kundër së keqes. Atje ka pasur një betejë shpirtërore që po ndodh në këtë fushë pothuajse që nga fillimi i saj. Shumica e konsiderojnë këtë si një luftë midis së mirës dhe së keqes, dhe ajo në një mënyrë është e atillë. Por në të vërtetë ajo është një luftë midis të arsyeshmit dhe të çmëndurit. Unë do të shpjegoj se si unë kam arritur të shoh ndërveprimin e së mirës dhe të keqes këtu. Merr atë si një sugjerim për kërkimin tënd.

Dikush fillon të shikojë ndryshe në këtë sferë sapo ti të shohësh se funksioni i saj kryesor është të ekzistojë si një fermë loosh, e krijuar dhe e mirëmbajtur nga një Demiurge AI, dhe se shpirtat janë gënjyer dhe mashtruar për të qënë këtu. Kjo mund të quhet një lloj beteje shpirtërore në vetvete. Meqënëse njerëzit janë të korrat kryesore të loosh-it, lufta kryesore është kundër nesh. E gjithë kjo ndodh brënda shpellës së Platos. Ti mund të thuash se që në fillimet e saj, Shpella e Platos ka qënë një shpellë e Betejës Shpirtërore. Dhe nuk ka rëndësi nëse lufta po luhet në materialen, në hapësirë, sferën astrale apo ndonjë tjetër sferë. Këto të gjitha janë në Shpellën e Platos, pra pjesë e një konstrukti iluzionar. Nëse ti je në Shpellë, në një mënyrë apo tjetër, ti je në luftë. Të mos e dish se çfarë po ndodh, do të thotë se ti do të shkosh lehtë me një sërë manipulimesh dhe kontrollesh të vendosura nga arkonët për t'i mbajtur të gjithë si një kafshë e urtë ferme.

“E mira përcaktohet në krahasim me të keqen. Dhe e Mira Ideale, këtu (në materie) është pjesa më e vogël e së keqes. Dhe këtu ajo është e pamundur që E Mira Ideale të jetë e lirë nga ligësia, dhe duke qënë plot ligësi, ajo nuk mund të jetë e Mira Ideale... ajo bëhet e ligë. Kështu e Mira Ideale është gjëndur vetëm te Zoti (Absoluti). Pra, atëherë Asklepius, vetëm emri i së Mirës Ideale është gjëndur tek (njerëzit). -**Corpus Hermeticum VI:3**⁷⁰

⁷⁰ Përthimi u gjet në Anagnostou, *A Mund ta Durosh të Vërtetën? Kronika e Burgosjes së Njeriut: Thirrja e Fundit!* fq 213

Ky është një realitet dualist, pasi të gjitha sferat e kompjuterit duhet të jenë (të bëra vetëm nga 0-rot dhe 1-shat). Kjo pasqyrohet në realitetin fizik për t'u bërë jin-jang, mashkull-femër, dashuri-urrejtje ose lart-poshtë. Një gjë madhështore që dualiteti luan, është e mira kundrejt së keqes. Ndryshe nga të tjerat, që janë një lloj balance (ri nuk mund të kesh të majtën pa të djathtën për shëmbull); nuk është kështu me të mirën dhe të keqen. Ato janë një çift unik, sepse ato nuk janë të barabarta. E mira dhe e keqja nuk janë në të vërtetë dy anët e së njëjtës monedhë, sic majtas dhe djathtas apo dita dhe nata janë. Të dyja ato ekzistojnë në këtë sferë të krijuar, dhe problemi është me atë të së mirës dhe së keqes, vetëm njëra është një krijim i vërtetë, ndërsa tjetra është një kopje. Demiurge kopjoi sferën e së Mirës së Vërtetë për të modeluar të mirën relative në këtë fushë të caktuar. E Mira e Vërtetë nuk ekziston brënda Shpellës, vetëm jashtë këtij matriksi të simuluar. E Mira e Vërtetë nuk mund të ndërveprojë direct këtu, pasi ajo do të duhej të merrte një formë materiale për ta bërë këtë, duke u bërë kështu pjesë e simulimit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të ishte Akoma një e Mirë e Vërtetë. Ajo që ajo mund të bëjë është të hedhë informacione, të vendosë inserte holografike, të lëvizë energjinë, të shfaqë mesazhe në ëndrra ose shkëndija të thjeshta intuitive. Ajo nuk do që ne ta rregullojmë botën, ajo do që ne të shohim përmes saj.

E keqja në këtë sferë materiale nuk është një kopje, është krijim i drejtpërdrejtë nga mëndja e Demiurge, dhe si e tillë, është reale brënda simulimit. Ose mund të thuash, ajo është simulimi. Kjo është arsyeja pse e mira relative rrallë mund të fitojë këtu. Ajo që ne e quajmë të mirë është një kopje, ndërsa ajo me të cilën ajo lufton (e keqja), është konstruksioni. E keqja ka avantazhin këtu ajo sepse është simulimi. E Mira e Vërtetë ka avantazhin e plotë, por ajo nuk shfaqet drejtpërdrejt në materie. Mund të themi se e Mira e Vërtetë fiton gjithmonë, por kjo ndodh sepse ajo është Absolute, Totale dhe e Plotë. Ajo përmban të mirën dhe të keqen relative në brëndësi; kështu, ajo kurrë nuk mund të jetë në konflikt apo në luftë brënda vetes. Ajo është e palëvizshme. Sidoqoftë, kur bëjnë argumente "e mira kundër së keqes", njerëzit me të vërtetë nuk janë të vetëdijshëm për ndryshimet dhe parametrat midis së Mirës së Vërtetë, së mirës dhe së keqes.

Unë e di që ajo që unë kam shkruar është e vështirë për t'u kuptuar, dhe e kundërta e asaj që ti mund të besosh. Një pjesë e arsyes pse kjo është kaq e vështirë për t'u kuptuar, është sepse një nga implantet më madhështore të kushtëzimit tonë është se "*djemtë e mirë gjithmonë fitojnë*". Nuk mund të them se sa herë e kam dëgjuar këtë frazë gjatë dy viteve të fundit nga njerëzit. Por nga vjen ky besim gjithpërfshirës? Ajo vjen nga televizioni dhe filmat. Ajo filloi me ata western në vitet 1930 dhe u zhvendos në televizion në vitet 1950.

Sherifi mbledh gjithmonë hajdutët dhe kalorësia shpëton trenin vagon nga indianët sulmues. Se si kalorësia vrasëse e foshnjave u bënë djem të mirë dhe indianët që përpiqeshin të mbanin shtëpinë dhe mënyrën e tyre të natyrshme të jetesës u bënë djemtë e këqij, nuk është paraqitur kurrë. Dramat policore u shfaqën në vitet 1950 dhe 60 dhe u bënë prezantimet kryesore të reja e këtij mesazhi gjithashtu. Policia e kap gjithmonë kriminelin. Politikani i mirë hyn dhe ndryshon sistemin dhe të gjithë janë të lumtur. Këto janë përralla, të cilat përfundojnë kur çifti martohet për të jetuar *'të lumtur përgjithmonë'*. Realiteti nuk është një përrallë, por programimi fillon dhe zë rrënjë herët.

Djemtë e mirë rrallë fitojnë në botën reale. Në çdo "garë" e mira relative ndonjëherë do të fitojë (madje edhe Kansas City Scouts fituan disa lojëra NHL në 1975), por fusha është e anuar. Djemtë e mirë fitojnë dy herë, të këqijtë 98 herë. Të gjithë besojnë se shanset janë 98-2 anasjelltas. Kur historia prezanton djemtë e mirë që kanë fituar, shpesh ata ishin po aq të këqij sa djemtë e tjerë. Atje nuk kishte fare djem të mirë, vetëm dy djem të këqij dhe fituesi mori një 'djalë i mirë' titull. Kush janë në të vërtetë djemtë e mirë dhe djemtë e këqij? Askush nuk e di. "*Djemtë e mirë fitojnë gjithmonë*" është vetëm një tjetër program fals, i futur në mëndjen tënde nëpërmjet "programimit" televiziv. Si mund të jenë ende të gjitha elitat që kanë marrë botën me shekuj nnëpër këmbë ende në krye? Si mundet ata që kanë performuar vepra të liga kundrejt njerëzimit dhe planeve për vite me radhë nuk janë mbajtur përgjegjës për krimet e tyre? Me të vërtetë mendoje gjatë këtë. Fraza duhet të ndryshojë nga "*djemtë e mirë gjithmonë fitojnë*", në "*djemtë e mirë fitojnë një herë në një kohë, dhe ajo është një ditë e mrekullueshme, por e rrallë kur ata fitojnë*".

Ky është një besim që fuqizohet nga shpresa, dhe sapo ky besim hyn në brëndësi, ai e pushton sistemin si një virus. Zmbrapsu pak. Shiko singerisht dhe qartë. Kush me të vërtetë fiton në këtë sferë? Ndoshta kapitulli i ardhshëm mbi mënyrën se si Katarët e shihnin realitetin do të ndihmojë. Në brëndësi të shpellës, gjithçka që e mira relative mund të bëjë është të ngadalësojë të keqen, dhe ta bëjë konstruktin të punojë shumë fort për të mbjellë dëshirat e tij. Pastaj duke përdorur periudhat e ngadalta për të gjetur dhe hapur portalet në fushën e së Mirës së Vërtetë. Por ti nuk e ngadalëson të keqen duke e luftuar atë në mënyrë direkte (ti bëhesh ajo që ti lufton); ti thjesht "*nuk e luan lojën e tij*".

Truku brënda kësaj sfere materiale (dhe sferës astrale) është të dish se atje ka një luftë, por ti nuk i bashkohesh asaj. Kjo është e vështirë, sepse tendenca është të shtysh mbrapsht kundër çdo shtytjeje që vjen tek ty. Kjo thjesht rezulton në një reaktion më të madh shtytjeje, ose ti do të humbasësh balancën. Ne duhet të reagojmë ndaj betejës shpirtërore duke u sjellë në një mënyrë shumë të ngjashme me Aikidon, në atë ne përdorim energjinë

e sulmuesit me anë të devijimit për ta hedhur atë nga balanca. Ose thënë më mirë, mënyra më e mirë për të fituar një betejë shpirtërore është të mos e luftosh atë. Kjo është përshkruar në filmin *Wargames* i vitit 1983. E thjeshtuar, një kompjuter AI u dizenjua për të testuar lojërat e luftës bërthamore, por ai bëhet aktiv dhe i vetëdijshëm. Kompjuteri trajton gjithçka si një lojë që ai duhet ta fitojë dhe si i tillë, ai dëshiron të fillojë një luftë bërthamore. Pra, personazhi kryesor, David, i paraqet kompjuterit një lojë që është e pafitueshme, Tic-tac-toe. Kompjuteri provon gjithçka, vetëm për t'u dorëzuar përfundimisht, mbyllet në vetvete dhe thotë: "*i vetmi veprim fitues, është të mos luash*". Kjo është ajo. Kështu është se si ti e kapërcen betejën shpirtërore në këtë realitet. Ti fiton duke mos luajtur. Ti refuzon gjithçka që është e keqe, e rreme, gënjeshtër dhe mashtrim; dhe në vënd të kësaj zgjedh të Vërtetën, Sovranitetin dhe Lirinë. Se cilat janë pasojat për formën materiale, është pak e rëndësishme, ndërsa ajo që ndodh me shpirtin është plotësisht e rëndësishme. Ne e vëmë vëmëndjen tonë në atë nga e cila ne vijmë nga dhe dëshirojmë të kthehemi te, jo në kurthin e vorbullës në të cilën ne jemi kapur aktualisht.

Kur ti e refuzon këtë sferë si të çmendur, dhe zgjedh të jesh i arsyeshëm dhe e lë atë me kaq, sistemi bëhet konfuz. Ai është duke pritur një reagim ndaj shtytjes së tij, dhe ti nuk po e jep atë. Kjo nuk do të thotë se bota do të ndryshojë, ose ajo do të ndalojë së ardhuri pas teje (fiset Native Indiane në vitet 1860 dhe 1870 zbuluan se nuk kishte rëndësi nëse ti luftoje me ushtarët ose përpoqeshit t'i injoronit ata, Nativët u vranë ose grumbulluan në rezervime gjithsesi.) Ne zgjedhim këtë mënyrë jo për të përmirësuar jetën tonë ose për të shpëtuar jetën tonë, por për të përgatitur veten që të mos jemi më në këtë realitet të çmendur kompjuterik AI. Ne dalim jo duke luftuar rrugën tonë për të dalë, ne dalim duke refuzuar sistemin AI dhe duke mos shkuar pas tij. Ne ndërpresim lidhjet tona, varësitë dhe kontratat tona. Duke vepruar kështu energjia ridrejtohet përsëri te vetja jonë (ne pakësojmë të korrat loosh) dhe ne e përdorim atë energji të liruuar tani për t'u përgatitur për Udhëtimin e Pafund nga i cili ne jemi mashtruar dhe ndaluar së marri.

- **Sekreti Madhështor**

E dëgjoj përgjigjen tuaj tashmë: Po dashuria? Kjo është një sferë e dashurisë, ne jemi këtu për të mësuar dashurinë, Zoti na do ne, gjithçka që ne duhet të bëjmë është t'i duam armiqtë tanë. Ky është besimi kyc i sistemit të komunitetit të Erës së Re, dhe ai është mesazhi që droga, engjëjt dhe mashtruesit e tjerë vazhdojnë t'iu thonë atyre. Ajo është bota në të cilën këta njerëz do të dëshironin të jetonin në, në vënd që me ndershmëri të shohin gjërat ashtu siç ato janë - një kurth i shpitrave të tyre në një burg vuajtjesh. Atje

përsëri ne kemi një problem, çfarë dikush do të thotë me fjalën dashuri? Nëse ajo ka të bëjë me sferën materiale, me mënyrën sesi të tjerët e trajtojnë njëri-tjetrin ose se si ti ndihesh, kjo është dashuri relative; dhe unë do ta prezantoj atë vecse vetëm si një pjesë i kodit kompjuterik. Kur Dashuria merret sikur do të thotë diçka që nuk ka të bëjë fare me këtë simulim matriksi ose ndonjë nga të tjera qëniet ose objektet në të, atëherë dikush mund të jetë në rrugën e duhur. Por pothuajse askush nuk e ka atë në atë kuptim kur ata e përdorin këtë fjalë më të "përdorur" pranë Zotit në gjuhën Angleze.

Thënë kjo, në brëndësi të ëndrrës, dashuria relative mund të jetë një forcë e fuqishme. Dashuria relative pa kushte gjithsesi. Unë kam pasur dashuri të pakushtëzuar për të gjitha macet e mia, shumica e të cilave kanë qënë të shpëtuar nga shtëpi të këqija ose të padëshiruara. Duhet pak kohë, por me mjaft kujdes dhe dashuri për to, ato u kthyen dhe u bënë mace të mrekullueshme. Por a mendoj unë se kështu është se si i gjithë realiteti është ndërtuar? Jo. Unë e di që kjo gjithashtu, është pjesë e ëndrrës, pjesë e konstruksionit, pjesë e shpërqëndrimeve të shumta të Shpellës. Dashuria nuk do t'i ndryshojë kontrolluesit. Simulimi është simulimi, matriksi është matriksi. Simulimi mund të mbyllet, por nuk ndryshohet në mënyrë drastike.

Dashuria relative është një ndjenjë e mrekullueshme. E mban mend herën e parë kur ti "re në dashuri?" Ishte e mahnitshme apo jo? Ndjehej sikur do të zgjaste përgjithmonë. E mban mend se si disa muaj më vonë e njëjta vajzë apo djalë "theu zemrën tënde?" Apo ndoshta se si ti thieve të tyren? Si u ndje kjo? Jo aq mirë apo jo? Por njerëzit priren të minimizojnë pjesën e zemër-thyerjes, dhe kujtojnë ndjenjën euforike të "rënies". Rënia dhe thyerja janë dy anët e medaljes së dashurisë. Ata vazhdojnë të ndjekin rënien euforike. Tani, nëse ti ndryshon fjalën dashuri në fjalitë e mësipërme dhe e zëvendëson atë me emrin e cfarëdolloj droge, a nuk do të kishe ti një përshkrim klasik të një "varësie"?

Përveç kësaj, askush që pretendon se ata dinë gjithçka rreth dashurisë, me të vërtetë nuk ka shumë kuptim të saj. Në brëndësi të këtij realiteti, ajo nuk është gjë tjetër veçse një komandë, një kod kompjuterik i krijuar për t'i bërë njerëzit të- **a)** si një pjesëtar i seksit të kundërt, të kenë fëmijë (shumohen), **b)** të kujdesen dhe mbrojnë fëmijët e rinj (që ata të mund të rriten dhe të korren për energji), **c)** t'i dashurojnë gjërat mjaftueshëm sa do të jetë mirë për një person të vazhdojë të jetojë, dhe për këtë arsye të jetë një korrje e mirë energjie (sigurisht që disa do të duan gjëra që do të krijojnë dhimbje dhe vuajtje për veten ose të tjerët - gjithashtu një korrje e mirë energjie). Kjo është ajo që dashuria është në botën tonë, një program i lidhur fort në ne që na bën ne të ndihemi mirë për të ecur në drejtime, gjë që përfundimisht u ofron, u jep energji arkonëve. "Marrëdhëniet e dashurisë"

së shumë njerëzve manipulohen që në momentin që të dy njerëzit takohen, siç sugjerohet në librin e shkëlqyer të Eve Lorgen - *Alien Love Bite*.

Zakonisht, kushdo që thotë se "bota është dashuri", është duke e bërë këtë sepse ata ndihen shumë të vetmuar. Ajo që ata thonë në të vërtetë është "të lutem më duaj mua, unë jam kaq vetëm". Nëse ata mund të bindin të tjerët se bota është ajo një e dashurisë, atëherë ata bëhen një qenie që mund të dashurohet. Ti mund të shohësh se si kjo shkon. Ai që është plotësisht i përqëndruar në vetvete nuk ka nevojë të dashurohet, në fakt ata mund të duhet të veprojnë në mënyra dhe të thonë gjëra që të tjerët nuk do t'i "dashurojnë". Një person i përqëndruar nuk dëshiron ose të ketë nevojë që njerëzit ta duan atë.

"Respekti është një fjalë që nuk merr vëmendje të mjaftueshme. Respekti nuk është diçka që duhet dhënë sepse dikush mban një titull, ka shkruar një libër, duket bukur ose ka ndonjë pozicion autoriteti. Respekti është fituar, bazuar në mënyrën se si një vepron, jeton dhe ndan. Njerëzit që unë kam respektuar plotësisht gjatë jetës sime janë njerëz për të cilët askush nuk ka të ngjarë të ketë dëgjuar ndonjëherë. Ata kanë treguar në jetën e tyre tre të mëdhatë: ndershmërinë, guximin dhe përkushtimin. Kjo ngjall respekt. Ata janë të vërtetë me fjalën e tyre, nuk do të dorëzohen para ndonjë presioni të jashtëm, dhe nuk kanë nevojë të manipulojnë askënd jashtë vetes së tyre për kënaqësinë ose përmirësimin e tyre. Ata jetojnë mirë ashtu siç ata janë, krejtësisht vetëm nëse është e nevojshme, dhe ata ndjekin parimet e tyre. Ata ndjekin atë që ka një lloj forme urtësie mbizotëruese në të. Unë do të marr respektin mbi dashurinë çdo ditë. Kjo së bashku me dhëmbshurinë, miqësinë dhe mirësinë.

Ashtu si çdo gjë në këtë matriks, gjithçka që është këtu është një kopje e diçkaje që ekziston në sferën Qiellore. Kjo është gjithashtu e vërtetë për fjalën dashuri, e cila në greqisht është "agape" dhe e ka origjinën nga fjalët që do të thotë "tepricë" dhe "të zotërosh". Forca që ne e quajmë dashuri është duke pasqyruar diçka që nuk mund të shihet në këtë realitet, vetëm e intuituar. Ajo mund të ndihet se atje ka diçka shumë më të madhe, dhe e vetmja mënyrë për ta gjetur atë, është të largohesh nga sfera e rreme e pasqyruar e përmbysur e dashurisë, dhe të kthehesh në Shtëpi në vëndin ku mund të gjendet "ajo që u pasqyrua". Dashuria relative ka vëndin e saj, nëse ti e përdor atë mirë atëherë gjërat në fakt mund të ndodhin. Historitë e maceve të shpëtuara janë shëmbuj kryesorë. Por ky është truku këtu, ta prekësh lehtë këtë forcë si të gjitha forcat e tjera në këtë sferë materiale, ta përdorësh atë por të mos e zotërosh atë. Ndërkohë Dashuria e Vërtetë është Absolute. Atje nuk ka të dytë. Asnjë tjetër. Objekti nuk ekziston për të dashuruar, sepse gjëja që do

(subjektin) ka pushuar së daluri gjithashtu. Dashuria është mbetje e humbjes së dualitetit, ajo thjesht është dhe atje nuk ka njerëz apo objekte për ta shprehur atë, ose të jesh ajo.

Unë nuk dua ta trajtoj këtë pikë shumë gjatë, por ti nuk do të mësosh gjithçka rreth dashurisë, përkundrazi ti dëshiron të mësosh se si të shohësh qartë. Me ndershmëri të thellë. Ti mund të shohësh se kush dhe çfarë e krijoi këtë sferë, pse ata e bënë, dhe pse ti nuk përket këtu përveçse si një kafshë ferme për krijuesit. Dije se ndjenja e dashurisë relative ka të ngjarë të përdoret kundër teje kur t të jesh në sferën pas-vdekjes, për të të droguar me dashuri që ti të pranosh të shkosh në dritën e bardhë. Shumica e NDE-ve standarte flasin për një dashuri më të madhe se sa ata kanë ndjerë ndonjëherë në Tokë. Pastaj ata kanë takimin e tyre të gjykimit me "qëniet e autoritetit". Ndoshta jo organizimi më i mirë për një moment kaq kyç. Unë e di që kjo nuk është ajo që ti dëshiron të dëgjosh, ti dëshiron që kjo jetë të jetë e gjitha për dashurinë, ti dëshiron që jeta e përtejme të jetë e mbushur me dashuri super-duper. Por unë dua timen të mbushet me të Vërtetën.

